VASIL VASILI

PËRKTHIMET E KOHËS

POETIKA E MOIKOM Z.

West Print
Tiranë, 2018

Autori:
VASIL VASILI

Titulli i librit:
Përkthimet e kohës

Pergatiti librin:
ANTON PAPLEKA

Redaktor:
FATMIR MINGULI

Design:
Xhina ÇAÇI

ISBN:

Ky libër i kushtohet prindërve të mi,
Andonit dhe Sofisë.

Vasil V.



PASQYRA E LËNDËS

Në vend të parafjalës 7
Në kaos ka përshtathje 9
Ka frikë mos i vdes Zoti
në duar Moikom Zeqos 11
E dashur mos vdis..... 21
Na drejtojnë përfytyrimet Pasqyrë
pas "Ka frikë mos i vdes Zoti në duar" 33
Tre ungjillorët e poezisë 41
Plagosja e kujtesës 47
Te Moikomi koha lulëzon çasti vdes 53
Redaktori refleksiv Pasqyrë para
"Shenja koha sot me ciklet
e mëdha të kohës" 69
Shenja koha sot me ciklet
e mëdha të kohës 85
Përgjigje njeriut dhe krijuesit Pasqyrë
pas "Shenja koha sot me ciklet
e mëdha të kohës"..... 103
Tokë pa kohë..... 109

"Dominantja e padukshme"..... 113
Fjalës s'i mjafton kurrë një kuptim 125
Fjalët kthehen në rrugët që lindën..... 147
Kronikë e dytësit shoqërues..... 153
O Hy i poezisë! Shkofsh në djall!" 159
Letër Vasil Vasilit për poezinë 163
Thënie të poetëve amerikanë për Moikomin 166

NË VEND TË PARAFJALËS

Moikom Zeqo poetikisht qëndron i varur te Çasti i Madh, – te Koha dhe te rimishërimi i Pitagorës.

Te një aksident në gjykim, siç është koha dhe te një ringjallje e pjesës së lehtë, siç është shpirti i rimishëruar pitagorian, ka mbështetur të dy mekanizmat e tij poetikë.

Ka vënë në lëvizje dialektikën e çastit nëpërmjet kohës së amshuar. Kjo është një rrugë shumë e vështirë poetike.

Është e njohur që Moikomi është poet i jashtëzakonshëm i referencave historike. Ato i ka bërë vetëdije kulturore. Referencat, të futura brenda guackës së figurës, i ka hedhur si çaste të ndritshme mbi kanavacën e errët të kohës. Si rastësi të menduara, ato ndihmojnë për të të bashkuar me idenë e një çasti.

Të qenit brenda një çasti ka shumë rëndësi për t'a ndjerë një poezi. Brenda një çasti është e barabartë më së paku me thithjen e avullit poetik, i cili ka të tretur disa përbërës në ajrin e tij të lehtë. Por Moikomi brenda një poezie ka shumë çaste që vihen në një unitet, pikërisht nga avulli poetik me të cilin i mbështjell.

Moikomi çastin e flijon për kohën. Ai psikologjikisht

nuk e njeh çastin. Psikologjikisht nuk e njeh dhe kohën. Kohën e njeh kulturalisht, ndërsa çastin nuk e njeh as kulturalisht, se thamë që atë e flijon për kohën, por duhet saktësuar se e flijon për kohën kulturore dhe, koha kulturore është një kulm që vjen rrallë dhe, në urnën e saj ka pafundësi çastesh të flijuar.

Poezia e Moikomit është urnë e çasteve dhe jetë e kohës.

NË KAOS KA *PËR-SHTAT-JE*

Të këqyrësh vetveten si zanafillë kaosi
atje të t'zbulohet luzma e mistereve,
të ndjesh të përshkoi bukuria si trëndafil
që s'hedh në mbremje hije kohe për brerore,
si të panjohurat e kyçura në vetvete
të pagëzohet për herë të parë
me shënja fonike dhe, duke u fshirë,
ato të mbrrijnë te shenja poezi,
të fitohet botëvështrim për fitore
të mundëshme të njeriut (me stil)
në botën Moikom
si lindja që s'u krijua nga vetmia
doli nga takimi i vetmive dhe i shoqërimit
se s'ka rilindje nga vetja në kaos
ka *Për-Shtat-Je*.

KA FRIKË MOS I VDES ZOTI NË DUAR

Moikom Zeqos

Ende rravgoj të gjej shkruesin e vargut me ndriçim trishti, "E dashur mos vdis!". Cituesi i famshëm, Moikom Zeqo, siguron gjithkënd: Është nga domeni i Pablo Nerudës, madje thotë se, medalioni i poemës së tij, është me lëndën e bryllët të këtij portreti tingujsh.

Pjesa është tagri im. Me atë mund të përshkoj rrugë mesdite me zheg të fortë. Jam nisur të kërkoj kush e shkroi vargun, "E dashur mos vdis!", se besoj: me një dashuri mund të jesh tokësor në qenien tënde. Në rravgim përsiat. "Rravgim" e "përsiat" emërtojnë të njëjtën gjë në gjeografi të ndryshme, prandaj s'janë e njëjta gjë. Ndjej se vargu, që më mundon, ka qënë gjithnjë. Moikomi citon me shumë mënyra apokrife edhe autorë, që e kanë rikrijuar. Edhe ata mund të citonin paraardhësit e tyre. Krijuesi, që është brenda njeriut të sotëm, Moikom Zeqo, i kujton me nderim të mëparshmit e pemës gjenealogjike të: "E dashur mos vdis!"

Unë kapa të përgjithshmen: "E dashur mos vdis", ka qenë e shkruar dhe e folur, madje edhe

e lojtur si rit sinkretit. Pastaj u bë ferment i kujtesës estetike. Krijuesit paraardhës ishin krijues me qenie të ndërprerë. Tani ata janë të amshimit. Një fat i tillë e pret edhe Moikom Zeqon. "E dashur mos vdis!" është kumt për të përgjithmonshmen. Ekzistencializmin e tyre e kqyrr në rrugët që ndoqën për të mbrritur te: "E dashur mos vdis!"

Ata janë kor etrish madhështor. Jam shumë larg vendit ku kori këndon Këngën e Jetës, por ua shquaj fytyrat gjithsecilit. Kjo këngë s'mbaron kurrë. Një çast Poetët bisedojnë në shoqërinë e të zgjedhurve të rastit. Më të shumtit janë vetmitarë mes shtrëngatave të tyre.

Dua të sqaroj diçka të vështirë, tej mundësive të mija. Rrekem për fjalën e pashpjegueshme,"Poet". Ndriçoj një të barasvlershme të saj librore: "kujtesë e përndezur".

Pastaj e kall këtë të barazvlershme librore, për më shumë qartësi dhe reliev, në shtratin e metaforës: "Kujtesë që ka marrë zjarr". Besoj se në këtë metaforë është poeti.

Po shquaj Heraklitin e Efesit, të errtin. Pamjet, që ka parë dhe, mendimet që krijon nuk i mjaftojnë të ngujuara në kujtesë. Do, që ti derdhë në një lumë, që e quan kohë. Në atë lumë nuk u la dot dy herë. Gjithçka ndërpritet, madje edhe lumi ndërpritet, është metafora e të errtit. Ndërkoha ishin ditët e tij. Humbja e kohës ka qënë për të: "E dashur mos vdis!".

Ca të panjohur, të përbuzur, të varfëruar u kujtuan

të krijonin me vegullime Krishtin Shpëtimtar. Eshtrat u janë bërë pluhur, ndërsa vegullia e tyre jeton ende. Me emrin e vegullimtarëve është paraqitur Ungjilli sipas Gjonit.

Një burrë i vetmuar heq protezën e krahut të majtë. Mos është Servantesi, që po shpie Don Kishotin te Dylqinja e Tabozës?

S'pata mundësi t'ia shoh krahun cung se i mbiu flatër dhe flatrën ia gjallëroi piktori Jeronim Bosh. Pak më vonë agori i burrit mori trajtën e Vajzës me Flatra si në një tregim të Dino Buxatit. Trupi i shndrruar shfaqej me fuqinë e një mashkulli në zenit dhe me brishtësinë e kërcelltë të një femre me flokë të gjatë si nata. Ai trup, që gjininë e këmbente sall për dukje të bukur, sapo kishte kënduar: "E dashur mos vdis!" në një gjedh të ri.

Ne,- qeliza, zanafilla, dashuria.
Dyshi i dashurisë është - një,
dy krahëza pikëlorë në buburezë.

Disa burra me pelerina të plurosura, me sandale të ngrëna në themra nga jeta e gjatë dhe pesha e trupave të lartë, me nga një shkop në duar, në mesin e tyre - gra dardana -, lanë amfiteatrin dhe nisën një udhëtim biblik.

Ishin pellazgët h-y-j-n-o-r-ë të Homerit që, pasi kishin kënduar Këngën, sipas gjedhit të tyre parak,

largoheshin. Ata, që mbetën në shkallare, ndjenë se alfabeti i tyre u bë me më pak gërma. “E dashur mos vdis!” e h-y-j-n-o-r-ë-v-e këndohej: “Gjuhë mos vdis!”.

Jo kush e ka shkruar, kush e ka ngjizur dhe me ç’lëndë. Shkruesi mund të jetë murg kopjues me zhgun të zbërdhylur në mëngë e në bryla, a një student me xhinse të grisura në gjunjë, që ndjek natën në disko muzikë të zhurmshme metalike.

Kur është krijuar “E dashur mos vdis!”? - më pyet zëthi i brishtë i njeriut hedonistik të sotëm, strukur brenda meje. Në Ditët e Jetës së Njeriut, që janë Lotore (antike), i përgjigjem pa nerv.

Kaq e thjeshtë paska qënë (kjo dituri)? Jo aq e thjeshtë se ditët shembëllejnë me kraharorë të zgavëruar burrash, që brënda u ka rënë jeta. Zëthi hesht në plazmën e vet. Po të tregoj edhe pamjen e jetës. Ajo (jeta jonë) është si fytyrë me mise të prajtë femre, që e gëlltit hija e ditëve. I lidh dot fjalët “jetë” dhe “ditë”? Jo? Ditët lidhen me ne të dy, mbase vetëm me ty. Ndërsa jeta nuk e di me kë lidhet. Dëgjo një kuptim ose një lidhje të tyre. Jetë (natyrë) në ditët e njeriut. Kjo është lidhja ideale. Dëgjo edhe një pamje tjetër të kësaj lidhje. Në natyrë kanë rënë ditët (tona) si pllanga boje. Ne bëjmë sikur nuk i shikojmë pllangat. Dikur jeta (natyra) i ndërpret ditët tona. E dashur mos vdis! ka lindur si klithmë e njeriut të ndërprerë. Të gjitha pamjet e jetës dhe të metaforave janë eufemizmi i kësaj klithme të fshehur në shendin e ditëve. Midis

nesh, (zëthit hedonistik dhe krijuesit të tij, pra vetes time, që e quaj zanafillë) të strukur në 178 cm lartësi të lëvizëshme, kishte moskuptim. Prandaj ata njerëz të korit, që po rrallohen në shkallët e amfiteatrit, po kqyrr. Po kërkoj poetin, kush është poeti? më shtyn të pyes në mënyrë të këtilltë një mitologji bashkohore individualiste. "Poeti është i Treti, mes Njeriut të Përkohshëm - dhe njeriut të Përjetshëm", janë fjalë të krijuesit të zhdukur Moikom Zeqo. U bëra nga këto fjalë dëshirë, që grish kujtesën.

Një trumzë fluturash, një shoqëri zogjësh zbritën hijet e tyre mbi shkallët, ku kishte kënduar kori, dhe vetë s'ndaluan. Kjo çfaqje ishte një problem i vazhdueshëm për të errtin, (Heraklitin).

M'u kujtua një emër. Edhe ai kishte folur për: "E dashur mos vdis!" Ca çaste më parë ndërmenda fjalë të purpurta të tij. Ai kishte qënë në atë kor. E gjeta atë, që kishte mbrujtur dhe e lexova me zë, gjer në fund të saj.

Fjalët mbaruan, por fara e tyre më pllenoi gjallesa në tru.

Pastaj thashë, arrita në përfundim: Sipas poetit ("Kujtesë që ka marrë zjarr"), Moikom Zeqo, do të thotë edhe sipas Pablo Zgjohu Druvar Nerudës, që ka thënë: "E dashur mos vdis!"; do të thotë edhe sipas Uollt Fije Bari Uitmanit, që i këndoi trupit elektrik të mashkullit dhe të femrës; sipas poetit Moikom Zeqo do të thotë edhe sipas Naim Frashërit, që u dogj në

Qiririn e Fjalës; do të thotë edhe sipas Simfonisë së Nëntë të Bethovenit, që ka rënë si diell mbi netët; sipas poetit Moikom Zeqo do të thotë edhe: "Të dy brenda Vdekjes - do ta vdesim vetë vdekjen,- e dashur mos vdis!" (zanafilla nuk rrikthehet në zanafillë, mbetet e tillë, më thotë vetja); sipas poetit Moikom Zeqo do të thotë edhe sipas dhembjes së Pol Elyarit, që ia mori Galën e tij Salvador Dali; do të thotë edhe sipas erës së sotme, që sjell fantazmën e mbretit Hamlet të dëshmojë, domethënë të lahet dy herë në lumin e të errtit Shekspir; do të thotë edhe sipas lumit Vjosë si Migjen i kaltër, që është ngritur në qiell dhe kullon bula uji a fjalë të vagullta fatthënash; do të thotë edhe sipas "Helenës së Trojës që i shpiku Akejtë"; sipas poetit Moikom Zeqo do të thotë, që Moikom Zequa ka thithur burrnotin e Botës dhe ende s'tështin, (e mbrojnë fjalët, që i ka bërë vegulli); sipas poetit Moikom Zeqo do të thotë: fjalët më tepër se kuptim janë kuptimi i vegullive; do të thotë edhe: ritmi zanafillor, që ai e rrigjeti ia mban të lidhura fjalët.

E dashur mos vdis! është himn? S'ka asnjë unazë dashurie të shkuar në gishtin e thatë të himnit. Je cinike, me këtë cilësor, i shpalla luftën morale vetes. Po të kthehem te orgjina (jam e mbushur me orgjina), s'do të pranoja të isha himn. Si njeri bashkohor, po të them, se ti vetja ime, je një pjesëzë mohuese. Bashkohor...?

pse më jep pezm të ri. Poetin e ke dëgjuar kur thotë: "s'ka kohë të përbashkët"? E cyta veten të dali nga errësira e fjalëve të saj. Enkas i thashë: unë kam rreth meje bashkohësit, që thonë: "E dashur mos vdis!" është himn. Himn!? Himni është fundi..., heroi..., i rrethuari me mure. Në natyrë kanë rënë ditët (tona) si pllanga boje. Ajo, me gjithë motërzimet është Zanafillë, Njeriu i Parë. Se, Njeriu është gjithnjë Njeriu i Parë, që mban brenda në parzëm një Njeri dhe, të Dy, brenda jetëvdekjes - rikrijohen. Mbetja e tyre është një këngë e përgjithmonshme. Njeriut të Parë ka frikë se mos i vdes zoti në duar. Midis zotit dhe njeriut, që mban në parzëm njeriu, nuk ka ndryshim. E dashur mos vdis! mohon vetiu pa qëllim himnin, që s'e njeh dhe nxjerr zanafillën. Dëgjo fjalët e njeriut:

"Dhe mbase ky mermer - gëlon nga krimba - kufoma të dekompozuara, - po dashuria jo – e dashur mos vdis!"



INTERMEXO 1



E DASHUR MOS VDIS[1]

For evengthing that lives holq.
Lifedelights is life!
W.Blake

Se çdo gjallesë është e shenjtëruar.
Se jeta jetën gëzon!
U. Bllejk

Pikat e vesës – i mbledh nga gjethet lotoret antike, - ankthi i kozmosit i shpërthen – zemrat e luleve, - imazhet – parzmore të rreme – të realitetit të tmerrshëm, - këlthitës, - e dashur, mos vdis !

***

Ti hesht, - largohesh nga pasqyra, - por fytyra të mbetet aty, - duke vështruar me pikëllim – tërë ikjen tënde – në terrin e pakohshmërisë pakuptim, - e dashur, mos vdis !

***

Gishtat e tu të largët – zbresin mbi ballin tim – si ca këmbë të zbathura- engjëjsh të vegjël, - sa të lodhur janë, - sa të lehtë, - e dashur, mos vdis !

***

Ja pëllumbi – mbi ujërat e praruara të Jordanit, - zambakët në brigjet e Eufratit, - të emigruar nga Edeni, - shtrëngata florizgjuese të kambanave, - drurët e qitros – të ngrënë nga milingonat, - në shkretëtira lëviz – karvani i eshtrave dhe kafkave – dhe arna e Hënës – e qepur me fije shiu – e dashur, mos vdis !

---

1) *Varg i famshëm i Pablo Nerudës*

***

Hyn e del – zogu i orës në mur, - a thua është fallos-i i një hyu, - që nuk mbars asgjë ? – E dashur, mos vdis!

***

O, mbase – këto flutura të brishta, - kanë thundra dinozauri, - e dashur, mos vdis!

***

Dhe gjej leshterikë – e lakra deti – në bregun e Currilave, - mbas furtunave të kërleshura s- si mjekrën e Shën Onufrit, - ç'femër e mijëvjeçarëve – e dashuroi atë – dhe ai idioti i shenjtë – ju përgjërua shkretëtirës – plot akrepa, zvarranikë, halucinacione, - e dashur, - mos vdis!

***

Çdo vit vërtet ngjallet Krishti? – Më i sigurtë Sizifi, - e ngre sërish shkëmbin, - që rrokulliset – e dashur, mos vdis!

***

Dhe mbase ky mermer – gëlon nga krimba – kufomash të dekompozuara, - por dashuria jo! – E dashur, mos vdis!

***

Këtë blic fotoaparati – e kam temjanicë – të përkohshmërisë së ndalur, - e dashur, mos vdis!

***

Dhe ja, kërcen tek unë – një metaforë bretkosë, - por me kurorë princeshe – e dashur, mos vdis!

***

Pyjet të trishtuar – shohin karrigen – në bibliotekën time, - ke kohë, që s'je ulur aty, - dhe ca sharra të padukshme vërtiten, - e dashur, mos vdis!

***

Ajri – pluhur qeniesh, - njëmijë Buda janë ulur si në WC – te një Vrimë e Zezë – e universeve, - e dashur, mos vdis!

***

Duel i pa zë mes detit – dhe Hënës, - vijnë çdo çast – miliona të dashuruar, - kanë humbur parajsat e tyre, - në formë çamçakëzi, - blerë fare lirë, - në supermarketet – e Hiçit, - e dashur, mos vdis!

***

Dhe unë, - tani i thinjur, - dua të rilind – moshën e dikurshme – te uji i ri – i deteve deradianë, - e dashur, mos vdis!

***

Nga metali misterioz, fisnik, - që del nga zodiaku, - argjendarët e shpirtit – e bëjnë unazën tënde, - e dashur, mos vdis!

***

Dhe shfaqet mbretëria e luleve vajtuese - ç'trishtim të jesh Princi i Jaseminëve – e dashur, mos vdis!

***

Afërdita shkëputet nga statujat, - e ajërt si shpirti, - e dashur, mos vdis!

***

Rrëzim i Verbër i Vetmisë – nga sipërfaqet – në brendësitë, që s'dihen, - kafshë me fytyra kukullash – fijet e ylbereve – i mbledh çikriku i Diellit, - kronika e zezë e mediave – është tapeti i zyrës së Zotit, Zotit, - tunden drurët – eshtra të shtrëngatës – dhe dridhet – ndriçimi i semaforëve, - të ngjashëm me zogjtë e detit – e dashur, mos vdis!

***

Si ta festoj – datëlindjen e kësaj peme, - po të detit? – Drithërat plot brohoritje për Hënën, - po De Rada e ka braktisur – muzeun e myshkur – të Poezisë, - është çmendur vreshta – e hyut Pan, - por askush, askush s'shqetësohet për të, - në Tebë bëheshin blatime për Miqësinë, - në Rodos për Diellin, - në Eleusina për Tokën, - por në Currila për Dashurinë – e dashur, mos vdis !

***

Dhe deti e ëndërron – një vdekje prej agavie, - e dashur, mos vdis !

***

Kush flinte vallë – atë natë – nën pemën e madhe prej fosfori ? – E dashur, mos vdis !

***

Rrufeja mbledh – veglat e saj të zdrukthimit – mbi tryezat e reve, - mbi ujërat e shqetësuara, - mbi palmat – dhe trandafilat e egër, - në brigjet e koralizuara – të shkatërrimit dhe ëndjes, - kush do të ma bëjë – bibliotekën – arkivol – pezull në erëra ? – E dashur, mos vdis !

***

Poeti është i Treti, - mes Njeriut të Përkohshëm – dhe Njeriut të Përjetshëm, - digjen dallëndyshet në ajër – me mantelin e Kentaurit, - çdo i vdekur e kupton, - se absurdi i ekzistencës – është pluhur Hëne,

- dhe Zoti, Zoti e ç'bën, - e prapëson gjenezën e botës, - e dashur, mos vdis !

***

Princeshat ilire, - të hajthmet, - të kaltrat, copëtuar – nga shpatat romake – janë shndruar – në turtullesha shtrëngate, - vërtiten padukshëm, - ethshëm, - nxitimthi, - përherë në enigma, - në përtejhistori, - në çmeritje të shenjtë, - arsyeja përherë – përputhet me sendet, - po poezia i blatohet infinitit, - në çdo imtësi pa rëndësi, - e dashur, mos vdis !

***

Kanë mbetur gurët –
Hyjni, të braktisur
Nga hyjniteti !

Dhe Engjëjt e Hakmarrjes
Befas kthehen
Në flutura lulesh!

Dhe shpirtrat
gjejnë tani
Shtëpi në Internet,

Kanë mërguar
Trandafilat
Në trojet e metafizikës.

Qiriu i Naimit
I shpik
Agimet e Mëdha!

Mbaj tërë vdekjet,
(E atyre që desha)
Si qostekë e sahatë ari!

Po ti nuk je,
Si t'i shumëfishoj
Shqisat, - si ?

Po ti nuk je,
Si vallë
Të të trupëzoj,

Që nga mendimi,
Sërish ?
E dashur, mos vdis !
***

Nga gjoksi yt – kërcejnë dy pantera, - unë jam flija, - pa kundërshtim, - pa ngjethej, - e dashur, mos vdis !
***

Kapini mjellmat e zeza – të syve të mi, - kapini, kapini, - por kujdes, - sa t'i prekni – do të dëgjoni – Ardhjen e Dytë – të Krishtit Shpagues, - dhe Këngën e Fundit – të Mbarimit të Botës, - e dashur, mos vdis !
***

Ky zog – ikën para meje – në largësi infiniti, - psalm udhërrëfyes i Vdekjes, - e dashur, mos vdis !
***

Poezi, trupi im – shpirti yt – dhe asnjëherë – tabuti yt, - e dashur, mos vdis !
***

Jemi dy pemë, - përballë – shahu surrealist – i gjetheve tona – të shkulura, - vërtitet – në miliona lëvizje, - pa humbje, - pa fitore, - në tërë realitetet, - në çdo metafizikë, - ç'po luajnë kështu, - në humbëtira makthi ? – E dashur, mos vdis !
***

O, diktatura inteligjente e Kohës, - me 12 muaj – e 7 ditët e javës, - me një burokraci të paimagjinueshme – orësh dhe minutash, - saktësi indiferente, e ftohtë, - në përjetësi ciklike, - e dashur, mos vdis !
***

Te humnera – në largësi – humbet stuhia – si britma e një mbreti, - të rrëzuar nga froni, - e dashur, mos vdis !
***

Fjalët mund t'i them saktësisht – por s'kanë asnjë kuptim pa ty – e dashur, mos vdis !
***

Një burri me krah të prerë – i ndodhi çudia :, - hodhi tej protezën,

- e i doli një krah mjellme, - ky krah mjellme ishe ti, ishte ti, - e dashur, mos vdis !

***

Herakliti i Efesit, - i fshehur nën shtretërit e lumenjve – mezi i mban – pamjet e shumta të tij – se i ikin tej me vërtik, - pa kthim, pa kthim, - por pamjet e tua – mblidhen tek unë, - e dashur, mos vdis !

***

Me bebëza të Zotit, Zotit – të shoh ty – nga çdo qepallë pellgu, - e dashur, mos vdis !

***

Po të mos kishin emra – toka, era, sorkadhja, - gjiri i Currilave, ylli Orion, qyteti i Durrësit, -agavia, Milosao, detet, lumi i Drinit, - padyshim, padyshim, - do t'i quaja me emrin tënd, - e dashur, mos vdis !

***

Muzgu – shtëpi e artë, flurore, - ku të lodhurit e mëdhenj – kërkojnë prehje të vogël – tek ty, tek ty – unë kërkoj – prehjen e pafund, - e dashur, mos vdis !

***

Jemi lëndë e ëndërrave,
Lëvizje e një gjumi që s'mbaron ?

Sa aventura të erës,
Pax tibi, pax mundi[2)] !

Akujt zgjatin mbi det –
Anije fluturuese ëndrrash !

I kemi shpikur botët
E botët na ribëjnë ne !

Shtrëngatat – racë mbretërore
Na blatojnë në zgrip !

Fjalët – kulla argjenti
Me kuptimet – pëllumba të artë!

[2)] *Paqe ty, paqe botës (lat.)*

Me poezinë – nomatisje e shenjtë
E vonojmë mbarimin e botës!

S'mbajmë mend kur lindëm,
E dashur, mos vdis!

***

Këto doreza dyersh – i ngre lart si çadra shiu - ç'vajtime zotash na vërshojnë nga sipër? - E dashur, mos vdis !

***

Në Kohën Peshk ka vetëm zogj, - në Kohën Zog ka vetëm peshq, - në Kohën Dashuri – ka vetëm ne të dy, - ne të dy, ne të dy, - e dashur, mos vdis !

***

Vetëtima e mbetur mes drurëve – si thikë platini – mes fletëve të lexuara – të një libri profecish, - me të mund të vetëvritemi, - në një çast ne të dy, - sëbashku në jetë, - sëbashku në vdekje, - e dashur, mos vdis !

***

Dhe heshtën akiliane – të guximit të çmendur – unë e bëra për ty – direkun e Anijes së Metaforës, - e bëra bishtin e fshesës vigane – për të fshirë ndyrësitë e qytetërimit, - e dashur, mos vdis !

***

Ylli im, ylli im është i stërlodhur,
Ylli im, ylli im i zbehur nga streset
Big crunch[3)], fluturimi i shqiponjës –
Qarkullimi i gjakut në dejet e shekujve!

Insektet estete gllabërojnë gjithçka,
Shkatërrojnë Mbretërinë e së Bukurës,
Por ikonën tënde askush dot s'e ha,
As ikonoklastet kanibalë të urët.

Nga varrosja e klithmave tona të gjalla
Nën tokën indiferente të mardhur
U bënë mineralet e çmuara, të rralla,
Të pazbuluara ende të së Ardhmes!

[3)] *Kërcëllima e madhe (angl.)*

Ylli im, ylli im në infinit s'do të ecë,
Në mashtrutet tërthore, në rrugë të trilluara,
Por në zërin tënd e dashur si flesh
Do t'i shumëfishojë mistiket gjurma!

Dhe molekulat si mijtë elektronikë
Mblidhen në turma të mëdha në abys
Por luleshegat thonë mes shajnive prej frike:
- "Mos vdis e dashur, e dashur, mos vdis!"
***

Dhe guri i vockël – i pagjumësive të mia – u rrit dhe u bë Himalaja, - e dashur, mos vdis !
***

Këto peizazhe rrjedhin – në ullukun e Ëndërrës, - e dashur, mos vdis !
***

Balli im ka vesë amëshimi, - e dashur, mos vdis !
***

Një nuse prej toke – bëhet pjellore, - nga një burrë prej uji, - e dashur, mos vdis !
***

Duart e mia – janë popuj biblikë – që me trumbetat e gishtave – rrëzojnë muret e kundërshtimit, - të tabuve, - të ndalesave të hiçit, - muret e keqkuptimeve idiote, - të shpifjeve, të mplakjes, - e dashur, mos vdis !
***

Tani miliona kuaj – vrapojnë në pllaja – batica marramendëse – e mishit tim të gjallë – për tek ty, për tek ty, - e dashur, mos vdis !
***

O buzëqeshja pa buzë, - o shikimi pa sy, - o artikulime fjalësh pa gojë, - por jo pa ty, jo pa ty, - e dashur, mos vdis !
***

O pema e Edenit, - ku shartoj pemën e meridianëve, - e dashur, mos vdis !
***

Skilla dhe Karidba – në shahmatin e shekujve, - ku të tretët vdesin, - por jo ne të dy, jo ne të dy, - e dashur, mos vdis !

***

Mbledh tërë zërat e pulëbardhave – të bëj një statujë për ty, - dhe tërë lumenjtë t'i bëj sorkadhe për ty, - e dashur, mos vdis !

***

Në fotomontazhin e ëndërrave – fytyra tënde rri – mbi një qafë luani, a sfinksi - e dashur, mos vdis !

***

Përjetësia – makina e iluzionit – të pafund – s'na duhet, s'na duhet – e megjithatë, megjithatë – ndjemë dhe dëgjomë, - e dashur, mos vdis !

***

Nëse ti ikën – zogjtë kthehen në fluturim – si numërimi mbrapsh i orës – përroi i rikthehet burimit – e trenat, avionët, biçikletat – lëvizin sëprapthi - e dashur, mos vdis !

***

Gjysmëprania jote – plotësohet – nga gjysmëprania e muzgut, - nga gjysmëprania e Amëshimit, - e dashur, mos vdis !

***

E jam shpesh fëmi ilegal i librave të mi - e dashur, mos vdis !

***

Raketat zhurmërojnë në kupolën e qiellit – pistoleta minatorësh – për të çarë hapësira të reja – për ty, për ty, - e dashur, mos vdis !

***

Dhe bëj një matematikë – a algjebër dashurie – me numrat e shtëpive – të qytetit tim – për ty, për ty, - e dashur, mos vdis !

***

Kuaj lodre prej qelqi, - të thyeshëm – po u rrëzuat mbi strall, - nëse bëhemi mijra copëza, - do t'ju shndroj në rërë – dhe kështu mbi bregdet të Currilave – do të shëtis – si një hyjni – mbi krifat fantazmagorike – e trupat tuaj – prej lodre të gjithësisë dhe rastësisë – për të dashuria, për të mrekullia - e dashur, mos vdis !

***

Vrapojnë shkëmbejtë – heronj të plogët – të vargmalit Karmel – të eposit – të gjeografisë së mallkuar – të sakrificave për ty - e dashur, mos vdis !

***

Po e vesh – muzikën e drurëve – pulovër magjinë – të stinëve të reja, - e dashur, mos vdis !

***

Hidhem në boshllëkun, - që quhet e Ardhme, - krejt i sigurtë, - krejt i vetëdijshëm – për ty, për ty, - e dashur, mos vdis !

***

S'i kaloj dot fjalët – as idetë, - apo një vetvete të dytë – gjersa je ti, gjersa je ti, - e dashur, mos vdis !

***

Helena e Trojës – i shpiku akejtë, - Agamemnonin, Menelaun, Odiseun, Akilin – si Arti që i shpik – tërë realitetet e mundshme - e dashur, mos vdis !

***

Më ndjell – më grish në Vdekje – si deti në breg të Currilave – si vetë Dashuria – si vetë Rikrijimi i Madh - e dashur, mos vdis !

***

Era rrëzohet – pemë e prerë me sopatë – por jo ti, por jo ti, - e dashur, mos vdis !

***

Yjet – ameba – që dridhen – për ribërjen – e tërë gjallesave të mëdha - e dashur, mos vdis !

***

Kujtesa – është si të ngrohesh – me dritën e Hënës – mes acarit të së Tashmes – por ti mos u trishto, - ti mos ki frikë, - ji e qetë, - e sigurtë, - përvëluese, - e shumëngrohtë, - e dashur, mos vdis !

***

Unë do t'i gjej – e do t'i vras – tërë djajtë – në brigjet e errta – të Belfegarit – në brigjet e zymta – të Pandemoniumit - e dashur, mos vdis !

***

Njëmijë puthje – engjëj alabastri – fluturojnë – sipër pullazeve dhe epokave, - e dashur, mos vdis !

***

And every generated body – in its inward form – is a garden of delight – and a builing of magnificence[4)], - e dashur, mos vdis !

***

Poezia – fantazmagori e të Paarritshmes, - e dashur, mos vdis !

[4)] *Se çdo përtëritje e vetë krijesës – është një kopsht hareje – një ndërtesë e madhërishme (angl., vargje të W. Blake)*

***

Ulërij – si Nabukodonozori biblik – në funeralin – e të vërtetave të botës, - e dashur, mos vdis !

***

Elle est venue -, ujgne sur la blessure, - par cette ligne blanche[5)] - e dashur, mos vdis !

***

O trupi kozmogonik i gruas, - o madhështi përvëluese, - o dëlirësi e pavdekësisë, - o këngëzim orfeik i rrënjëve, i dejeve, - o seks ripërtëritës, - o magjepsje e pafundme e shqisave, - o tokë e Antarktidës plot kopshte lulesh në gji, - o plug mashkullor, i pashmangshëm – nga harliset e shpaloset në zenit gjithçka, - o shumëfishim i të vetmes – pa ngjashmëri, pa rutinë, - o sakrilegj i vetmive, - që nuk dinë bashkimin, - o gjethe të hipnotizuara nga hapësirat, - o gjarpërinj të padukshëm të çasteve, - të brengave dhe hidhërimeve tronditëse, - o definë peligrinë në labirintet e shpirtit, - o kujtesë e kaltërsisë të shpikur nga gjeneza, - o përmbytje si katarsi, - o përvëlim squfor i verdhë, - o Bukuri e Përgjumur – e ngritjes mengadalë nga thellësitë pa ëndrra, - o pyetje shpaguese për identitetin, - o ylberë të orgazmave, - po puthje – që thithin ajrin mistik – të shpirtrave, - o sferat e përmbysura – të metafizikave abstrakte, - o sterilitet mashtrues dhe virtual, - o kalimtarë të pafund, - që jeni vetëm një njeri i vetëm, - o nderime ndrydhëse të famës së kotë, - o Gjeniu i Dritës, - që ka brenda vehtes – Binjakun e Errësirës, - o himne të mbretërve të mëdhenj, - që i trashëgojnë – në të vërtetë – vetëm skllevërit, - o Tokë Qiellore, - ku e Shkuara – e Tashmja – është vetëm e Ardhme, - o net të pasqyrave, - ku siluetat kanë mësuar – të vetëndriçohen befasisht, - o princër të zgjedhur të Misterit, - o këmbëzbathur të sakrificave sublime, - o shpresëhumbur në acar, - drejt kryqtrandafilave – të rozenkracëve të zhdukur, - o shtretër – të kthyer në tryeza – të Eukaristisë së Njeriut, - o Maska Mortore – prej ari mikenas – o delta të shpërthimeve vertikale, - o agoni të plakjes pa qëllim, - o të jesh i bashkuar – dhe pa u takuar asnjëherë, - o shpërfillje, - o zikzake opiumi, - o rrënoja perandorish të mëdha, - o kromanjollë të kibernetikave, - o neandertalas të ekraneve, - o njeriu prehistorik me Shekspirin në duar, - o përpikmëri e Mbijetesës, - e dashur, mos vdis !

[5)] *Erdhi ajo – mjellmë mbi vuajtje – përmes horizontit të bardhë. (frëngj., vargje të René Char)*

***

E dashur, mos vdis, - e dashur, mos vdis, - e dashur, mos vdis !

***

Të dy brenda Vdekjes – do ta vdesim vetë Vdekjen, - e dashur, mos vdis !

Durrës 2004 – Tiranë 2005

NA DREJTOJNË PËRFYTYRIMET (FJALËT)

Pasqyrë pas "Ka frikë mos i vdes Zoti në duar"

Shestimi i përfytyrimeve është mpiksur në fjalë. Me fjalën shkojmë më tej se fjala, dalim nga kufijtë që janë shpallur në kuptimin e saj dhe gjendemi në zona të reja. Me fjalën ka ndodhur ajo, që ndodh me krijimin, ajo është një shterje e një ngopjeje të përfytyrimit. Prandaj ajo ka shtresa në mineralin e saj.

Përfytyrimi, që ndryn fjala, e cila rishfaqet me trajta të ndryshme të vetvetes, e vendos atë në rradhët e epërme të krijuesve të mëdhenj të metaforave. Fjala është Toka dhe Qielli i mendimit.

Me një kërc (fjalë) është krijuar një pemë përplot me përfytyrime. Brenda një çerdhe tingujsh është hapur vend për lëndën me veti dhe është synuar për të njësuar tingujt me natyrën, që kanë shkërbyer. Shkërbimi ka vlejtur si gramatika fillestare e pemës së fjalës. Po përfytyrimi mbetet përherë pa cak. Aq i madh është pushteti i këtij pacaku të papërshkruar, i lëndës, që ka mbetur jashtë tingujve të fjalës, sa shërbimi i fjalës ka lënë jashtë vetes një formë të tij, që e quan poezi, për të vijuar alkimizmin për zgjerimin e

qerthullit të fjalës.

Gjithmonë gërmohet në boshësinë ku s'ka shkelur fjala, megjithëse fjalët kanë hyrë në të gjitha hapsirat.

Kanë mbetur të lira hapësirat ndërthurëse midis fjalëve dhe pemëve të fjalëve dhe ajo, që ka mbetur jashtë përfytyrimit fillestar dhe të plotësuar.

Fjala "*kërc*" është shkërbim i tingujve të lëndës, që në vetvete nuk shprehin kuptim. Kuptimi është ndërtuar në përfytyrim si pranëvënie. Kërc-i është ai... që nxjerr tingujt k-ë-r-c. Pastaj fjala vijoi rrugën në përfytyrim, me pavarsinë, që ia dha gramatika dhe, rastësisht, u bë në kujtesë, pa djeninë e saj, ama e pemës së kërceve. Ajo grumbulloi rreth vetes të gjitha të ngjajshmet tingullore dhe u dha kuptime plotësuese rreth boshtit të këmbanës së saj. Pema e fjalëve është e plotë kur shteron pjesën e saj të natyrës gjë, që s'ndodh asnjëherë.

Në përfytyrimin e pemës së fjalës ka dije afërsisht të përpikta dhe dije të lira nga përpikëria. Dijet afërsisht të përpikta kanë bërthamë shkërbimin dhe më tej, plotësohen me rregullën e gramatikës, ndërsa dija e lirë nga përpikëria ka pikënisje metaforën e poezisë. Përbërsit e këtij rregulli janë të përkohshëm. Ajo që ka pikënisje metaforën, nesër do kthehet në rregull.

Fjala është dija e shqisave, që shëmbëllen me vegullinë e tingullit.

Fjala amë rastësisht është rastësore. Ajo para se të ndërtohej si fjalë ka qënë e shprehur nga lënda në

rrethanat e saj, me po ata tinguj, që u thadrua fjala. Ajo është e kushtëzuar nga tingujt, që ka shkërbyer, ndërsa pema e fjalëve, që rrjedh prej saj, udhëhiqet nga llogjika e përfytyrimit, e futur në rregullat e gramatikës, e cila është kujtesë e lëvizëshme e papërsosur.

Dikur përfytyrimi ishte më i harlisur dhe ka qenë zej mbizotrues. Edhe pas mijra vjetësh krijuesi i fjalës rron. Po ta hapim trupin e gjallë të fjalës, do gjejmë vetëm tinguj të natyrës dhe të psikikës, që edhe kjo e fundit është një përkthim më i lirë i natyrës.

Çdo fjalë e krijuar është e barasvlerëshme me një zbulim. Sot nuk ka krijues të mëdhenj, që të përafrohen me krijuesit e fjalës. Krijimi i fjalëve e shteri degën kryesore të përfytyrimit dhe e ktheu në kujtesë dhe përmbylli periudhën më krijuese të njeriut. Kujtesa me përfytyrimin nuk janë të njëjta dhe s'ndjejnë në mënyrë të njëllojtë. Kujtesa, mbas fiksimit të lëndës së saj, fillon të zbehet, ndërsa përfytyrimi në përsëritje futet në zona të reja për të shtuar vetveten. Sot jemi të dënuar me kujtesë dhe me pak përfytyrim dhe atë përfytyrim që kemi është përfytyrim i përfytyrimit.

Mendimet, ndijimet, ëndrrat përkthehen vetvetiu dhe menjëherë në fjalë, madje çastet e shfaqjes së tyre janë fjalë të fshehura, që i japin sinjalet me trajta të tjera. Pa u përkthyer në gjuhën e fjalës ato s'bëhen të kuptueshme nga mendimi, që gjendet dhe zhvillohet në fjalë. Nuk mund të zhvillohet një mendim pa fjalët, të cilat janë mendimet e paraardhësve në ligjërimin e

sotëm. Ne jemi të ndërtuar nga paraardhësit.

Fjalët janë kuptimet dhe me kuptimet e tyre është ndërtuar qenia jonë. Ato i kanë dhënë kuptime lëndës dhe na e drejtojnë jetën në hullitë e vjetra.

Askush s'dyshon te mosha e fjalëve. Në përdorim fjalët s'kanë moshë. Për ato besohet se janë të përjetëshme, ashtu siç duhet të ishin, në qoftë se do të kishte përputhje të përfytyrimit me lëndën që emërtojnë, të mos vepronin fuqi të jashtme, që ta prishnin përputhjen dhe, psikika të ishte e pandikueshme. Megjithëse na drejtojnë paraardhësit, që na dhanë fjalët, ne s'i njohim ata dhe kurrë s'na shkon ndërmend t'i njohim.

Fjala në përdorim s'ka paraardhës, domethënë s'ka kohë. Përdorimi i fjalës s'e njeh kohën, që i është dhënë, se fjala ka vetëm mënyrë shfaqje, megjithëse është kujtesë, e cila është veti e lëndës, por jo kohë.

Edhe kur kumton diçka të mëparëshme, fjala zgjidhet menjëherë nga kumti si fjalë e paraardhësve dhe kthehet në rolin përdorues, pra në jetë, ku s'ka kohë. Fjala e ka këtë veti të trashguar nga lënda që përshkruan, e cila nuk e njeh kohën. Edhe tingujt dhe tingujt psikik, që janë estetika e fjalës, s'e njohin kohën. Kohën e pranon vetëm mendimi, edhe ai, për lehtësi përdorimi, në rrethana.

Nëqoftëse paraardhësit, kohët gramatikore do ti kishin emërtuar ndryshe, ne s'do ti njihnim ato, se do të përdornim masa të tjera.

S'mund të ndodhin ndryshime në mendim pa ndryshuar kuptimet e para të fjalëve. Fjala u krijua për të ruajtur përfytyrimin që po lindëte. Në marrdhënie me lëndën fjala është metaforë e lirë. Fjalorët, kuptimet rrjedhëse të fjalës, i shënojnë si të mbartura, por edhe kuptimi i parë i fjalës është në vartësi të lëndës pra, është i mbartur. Fjalët janë mbartje të mbartjes dhe, kuptimet e tyre, cilësi të lëndës të shkërbyer.

Hapësirat e kuptimeve janë të kontrrolluara nga hapësirat e fjalëve.

Të jesh i lirë duhet të kesh qartësinë për të parë edhe brenda në fjalë mure, të cilët, duke u kaluar, krijojnë sintaksën e fshehur në fjalë dhe kuptim të cunguar.

Fjala është ngrehinë me mure tingujsh (parashtesash, rrënjësh, prapashtesash, shquarsisë, mbaresash, rrokjeve, rasash, kuptimesh parake, dyzanoresh (kufi fjalësh), etj).

Këto mure të njëpasnjëshëm i kaluan paraardhësit tanë dhe ne tani pothuajse nuk i shikojmë, se ata vunë një regull në kaosin e tingujve, të cilat i vërrejmë si mrrekulli të pakuptueshme ose edhe si monedha të përdorëshme. Paraardhësit nuk e lanë të shkruar formulën e strukturës së fjalës, veçse në shumë raste ajo është e gdhëndur në skeletin e fjalës dhe me një lloj tejqyre mund të pikaset.

Fjalët kanë energjinë e tingujeve natyrorë dhe energjinë që u kemi dhënë me psikikë. Gramatika

bën rregullimin e energjive të tingujve të fjalës dhe të fjalës dhe kthehet në trase për të kaluar energjia e përgjithëshme e mendimit. Kalon s'do të thotë pa pengesa. Ecim mbi vetveten kudo që të ndodhet ajo. Ecja është e brendëshme për aq sa është në qenien me rrjet të përsosur fjalësh.

Zhvillimi s'përputhet me qenien. Qenia, ka gjasa, zhvillimin s'e ka patur asnjëherë brenda vetes.

Zhvillimi është teknikë mbi të cilën vepron vjetërimi, është nevojë e qenies së ndërprerë, jo qenie. Qenia është përsëritje e paqëllimtë e rrethit të saj, që nuk e njeh vjetërimin.

Fjala, që prej zanafillës, ka qënë muzikë natyrore dhe psikike, ka qënë gura që mbush kujtesën me përfytyrime për të ecur në qenie, ka qënë lënda e lojës së zgjuar të gramatikës, pa mbetje të dëmshme. Fjala nuk njeh fitues dhe humbës dhe ka mbetur e vetmja pasuri e patundëshme e përbashkët për gjithë njerëzimin, pa përjashtime.

Shpërndarja e saj është e lirë, mund të marrësh aq sa ke nevojë dhe, s'pakësohet kurrë. Cilësia e saj në marrje mund të jetë e barabartë për të gjithë, ndërsa në dhënie, jo të gjithë ia ruajnë cilësinë dhe janë të përzgjedhur ata, që ia shtojnë vetitë. Cilësia e ligjërimit të fjalëve në dhënie, është e lidhur me fuqinë e subjektivitetit përfytyrues për pemët nga kanë zbritur fjalët, të ndërthurura edhe me tinguj psikikë (estetikë).

Njerëzorja ka një histori të saj, që gjendet te

pema e gjelbërt e fjalës, e fjalës në gramatikë dhe po aq, jashtë saj. Guri, hekuri, makina janë histori të fjalës. Me fjalën u njëjtësuam ne fjalëshprehsit. Njeri dhe fjalë janë përkthime besnike të thelbeve të tyre.

Fjala s'ka një të kremte, ku simbolikisht të përsiatet, për ta rinisur jetën nga ajo, me një qëndrim të ri, por mbase një e kremte e fjalës do të ishte pa kuptim, pasi ajo është e plotëfuqishme dhe e pandashme brenda të njëjtës qenie. Fjala ka mbetur shërbyese duke qënë krijuese. Jemi nginjur me fjalën dhe vetëm e riprodhojmë si send përdorimi e megjithatë, na drejtojnë paraardhësit, që çdo fjalë të re e kishin një zbulim në qenie, rrjedhimisht kishte vend edhe për një të kremte të saj kalimtare



TRE UNGJILLORË TË POEZISË

Kanë ardhur tre ungjillorë... Rreshpja, Zeqo dhe Kacalidha.

Një brez pasardhës po s'e vrau... brezin paraardhës nuk shugurohet si brez pasardhës.

Rreshpja, e kërkonte brezin paraardhës, për ta vrarë, në zanafillë të poezisë shqipe. Ai, me dhembjen e tij të kristaltë, kapërxeu kangjelet e De Radës dhe u bë Rreshpja.

Moikomi, për t'u bërë e ardhme kohën, më e saktë do ishte, për t'u bërë e shkuar, se atje janë strehuar të mëdhenjtë, e ka kërkuar dhe ende e kërkon me këmbëngulje brezin paraardhës, për ta vrarë, në bashkohësi.

Paraardhësi i Kacalidhës ka qënë kozmolirika, ai e ka vrarë kozmolirikën me surealizmin e tij. Liriku i lindur s'vret dot, por poeti e ka të domozdoshme të vrasë mësuesin për t'a rigjallëruar lirizmin e tij.

Të tre ungjillorët i kanë brenda vetes të vrarët, që janë bërë zëri i dytë i tyre.

F. Rreshpja, me shenjtërinë e tij, ka ndikuar edhe mbi dy ungjillorët e tjerë.

Moikomi, rravgon si akademik mistik pranë

shenjtërisë së Rreshpjes.

N. Kacalidha, pranë shenjtërisë së Rreshpjes, ngron vezët e zanafillës.

Poezia e tre ungjillorëve ka këndvështrime të brendshme. Ajo ka pajtuar utopitë (e tyre) me një realitet dhe ka krijuar vetveten.

Këndvështrimi i brendshëm është risi e poezisë. Risitë kthehen në ligjërime.

Të tre ungjillorët kanë ligjërimet e tyre.

Shpesh, kritika s'i kap e s'i hap dot ligjërimet, se ato janë shumë hapa para saj. Ato presin një ditë t'u çelen zërat e fjalëve.

Për fenomenin Rreshpja, lexuesi ka ushtruar trysni mbi kritikën. U desh të kalonte një brez, që të kuptohej Rreshpja.

Për fenomenin Moikom, kritika sqimatare dhe lexuesit përzgjedhës kanë ushtruar trysni mbi kritikën dhe lexuesin e plogët. Pasi kaloi një brez, Moikomi ka filluar të kuptohet.

Për fenomenin Kacalidha, kritika ka qënë e vakët. Lexuesit përzgjedhës ushtrojnë trysni mbi kritikën për t'a bërë me shqisa. Ende Kacalidha s'është kuptuar ç'i ka sjellë kozmolirikës sonë. Ndërsa në Greqi është i vlerësuar si poet lirik i veçantë i saj.

Kritika, për tre ungjillorët, do të mbetet përherë në borxh. Për Moikomin borxhi do ritet.

Midis kujtesës dhe kujtesës krijuese, çmohet kujtesa krijuese, sepse është e lidhur me kodet e

fshehta të krijimit. Ajo e ushqen me trajta kujtesën dialoguese të unit estetik. Çdo kujtesë krijuese buron nga një kujtesë psikike e cila është ama e estetikës.

Te Rreshpja, kujtesa krijuese është e lidhur me kodet e dhimbjes. Kodet e dhimbjes janë në poezitë e Rreshpjes. Kodet e dëlirësimit, që përjeton lexuesi, janë perceptim shoqëror. Ato, Rreshpja, s'i ka përfillur.

Te Moikomi, kujtesa krijuese është e lidhur me kodet e pazbuluara të kohës. Ai operon gungat e kohës dhe merr hua kohë për kohën e tij. E sotmja (e tij) është nerv i së përjetshmes.

Te Kacalidha, kujtesa krijuese është e lidhur me kozmolirikën.

Në ngazëllimin e shndërrimit kozmolirik sython lumturia me paqe, që s'e njeh rekuiemin. Revolucioni i kozmolirikës s'ka pikë mbërritje prandaj është evolucion i përhershëm.

Edhe Rreshpja është kozmolirik, sepse ai ka kodet e estetikës së dhembjes, që janë qenie të ndjeshme ikumenike.

Kozmolirika është një nga degët e pemës filozofike të njeriut e shtypur nga muzat e luftës.

Nga tre ungjillorët, Kacalidha e përfaqson më plotë kozmolirikën.

Moikomi është poet qytetar i klasit të parë. Ai është edhe më tepër se poet qytetar, ai është poet i qytetërimeve.

Të tre ungjillorët, kanë vetëdije për talentin.

Ligjërimet e tyre janë prova.

Të tre ungjijtë janë shkruar nga muza e dhimbjes, e kohës dhe e kozmolirikës. Ata janë ungjij paganë, po një degë e tyre është ngjyer në gjakun e Krishtit.

Të tre janë të lidhur me të veçantat e tyre. Dhembja është një peshë mbi një kohë, koha është një ëndërr mbi një dhimbje dhe kozmolirika është një gjendje, që duhet të vijë mbi një dhimbje dhe mbi një kohë.

Ungjillori Rreshpja ka lindur me shenjën e dhimbjes. Dhimbja i ka përcaktuar figurën. Gjithë shenjat e poezisë i ka vënë në shërbim të saj. Kodet e dhimbjes i kemi të lindura dhe rrugët e dhimbjes janë të njohura. Dhimbja është një kozmos. Por jo një kozmos i mundur. Këtë e thotë ungjilli sipas Rreshpjes. Këtij ungjilli duket sikur i është dhënë për të shprehur pjesën, jo të tërën. Atij i është dhënë plaga e trupit për të ndërtuar trupin. Ai është ungjilli i dhimbjes (së plagëve).

Ungjillorit Moikom, ritmi i kohëve i përcakton dendurinë dhe cilësinë e figurës, e cila është fantafigurë,

Fantastika e lidh me alkimistët, shkenca e lidh me qytetërimet, por kodet e kohës janë kyçur. Kjo është një poetikë utopike ose poetikë e dëlirë. Ne shkojmë te koha si fli të saj. Kodi i kohës është më mistiku, këtë e thotë ungjilli sipas Moikomit. Koha dhe qytetërimet i kanë dhënë cilësitë e veta ungjillit sipas Moikomit. Tani ai është bërë një pllakë kujtese. Ai shkon te pjesa (hollësia) nëpërmjet së tërrës. Ai është ungjilli i të

tërrësishmes për të ruajtur kujtesën.

Ungjillori Kacalidha, rizbulon zanafillën e kozmolirikës si rend i harmonisë muzikale të fjalës. Çdo poezi e tij është një pemë fjalësh të përafërta. Përafëria e fjalëve dhe, pas tyre qëndrojnë përafëritë e dukurive, është një mënyrë bashkëjetese. Ende harmonia e mendimit s'e ka ngritur kozmogoninë e vet. Ungjilli, sipas Kacalidhës, është më i brishti, por ai thotë një të vërtetë, që s'e gjen te ungjijtë e tjerë. E ka thënë duke mos e thënë shprehimisht dhe ky është nervi i fuqisë së këtij ungjilli.

Kozmolirika ka qënë një herë, kur shkërbente pemën e fjalës, ciklet e natyrës dhe urtësinë. Ajo është e përjetëshme.

Pastaj erdhën kodet e dhimbjes dhe mëpastaj, kodet e kyçura të kohës.

Në emër të Rreshpjes, të Moikomit dhe Kacalidhës, sipas ungjijve të tyre, po vjen ungjilli i katërt.

PLAGOSJA E KUJTESËS

Në fillim të qershorit (2016), Moikom Zeqo më dërgoi librin me poezi "Plagosja e Kujtesës".

Një vit më parë më kishte dërguar "Miscellanea 10", për të cilin më thoshte: " Është libri im i jetës... formuar në 25 vjet, 1990-2015".

Brenda këtyre 25 vjetëve, Moikomi ka shkruar edhe dhjetëra libra, krahës "Miscellanea 10".

Turbull kam ndjerë pse ai më thoshte se 10- ta është Libri i Tij i Jetës.

Arsyeja s'mund të jetë koha e gjatë e ngjizjes.

Ka edhe libra të tjerë që i ka strukturuar për një kohë edhe më të gjatë, por mendoj se në këtë libër me poezi në formë strofike katërshe ka derdhur mendim vetjak modern por dhe të brishtë dhe, surealizmit dhe pindarizmit të figurës i ka dhënë pamje moikomjane brenda një disipline më spartane të strofës.

Ka ndërthurur klasiken me modernen brenda një shpirti që i operon kohërat.

Edhe rimat dhe asonancat ndonjëherë na japin nostalgji, se ato dikur ishin pjesë e muzikës së simetrisë. Qenia jonë nisi në parahistori dhe është e ndërtuar me

çdo të kaluar.

Tjetër arsye mund të jetë edhe se "Miscellanea 10" është shumë *shqiptare,* nga ndërkallja e detajeve që lidhen me kombin. Poeti fluturon shumë lartë për të rënë në zemër të lexuesit..

Ndoshta, për këto arsye ai më thoshte se "Miscellanea 10" është libri im i jetës.

Përsëri e theksoj një ndoshta të ndrojtur, sepse arsyet që e lidhin më tepër poetin me një nga librat e tij janë të padukshme.

Për poezinë e Moikomit, nga njeri libër në tjetrin, s'mund të flasësh për forcim të stilit, për rrokje të temave të reja, për modernitet. Moikomi, që në zanafillë të poezisë së tij, i ka patur këto cilësi dhe s'mund të flitet për 'to si vlera të fituara vit pas viti nga përvoja.

Mund të flitet për pamje të reja të të njëjtit stil. E vetmja përkryerje e kësaj mënyre të shkruari është shtimi i befasisë së figurës dhe i sintezës së saj.

Moikomi është një rymë më vete për plazmimin e figurës. Figura e tij është e ngjashme me shpërthimin e fuqishëm të mendimit me dije shkencore dhe me alkimi poetike.

Askush s'e mban mend kur Moikomi u kulturua, kur u bë erudit, kur u bë personalitet, kur u bë biblioteka më e madhe e gjallë e kujtesës shqiptare, kur u bë poet i madh. Ai sikur ka lindur me këto cilësi.

Duke lexuar "Plagosja e Kujtesës", të shkruar në pjesën më të madhe në dy vite, 1992-1993, vërrejta

diçka që s'e kisha pikasur më parë. Poezitë e këtij libri më shembëllyen me fluturat.

Për fluturat sikur ka në ajër enkas gropa pa ajër. Dhe, në çdo rënie në këto gropa ato sikur futen në një ngërç, por në dalje bëhen të hareshme.

Poezia e Moikomit, në këtë libër, më shembëllen me fluturimin e ndërlikuar me dy kohë të ndryshme të fluturës. Njera kohë është vija lineare e poezisë (fluturimi i fluturës), tjetra përftohet kur mbaron çdo strofë imazh (*ngërçi* i fluturës). Të dyja kohët kanë edhe mekanizmat e tyre mbështetëse.

Një figurë surealiste ka edhe një *vdekje* brënda në shtëpinë e saj.

Në poezinë e Moikomit, për të vajtur te strofa pasardhëse duhet ta fikësh habinë që të ka ndodhur brenda strofës së mëparshme imazh, sepse figura e fortë që gjendet atje mbyll një cikël të menduari dhe të përfytyruari dhe është pengesë e ëmbël për të hyrë në imazhin tjetër.

Shpërthimi i figurave në psikikë lë pas një *plojë.* Duhet prap një kohë ta marësh veten dhe të rilidhësh pjesët. Këtë iluzion e përforcojnë edhe kohët e ndryshme që plazmohen brenda të njetës poezi.

Logjika poetike e Moikomit është eklektike. Ai e përzgjedh kohën për përdorim poetik, që të mos jetë lineare dhe e një çasti, që ajo të jetë në zenit dhe, atje gjithnjë bën vapë nga zjarri i figurave; përzgjedh kohët si të barasvlershme me historinë, por ato duhet

të kenë mbetur emnesë në kujtesë, që të përdoren për një etikë pozitive; përzgjedh edhe imazhet si mitra në ethje që të lindin figura si fëmijë të shëndetshëm me të dhëna të jashtëzakonshme. Të tria këto përzgjedhje ai i mbledh në një, në një mendim eklektik, që i elektrizon të gjitha strofat.

Te Moikomi çdo strofë është edhe një njësi më vete. Atje mbyllet një mendim, një imazh dhe shpërthen një figurë. Janë tre njësi të pandara brenda strofës së Moikomit. Dominante në këtë poezi është figura.

Duket sikur figura e Moikomit është bijë e shkencës pozitiviste. Brenda kësaj poezie ka edhe detaje biblike, por ato janë pjesë të nënrenditura të etikës, sepse prej tyre synohet një efekt estetik.

Në psikikë, ku bëhet lidhja e të jashtmes me të brendshmen zanafillore, kjo poezi ushtron trysni me figurën. Është një pamje e dualitetit shpirt i gjithëkoshëm – shkencë e re.

Estetika e Moikomit nuk ka atdhe ose ka atë atdhe që i jep më shumë mundësi të shprehet bukur.

Çastin poetik, që hap ose përmbyll poezinë, përgjithsisht e sjell nga kohët historike. Ky çast nuk rron kurrë në vetmi. Brenda këtij çasti ai sjell me shumicë kohë të tjera. Poezia e Moikomit pëlcet nga kohët dhe nga figurat e historisë. Çastit i jep sivëllezër të panumërt të shpërndarë në të kaluarën, por edhe në të sotmen dhe, jo rrallë, edhe në të ardhmen. Ndiesh si në një çfaqje të kohëve. Kjo mënyrë e të përdoururit

të kohës është edhe një mënyrë zhbërje, për të lënë në jetë përfaqsuesen e saj biologjike, kujtesën, që është nënë e idesë së kohës.

Çka thashë më lartë, është iluzioni im, të cilin e përftova nga "Plagosja e Kujtesës", ngaqë poezitë e saj, në fillim, i përqasa pak turbullt me fluturat.

Moikomi ka mijëra faqe poezi dhe disa herë më tepër se sa aq metafora. Ka ardhur koha që ai të përzgjedh nga ky korpus i pashembëllt Miscellanea - n e Miscellanea – ve të tij.

Brenda katedrales poetike, duhet të ketë edhe një kishë të ngjashme me ndërtesën peshkopale, me ikonat më përfaqsuese të saj, për besimtarët e poezisë, ku të meshojë një prift pasionant që ndjen fuqishëm eklisirin e jetës dhe thimjamin e amshimit.

Mbase është detyrë edhe e studiuesve ta kryejnë këtë punë, si një rast të veçantë.

Moikomi shpesh citon me adhurim dhe me habi Mallarme-në: "Gjithçka në botë ekziston për t'u derdhur në një libër".

Ndërsa Kavafi, nga përvoja e tij krijuese dhe nga praktika askete e botimit (s'nxorri asnjë libër), mund të thoshte : " Libri nuk mund të shkruhet (kurrë!), ose: Libri është një qenie që s'e njohim. Njohim vetëm pjesë të qenies, jo librin e qenies.

Atëherë, të bëjmë përpjekje për të shkruar një libër dhe ta lëmë në hije Kavafin si një përjashtim të një të menduari të skajshëm.

Por është e kuptueshme, edhe Mallarme – ja, edhe Kavafi, tërthorazi thonë të njejtin mendim. A është e mundur që bota me qenie të derdhet në një libër? Gjithë problemi është qenia që nuk mblidhet dot nga njeriu.

Libri për të cilin fliste Mallarme është i shkruar nga të gjithë, në të gjitha kohërat, ndonëse jo i plotë, se i mungon kapitulli: *gjeneza e qenies*, pa të cilin s'mund të vijosh një libër për botën.

Tani pritet që gjithë dija e derisotme për qenien të futet në një libër. Çfarë do të jetë ai libër: Poezi, roman, shkencë, bibël, një lloj i ri? Askush s'e thotë dot. Çdo gjini ka muret e vetvetes. A pritet Godoja të na e sjellë librin?

Nuk jam i dhënë pas mendimit parashikus.

Moikomi ka kohë që e ka filluar punën për Librin... sipas Mallarme – së, si përzgjedhës i një pjese të lëndës së pafundme të dijes njerëzore.

Mbase edhe të tjerë po e shkruajnë librin e dëshiruar nga Mallarme.

Dikush nga ata po studion metaforën moikomiane për ta futur në Libër. Kë do zgjedhë: Tipin e saj apo një metaforë të veçantë? Asgjë s'dimë.

TE MOIKOMI KOHA LULËZON ÇASTI VDES

Moikom Zeqo poetikisht qëndron i varur te Çasti i Madh, – te Koha dhe te rimishërimi i Pitagorës.

Te një aksident në gjykim, siç është koha dhe te një ringjallje e pjesës së lehtë, siç është shpirti i rimishëruar pitagorian, ka mbështetur të dy mekanizmat e tij poetikë.

Ka vënë në lëvizje dialektikën e çastit nëpërmjet kohës së amshuar. Kjo është një rrugë shumë e vështirë poetike.

Është e njohur që Moikomi është poet i jashtëzakonshëm i referencave historike. Ato i ka bërë vetëdije kulturore. Referencat, të futura brenda guackës së figurës, i ka hedhur si çaste të ndritshme mbi kanavacën e errët të kohës. Si rastësi të menduara, ato ndihmojnë për të të bashkuar me idenë e një çasti.

Të qenit brenda një çasti ka shumë rëndësi për t'a ndjerë një poezi. Brenda një çasti është e barabartë më së paku me thithjen e avullit poetik, i cili ka të tretur disa përbërës në ajrin e tij të lehtë. Por Moikomi brenda një poezie ka shumë çaste që vihen në një unitet, pikërisht nga avulli poetik me të cilin i mbështjell.

Moikomi çastin e flijon për kohën. Ai psikolo-

gjikisht nuk e njeh çastin. Psikologjikisht nuk e njeh dhe kohën. Kohën e njeh kulturalisht, ndërsa çastin nuk e njeh as kulturalisht, se thamë që atë e flijon për kohën, por duhet saktësuar se e flijon për kohën kulturore dhe, koha kulturore është një kulm që vjen rrallë dhe, në urnën e saj ka pafundësi çastesh të flijuar.

Poezia e Moikomit është urnë e çasteve dhe jetë e kohës. Iluzioni i jetës së kohës që jep Moikomi është i habitshëm. Gjithëçka historike e bën kohë që s'vdes. Një metaforë e këndell kohën, e kthen nga amshimi i zbehtë.

Për çastin dhe poezinë, që rrjedh prej tij, duhet një kuptim tjetër, që ta godasë jeta jo kultura.

Moikomin e godet së brendëshmi dituria. Moikomi ka kujtesë, por s'ka çaste. Çastet e tij janë dituritë.

Ato janë çaste në kujtesë, jo para shqisave. Ai shikon me kujtesën. Çastet i lë si mbetje nën napën e diturisë. Duke e flijuar çastin për kohën ai bëhet artist jakobin, për të ardhmen e flijon të sotmen. Por edhe për të djeshmen e flijon të sotmen. Por i gjithë ky flijim i të sotmes është strategji poetike. Për poezinë s'ka kuptim lidhja vetëm me të sotmen, kuptim ka që ajo të jetë në çdo të sotme.

Moikomi të ashtuquajturën kohë e sotme nuk e ka, ai ka të ashtuquajturat të shkuar dhe të pritshme.

Askush s'e ka të shkuarën dhe të pritshmen, ndërsa Moikomi i përdor ato si të ishin eshkë që ndizet nga fjala e tij. Kujtesa te Moikomi rritet, shqisat tulaten,

mekanizmi poetik punon. Dy skajet e papranishme i përdor si pasqyra për të sotmen. Në vetvete e sotmja e Moikomit është e zbehtë, ajo i harxhon energjitë për të kaluarën dhe të pritshmen dhe rron duke thithur energjitë e tyre. Rron me mushtin e dy pemëve që s'janë. E sotmja është njeriu me çaste të vdekur dhe me kohë të gjallë në shpirt, njeriu që gjithënjë mbeti paradoks i pakuptueshëm. Kështu rron një shpirt i vjetër i rimishëruar në një trup të ri. E sotmja, në njërin kah shikohet në të kaluarën, në kahun tjetër, në të ardhmen. Ky paradoks i pakuptueshëm ngjan tmerrësisht dhe besnikërisht me Moikomin poet.

Ky synim është më shumë i vetvetishëm se sa i ndërgjegjshëm. Zemra e mekanizmit kohor te Moikomi është dega e shkuar e kohës, ajo është edhe më e përdorshmja. E sotmja është një pikë mbështetse.

Dialektika në këtë poezi është e zevendësuar me eklektizmin, por mekanizmat i punojnë nëpërmjet sintezave të cilat mpiksen në figurë.

Sipas ligjeve të brendshme të figurës, metaforat janë të zhveshura nga koha. Ato janë përkthime të brendshme të imazheve që lindin së bashku me fjalën. Imazhet s'kanë kohë, kohën e kanë vetëm në subjektivitet që edhe ai kërkon të përkthehet, që të bëhet shoqëror. Këtu poeti me mendimtarin krijojnë krisjen e parë. Figura vjen të bëjë një plojë poetike, të vrasë pamjen e së përditëshmes të rëndomtë lodhëse dhe të ringjalli kohën e bukur. Figurës i hiqet koha

dhe i shtohet koha e bukurisë së përjetëshme. Por dihet, koha e përjetëshme është një titull i zbrazur, se e përjetëshmja shfaqet nëpërmjet çastit. Prandaj poeti loz me mendimtarin, i jep një gjë që s'është. Ai e di që figura ka vetëm bukuri. Figura është një zgjuarësi sipërane, një ekonomizim fjalësh si një formulë shkencore Ajo ka lënë jashtë gjithçka të tepërt.

Bukuria është jokohore dhe shfaqet befas si shpërthim. Shpërthimi buron prej instinktit, por instinktin e kullon kultura që të mos jetë i breshtë.

Kemi thënë diçka që lidhet me personalitetin poetik të Moikomit: Instinktin e tij e kullon kultura që të mos jetë i breshtë.

Edhe diçka shtesë: Moikomi mrrekullohet shpejtë. Psikika e tij është e hapur për mrrekullinë. Gjithë rrjedhën e mrrekullimit ai e përkthen në metaforë. Është përkthimi i poetit, më i rëndësishëmi përkthim, që nuk është zej se është brenda njeriut, është natyral. Poeti përkthen vetveten me ndihmën e kohës. Poeti është në thelb poet për përkthimin e brendshëm. Pjesa tjetër është pajtimi i këtij përkthimi të brendshëm me një strukturë gjuhësore (shoqërore). Ç'farë merr nga koha dhe ç'farë i lë kohës kalon nga subjektiviteti i tij. Një poet i madh është edhe përkthyes i madh. Edhe lexuesit amtarë e përkthejnë poetin, por edhe ky përkthim është natyral, përkthyesit e një gjuhe tjetër e kanë përkthimin zej.

Moikomi ka kultin e figurës. Asaj i beson më

shumë se sa poezisë. Poezia për të janë 12 apostujt.

Figura është Krishti, që i udhëheq ata me dritën qiellore ose me dritën e së ardhmes. Për Krishtin Moikomi i flijon të 12 apostujt. Le t'i quajmë 12 apostujtë 12 përbërsit e poezisë. Me më shumë dhimbje do të flijonte Gjonin, sepse e quan të një gjaku poetik me të vetin. Të dy, përfytyrimin e kanë të harlisur, dhe më tej se aq. Gjoni ka edhe grimca rimishërimi. Një arsye shtesë për t'a quajtur të një gjaku. Dhe, të dy, janë dishepuj, por me mjeshtra të ndryshëm. Madje Moikomi ka dy mjeshtra, Kohën edhe Rimishërimin pitagorian. Brenda Kohës ka gjetur edhe Mjeshtrin e Gjonit, por atë e ka vetëm një shëmbëllim të bukur, e ka një nga shembujt e mekanizmit të tij të dytë poetik, jo mjeshtër të tij. Edhe brenda Pitagorës e ka gjetur mjeshtrin e Gjonit.

Figura e Moikomit kërkon të pamundurën, atë që mund ta bëjë vetëm Shpëtimtari. Moikomi ka marrë detyrën e shpëtimtarit të figurës. Figura e Moikomit sikur del nga një zonë industriale pa tym. Kjo zonë ka qënë në të gjitha periudhat, pavarësisht nga të thirrurit e saj: mitologji, fe, filozofi, mistikë, shkencë, art.

Kjo zonë ka një fjalë përmbledhëse, dituri. Kjo është zona e poetikës industriale të Moikomit, e cila gjendet në të gjitha qytetërimet.

Për Moikomin nuk ka kuptim të shprehurit për kohën në të shkuarën, për atë, gjithëçka që ka ndodhur, është ende e pranishme. Ai e përdor të kaluarën sikur

është ende, po këtë vështrim ka edhe për të ardhmen.

Ky vështrim është në pajtim me mekanizmin e dytë poetik të tij, por nuk është në hullinë e kohës heraklitane.

Si zbulim figura është asnjanjëse, si asnjanjëse ajo i përngjason shkencës. Shkenca i përngjason natyrës. Natyra është nevojë për qenien. Shkenca është pjesa e natyrës së zbuluar. Gjer këtu mund të mbërrijmë me mendim. Metafora si zbulim buron nga të menduarit shkencor, të menduarit shkencor degë kryesore ka dobishmërinë. Me këtë mendim krijohet një përplasje e rrëshqitshme, por metafora mbetet si zbulim që buron nga të menduarit shkencor i poetit. Metafora në të ardhmen bëhet shkencë. Ajo është zbulim dhe përgjithësim, pa kohë dhe pa vend. Metafora e rrethuar nga fjalët e rrethanave të saj krijon art.

Duke e kuptuar figurën si asnjanjësi, në fakt, e lidhim fshehtas me të përjetëshmen, me një eufemizëm të kohës.

Gjithnjë dalin probleme me përkufizimin e kohës. Asnjë përkufizim i kohës nuk i përgjigjet të gjitha rrethanave që lidhen me përdorimin e saj.

Metafora punon për t'i tejkaluar përfytyrimet e gjuhëve kombëtare. Ky tregues flet për thelbin e gjuhës së përbotëshme të metaforës.

Lëndën e kulturës poetike të Moikomit e përbën historizmi kulturor. Nga historizmi kulturor del edhe metafora e tij, e cila në gradën më të ultë

mund të shikohet edhe si pjesë e citimit kulturor. Duke rizbuluar një figurë kulturore ai bën edhe rikujtimin e historikes, i bën një rimishërim të lehtë në ceremonialin e vetmuar të poezisë. Ndez pishtarë nëpër kohë, por koha nënkupton edhe vendet që janë poshtë dritës së saj. Edhe kur flitet për vende, në këtë poezi, nënkuptohet koha. Kështu është lidhja e kohës me vendin në poezinë e Moikomit. Vendi është vasal i kohës. Vendi projektohet nga koha kulturore. Referencat janë kohë kulturore të thukta. Jeton ende ajo kohë dhe ai vend që i kanë mbetur për pasardhësit referenca kulturore.

Përbërësin e instinktit në figurë e ka të fshehur pas perdes së kohës dhe ndriçimit të metaforave. Si rregull, lëvizja e instinktit kryhet brenda çastit. Instinkti shoqëron çdo çast. Atëherë bëhet edhe përputhja në fjalë e instinktit me të ndjerit e brendshëm dhe me rrethanat, me rrethanat që e lindën dikur fjalën dhe me rrethanat, që lindin poezinë në rrethana të tjera. Moikomi çastit i shton me shumicë kohën dhe, nga shtimi i kohës dhe i figurave, instinkti zbehet dhe, nga zbehja e instinktit, mbetet vetëm poezia e kulturës.

Moikomi e nxjerr thellësinë e mendimit të tij, që e ka në figurë, në sipërfaqe. Ajo sikur gjen shtigje të ngushtë nëpër thepat e humbëtirave prej nga vjen dhe shfaqet në sipërfaqen e të sotmes me tensionin e një vetëtime. Rrufenë e përdorte vetëm Zeusi. Tani ja kanë rrëmbyer nga duart poetët, e kanë bërë metaforë.

Sipërfaqja me metafora është thellësia e kësaj poezie. Si impresionistët, ai gjithë fuqinë e artit e ka në sipërfaqe, sepse ajo është një poezi e kulturës, jo e instinktit.

Por figura e Moikomit nuk ngjan me figurat e pikturave të impresionistëve, se ajo në brendësi të saj ka fuqinë e Mujit të maleve legjendare shqiptare.

Moikomi ka krijuar një tip figure me lëndë nga historizmi kulturor, të cilin e ka idhull. Estetika e Moikomit dehet dhe zbërthehet nga historizmi kulturor. Për Moikomin ai vepron edhe në të sotmen.

Vetëdija e Moikomit punon si unike, por me të gjitha degët e kohës, andej sikur vijnë alenët e shumëpritur. Koha dhe referencat janë edhe kufij moral. Moralitetin e kohës dhe të referencave Moikomi e përfill me nderim dhe me ndrojë si një tabu, por atyre i jep një pamje të re me risintezën e figurës dhe i ushqen me lëvizje sanguine stili dhe me pamje të re surealiste. Referencat dhe koha, si pjesë e të menduarit klasik, nuk do të dëshironin kurrë që të ndodheshin brenda fjalisë sureale, por poezia e re ka klasin e vet. Koha me estetikën nuk përputhen në gjithëçka.

Mbase jemi në agun e një kohe të re të figurës dhe Moikomi është një përfaqësues i shquar i saj.

Mbase jemi edhe në një kohë të një poezie që ka lidhje të fortë me kulturën sipërane dhe tani, poezia i shembëllen një celulari që e ka zerin si cilësinë e tij të parë, por ka edhe figurën bashkëngjitur, dhe të

shkuarën, por që ruan edhe kumtet për të nesërmen, e shumë dije të tjera, aq sa ngjan me një enciklopedi të vogël. Bashkëjetesa e shkencës me artin është e dukëshme dhe në harmoni. Një nga emblemat e kësaj bashkëjetese gjendet edhe në poezinë e Moikomit.

Poezia e Moikomit është poezi e sintezës së mbyllur brenda një qarku, është një lloj aleksandrizmi i ri. Të gjitha sintezat kanë një qark të mbyllur. Megjithëse Moikomin po ta shtryllësh poetikisht do të pikojë kohë dhe rimishërim pitagorik, ai për qarkun e sintezës përdor librin, të ngjajshmin e kohës dhe të rimishërimit, por më konkret se ato. Libri është një burim jetëdhënës, tej kuptimit metaforik. Me librin askush s'matet dot se është një pafundësi dhe kujtesa kurrë s'mjafton ta mbulojë pafundësinë. Vetëm jeta e ka si pjesë të saj librin. Me jetën vetëm Uollt Uitmani guxoi të matej.

Në qarqe të tjerë janë elita të tjera me mjete të tjera artistike, të ndryshme nga ato të Moikomit.

Fjalën diturore Moikomi e lidh me fjalët më të zakonshme. Dituria sikur noton mbi të rëndomtën.

Fjalët e rëndomta janë shërbyese, por janë edhe një reliev për fjalën diturore. Ato së bashku me metaforën e nxjerin poezinë përkohësisht nga historizmi dhe e lidhin me çastin. Fjalët shërbyese të fjalës diturore, mbeten zëdhënëse të çasteve diturore. Ato e madhërojnë fjalën diturore me të rëndomtën e tyre. Ato janë balta e diturisë. E rëndomta është

gjithnjë në të sotmen. Kur depozitohet në të kaluarën, e rëndomta dlirësohet, por i avullojnë kripërat**.** Për Moikomin poezia është dituria, por dituria ka formën e patrajtëshme të kohës, që e shtyp psikologjikisht çastin e rëndomtë ku vlon instinkti.

Sa më shumë shtohet kultura aq më shumë zvogëlohet pesha praktike e instinktit, ndonëse rezerva e tij asnjëherë nuk paksohet. Megjithëse aq sa shtohet po aq edhe harroen pjesë të kulturës. Idea është se shtohet kultura. Harrimi është tendencë. Njeriu sot ka kulturën e të përdorshmes së shpejtë, me shumë hollësira, por pa metodë. Është e vështirë të gjesh një prerje të artë midis instinktit dhe kulturës. Këtë nyje gordiane të artit, në letrat shqip, e ka zgjidhur vetëm Migjeni, duke e lënë të lirë instinktin në mes të një kulture të pafundme që ndryshon.

Poezia e Moikomit shembëllen si lojë historike. Kohët përbërëse të poezisë kanë veshje të ndryshme.

Vetëm kostumin e stilit e kanë të njejtë, të disiplinuar, sipas psikikës së Moikomit dhe, me një petk të bukur rinor bashkëkohor. Shpirti i kësaj poeziet ka fisnikëri moderne. Ato ngjajnë me ngjyrat e gëzuara të portretit Baba Tangi të Vang Gogut.

Një plakë si historia, te Moikomi, ka pamje të re.

Edhe referencat janë trëndafilat e kohës që ka ikur. Moikomi i riçel.

Mbase është krijuar Iluminati i Poezisë dhe Moikomit i është caktuar një detyrë e fshehtë. Besoj se

brenda këtij iluminati poetik, Moikomi është poeti më i qartë, ndonëse shprehet me mistikë historie, që ka nën krahët e saj edhe polem mistikash të tjera.

Mister i ka figura, jo mendimi, se ai është i qartë si kultura. Figura i ka aq mister sa ka edhe një formulë shkencore. Ajo është një dituri që ka shpërthyer. Formula shkencore lëviz lëndën, metafora e Moikomit e shpërthen shpirtin e veshur me histori dhe me bijëzat e saj, për t'u parë nga brenda dhe për t'u vendosur në trupin e të sotmes.

Qëllimi i Moikomit nuk është as t'a vrasë as edhe t'a lëndojë historiken, ndonëse ajo shpesh shfaqet si shoqëruese penguese e njeriut. Ai ka përzgjedhur nga historizmi çastet më antologjikë. Me antologjitë ai kërkon të bëjë edhe kritikën e historizmit, por edhe të të sotmes, gjithënjë duke e lartësuar të bukurën që vjen nga të gjitha drejtimet. Ky vështrim përngjason me një revolucion kulturor.

Moikomin e kanë pranuar në qerthullin e iluminatit poetik, për cilësitë e shkëlqyera të figurës.

Atje, me siguri, mban titullin Mjeshtri i Madh i Figurës.

Iluminati Poetik, ku bën pjesë Moikomi, ka Priam Mjeshtër Pitagorën. Atje vijohet një projekt 2500 vjeçar i këtij Priami. Neni i parë i këtij projekti thotë se shpirti rimishërohet në trupa të tjerë. Ky nen është kundër natyrës, e cila shuhet dhe rilind nga hiri i vet, po në lëkurën e saj. Ky nen është kundër natyrës, por është

në pajtim me Priamin Pitagorë. Moikomi është shumë i përulur ndaj këtij neni. Përulja e tij është poetike, nëpërmjet këtij neni shfaq imazhet.

Iluminati Poetik u ka lejuar anëtarëve një frymë patetizmi panteist. Poetët e vuajnë pa dhembje, madje e vuajnë me krenari. Të gjithë ne jemi të rimishëruar në trupa të tjerë. Kjo botë nuk vdes kurrë, pikërisht nga rimishërmi. Ky është thelbi i mekanizmit të dytë poetik të Moikomit, që e ka pranuar jo si detyrim i venë nga Iluminati Poetik, por nga idea, edhe e tij, për pavdekësinë.

Libri e ushqen idenë e pavdekësisë. Edhe vetëm një metaforë e zbuluar flet për pavedekësinë.

Moikomi është brenda këtij qerthulli.

Ka aq nene themeltarë në poetika të tjera sa ka edhe Mjeshtra Priamë.

Moikomi është edhe Poeti i rimishërimit pitagorian Moikom Zeqo, po aq sa është edhe Moikom Zeqo, Poeti i Kohës heraklitiane.

Edhe Krishtin ky iluminat poetik e ka bërë pitagorian, por s'e ka futur dot në kohën heraklitiane.

Pa mësimet e këtij Mjeshtri Moikomi mund të mos ishte poet, por mund të ringjallëte metodat alkimiste.

Shpirti i tij kërkon të jashtëzakonshmen.

Ndaj Mjeshtrit Kohë Moikomi s'është i përulur. Atë e godet në pikat më të dobta, për ta provuar nëse është i vërtetë, por pasi e ka goditur, përsëri futet nën strehzën e tij si djali plangëprishës nën krahët e atit.

Dalja nga skema e kohës Moikomin e çdrejtpeshon, prandaj me gjithë pjesën dyshuese që ka në diturinë e tij, ai i blatohet kohës. E bren dyshimi i përhershëm nëse Koha është ashtu siç na e kanë përshkruar dhe, pastaj i lodhur, kapet pas kthetrave të historisë, që nuk është formë e kohës, se ajo është vepër njerëzore dhe njeriu prodhon luftra, por jo kohë. Lidhja e Moikomit me Kohën është midis të pranuarës dhe dyshimit nëse ajo është, prandaj ai shpesh përdor historiken si maskë të kohës.

Kohës nuk i njohim asnjë fjalë, por ne e mendojmë si shumë të ditur, madje më të diturën nga të gjithë të diturit. Këtë hamendësim Moikomi e ka bërë pjesë të dy mekanizmave të tij poetik. Ai kërkon të matet me kohën. Ta shpërndaj shpirtin pitagorin nëpër të gjithë kohën heraklitiane. Ta shpërndajë do të thotë edhe ta futi në trupa të tjerë. Koha sipas këtij arsyetimi është trupi i shpirtit pitagorian. Koha del si mjet, shpirti pitagorian del si qëllimi më i lartë i kësaj poetike. Këtu dhe kështu mbyllet qarku poetik i Moikomit, një nga të paktët qarqe kaq të mëdhenj që janë shestuar ndonjëherë. Qarqet s'janë të rinj, por është e re idea për t'i përdorur ata. Gjithë këtë zbrazëti të kohës dhe të rimishërimit që të trembin, Moikomi e ka mbushur me figura. Duket sikur e ka shpëtuar kohën dhe rimishërimin me përpjekjen e tij, por ndërkohë na ka dhënë idenë madhështore se mund të bëhet e pamundura, mund të shpëtohhet koha dhe

rimishërimi. Nuk e dimë se çfarë është shpirti dhe koha, mbase ide madhështore, por dimë që Moikomi është në qendër të kësaj ideje.

Me Pitagorën, Mjeshtirn tjetër, e ka më të lehtë. Ja ka pranuar ungjillin dhe e ndjek me besnikëri.

Atje bën klimatizimin e shpirtit në trupa të tjerë si në një uzinë universale. Moikomi ka një detyrë të rëndësishme në ceremonialin e klimatizimit të shpirtit me pjesët e kohës.

Moikomi është poeti me dy mekanizma poetikë, që burojnë nga dy mjeshtra. Njëri është abstrakt, mëse abstrakt, i pakapshëm edhe nga arsyetimi përfytyrues, tjetri ka jetuar 2500 vjet më parë dhe ka qenë një mendje gjeniale e së përpiktës, por ideja e tij e rimishërimit mbetet abstrakte. Ai i ka pajtuar dhe urtësuar në poezinë e tij këta *personalitete* (a s'themi për kohën që është gjykatës), ndonëse të dy janë abstrakt, se në thelb edhe rimishirimi është i pakapshëm. Të dy mjeshtat poetikë të Moikomit janë kohë të panjohura. Vetëm historia ka një dëshmi të zbardhur të së qenës në xhepat e dijetarëve. Nga dyshimi për kohën dhe për rimishërimin, Moikomi shkon tinëz te historikja. Koha dhe rimishërimi duke qënë të dy abstrakt, sipas një arsyetimi që njëson, mund të jenë një ide në emra të ndryshëm.

Asgjë s'është e re në këtë botë. Veprave që shembëllejnë si mistike, mjafton t'u dish ku i kanë ngulur rrënjët, atëherë ato të afrohen vetë.

Askush nuk i ka të gjitha cilësitë, por çmohet për ato që ka për të mos dalë nga vetvetja, ndërkaq bashkëkohës të tjerë ose nuk i kanë këto cilësi ose i kanë të zbehta, prandaj vënë maska..

Poezia e Moikomit është e shkruar mbi palimpsetin e kohës heraklitiane me një ëndërr pitagoriane.

Pa ndihmën e frymës moikomiane këta mekanizma nuk mund të punonin. Fyma moikomiane është pjesa e gjallë e mekanizmave, të cilët ndonëse shumë, shumë të vjetër dhe shumë të vështirë për t'u përdorur kanë marrë përfundimisht frymën e Moikomit. Tani ka edhe poezi me frymë moikomiane.

Këtë sprovë, për t'u futur në poezinë e Moikomit, e bëra duke përfytyruar Miscellanean e Miscellaneave të tij. Nuk mund të përdorja detaje nga që ai ka mijëra metafora, por më thelbësorja pse s'përdora detaje, është se këtë sprovë e shkrova për sivëllezërit e mi, shijuesit e poezisë së Moikomit.



REDAKTORI REFLEKSIV

Pasqyrë para "Shenja koha sot me ciklet e mëdha të kohës"

Sprovën "Shenja *koha sot* me *ciklet e mëdha të kohës*", nisa ta plotësoj sapo e pashë të botuar te "Milosao". E lashë leximin në mes se nuk po e kuptoja se ç'qe ai reaksion i beftë që nisi të më zhvillohej në tru. Pas botimit duhej të ndjehesha më i sigurtë, por pikërisht atëherë më zuri ankthi i papërsosurisë. Ndoshta s'e kisha përdorur të gjithë kohën e lindur prej saj. Fillova ta plotësoj menjëherë duke ia lënë ngrehinën të paprekur, po mbusha me detaje hapësirat që pikasa. Me vete dhe për veten, për plotësimet, them: *çela sythet*.

Besoj se në këtë sprovë, pjesët që lindën më vonë janë futur natyrshëm, sepse koha e saj s'kishte mbaruar dhe unë gjeta një shteg dhe u futa atje përsëri. Kam kuptuar se krijimi është i mangët nëse koha që ka lindur prej tij është ende brenda, e pashfrytëzuar plotësisht. Koha që krijon vepra s'është një shenjë e thjeshtë kalendarike. Ajo është shtëpia e natyrshme e veprës, e mobiluar enkas me psikologji pozitive për të rritur embrionin dhe do rrënohet pa zhurmë vetvetiu, kur të mbarojë trillimi me redaktimin logjik. Kjo kohë

s'duhet hedhur para kohe në kosh, se krijuesit do t'i shfaqet jo si një ëndërr e dalë nga truri, por si një ankth i dalë nga vepra që kërkon të përsoset.

Përse mbetet ajo trajtë e fjalisë e jo një tjetër, si formësohet një figurë, përse mbyllet vepra ashtu e jo ndryshe, përse shpesh vepra s'do redaktim dhe këtë punë kush e ka kryer? Kush e ka kryer redaktimin brenda njësive të veprës?

Përse-*të* janë të shumta dhe të vështira për t'ju përgjigjur. Dhe, s'mund t'a dimë sa është i lidhur me psikikën dhe sa me kulturën ky redaktim. Por një gjë është e sigurtë, krijuesi e ka brenda vetes edhe redaktorin refleksiv, atë që redakton kur trillimi end, që trillimit i jep pasqyrën për t'u vetëparë në çdo njësi artistike dhe në fund, pasqyrës i zmadhon përmasat për t'i parë gjithë pjesët si një e tërrë. Dhe vetë qëndron brënda trillimit, i gatshëm për të bërë ndreqjet gjatë endjes së stofit artistik. Kur trillimi pushon, për të mbledhur fuqi të reja, punon redaktori refleksiv në rolin e redaktorit logjik. Dhe kjo përsëritet, gjersa përfundon vepra. Redaktori refleksiv kontrollon trillimin. Çdo rëmb artistik ka edhe shijen e tij.

Një poet i madh është edhe kritik i madh refleksiv i poezisë së tij. Kritiku i madh refleksiv lind me krijimin dhe humb në krijim. Ç'farë mbetet nga kjo humbje? Përvoja, por çdo vepër nxjerr mushtin e saj, të papërdorshëm për vepra të tjera.

Përvoja është pjesë e zejit. Zeji e vret krijimin.

Krijimi mban aq zej sa të mos e vrasë vetveten. Mban edhe zejin e tretur në gjini i cili ka të drejtën e trashgimnisë.

Nuk mund të jesh kritik i madh pa qënë më parë redaktor i madh refleksiv. Por duhet theksuar se edhe kritiku i madh nuk është redaktor refleksiv, sepse ai nuk mendon brenda krijimit, se ai mendon për krijimin kur ka mbaruar. Në këshillat e tij nuk ka dhimbje të natyrshme. Kritiku refleksiv dhe kritiku nuk mund të shkrihen në një person. Ata janë vetëm plotësues me sqimë të njëri-tjetrit, por me peshë jo të barabartë në vepër. Njëri lind nga instinkti i trillimit, ndërsa tjetri lind nga kultura kritike. Edhe brenda redaktorit refleksiv ata janë të dallueshëm në role. Krijimi ka adn-*në* e redaktorit refleksiv dhe këshillimin e redaktorit logjik.

Një kritik i madh është vetëm redaktor logjik dhe kjo është grada më e epërme që mund të marrë.

Një poet i madh është edhe kritik i madh, se teorinë kritike e ka të mishëruar dhe, në këtë mishërim, është i tretur edhe redaktori refleksiv. Edhe një poezi e tij e ka brenda një libër të mundshëm për një kritik.

Krijimi bëhet për vete dhe për shoqërinë. Këtë urti ushtron redaktori refleksiv. Ai e ndjen ç'do vetja dhe ç'kërkon shoqëria.

Trillimi dhe redaktimi refleksiv janë dy fara brenda vezës që lind veprën. Ata lindin njëri-tjetrin.

Trillimi është energji e përfytyrimit, ai e fillon

i pari lojën, gjithnjë nën kontrrollin e redaktorit refleksiv. Tradita ka punuar për ta fshehur redaktorin refleksiv, edhe pse ai është fuqiplotë për trajtën e krijuar. Jo për dorëshkrimin, se për 'të është redaktori logjik, por për trajtën e krijimit në krijim, ku s'mund të futet redaktori. Redaktori e shoqëron me sqimë kritike veprën, por nuk mund të futet në qelizat e saj. Në qelizë ka qënë redaktori refleksiv, dytësi i ditur dhe i besueshëm i trillimit. Ai që quhet talent ka në thelb trillimin artistik, por ky udhëzohet drejtë përkryerjes prej redaktorit refleksiv.

Trillimi dhe redaktimi refleksiv janë bij të krijuesit, por edhe krijuesi lind nga trillimi dhe nga redaktimi refleksiv. Nuk ka krijues pa përbërësen trillim-redaktor refleksiv. Çdo krijues është i krijuar nga dhuntia dhe nga puna. Trillimi nuk është rrëfimtari dhe rrëfimtari nuk është krijuesi, ndonëse kanë lindur nga krijuesi, ata kanë pavarësi të mjaftueshme nga ai. Ata janë personazhe me tagër të veçantë të dalë nga krijuesi, i cili kur mbaron trillimi humb në vepër, ndërsa ata mbeten dhe marrin pasaportë autori.

Trillimi është cilësi, rrëfimtaria është strategji. Në këtë cilësi dhe strategji redaktori refleksiv është i pranishëm. Nga të gjithë përbërësit e veprës, vetëm krijuesi, redaktori refleksiv dhe koha e veprës e flijojnë veten. Krijues është një emër i përgjithshëm, nga thelbi i tij nisen në punë pjesët përbërëse të veprës dhe ai vetë ri pas tyre. Redaktori refleksiv është një

emër i panjohur për lexuesin, koha e veprës ka fatin e redaktorit refleksiv. Çdo vepër, që të shfaqet, i flijon pjesët e brëndëshme shërbyese.

Redaktori refleksiv nuk është i akredituar në krijim, ai është i lindur, që në fillesë, bashkë me embrionin e trillimit, sepse është estetik dhe estetika e ka fillesën te psikika, aty ku merret vendimi i parë për veprën. Në çdo fund të një njësie krijuese redaktori refleksiv humb në trajtën e krijuar. Pasi bindet për harmoninë e gjithë veprës ai humb përfundimisht në këtë harmoni. Ai është ndërgjegje artistike dhe kritike e trillimit dhe ashtu mbetet në vepër edhe pasi ka humbur përfundimisht në harmoninë e saj. Lexuesi nuk e njeh redaktorin refleksiv. Ai nuk njeh gjysmën e krijuest, pikërisht pjesën vetëkritike të tij, madje nuk njeh dhe krijuesin, njeh vetëm pjesën zyrtare të krijuesit – një emër në ballinën e librit.

Redaktori refleksiv ka ngjashmëri në fat me krijuesin. Të dy humbin me mënyra të ndryshme në vepër, por krijuesi rilind në formën e emrit të autorit, ndonëse emëri dhe krijuesi s'janë e njëjta gjë.

Roli i redaktorit refleksiv është përzgjedhja e cilësive artistike me mekanizmin natyral. I thjeshtëzuar ky mekanizëm mund të përmblidhet në kundërshtinë e hapur: Më pëlqen! S'më pëlqen! Ai lejon dhe heq pjesë të trillimit dhe thërret për ndihmë edhe redaktorin logjik që e ka brenda vetes. E thërret si pjesë të tij, se kjo pjesë ka lidhje më të drejtëpërdrejtë me kulturën.

Redaktori refleksiv, si dhe trillimi, janë vatra diturie të depozituara në instinktin krijues, me ato është krijuar kujtesa vetjake. Kjo kujtesë është banka artistike e krijuesit. Çdo kujtesë krijuese është një bankë artistike alkimiste që krediton veprën e ardhshme.

Redaktimi që fillon pasi vepra ka përfunduar është redaktim logjik, jo artistik, është vazhdim i redaktorit logjik brenda redaktorit refleksiv, është redaktim mbi redaktimin refleksiv. Por redaktimi mbi redaktimin nuk do të thotë se ai është më i rëndësishëmi. Ai vetëm kontrrollon redaktimin refleksiv, nëse kulluesja e tij ka qënë në punë gjatë gjithë kohës së ngjizjes së veprës. Redaktimi logjik përfaqëson një kulturë, redaktimi refleksiv përfaqëson mënyrën se si individi kërkon të shfaqet artistikisht në fjalë.

Redaktimi refleksiv është tretur në krijim. Krijimi e ka emrin e dytë redaktim refleksiv. Ai, së bashku me trillimin, është pjesa më mistike e veprës. Ai i jep vizë trillimit të marrë atë trajtë që do të bëhet më vonë e njohur.

Sikur të bëhej e mundur të regjistrohej mendimi i redaktorit refleksiv, do të dilte një libër që do ta trondite lexuesin. Ai do t'i jepte një pamje tjetër krijimit duke i treguar proçesin që s'është i barabartë me krijimin. Do kuptohej edhe roli i tij si përbërës që humb në vepër dhe do ndihmonte të kuptohej se si humbin edhe përbërës të tjerë.

Brenda krijimit janë dy gjuhë të mëdha, gjuha e

trillimit dhe gjuha e redaktorit refleksiv. Ato kërkojnë të njësohen. Njëra shton vazhdimisht vetveten, ndërsa tjetra kontrollon, heq dhe lë. Rreth tyre vërtiten gjuhë të vogla, që ndihmojnë trillimin dhe redaktorin refleksiv për t'u bërë artistik.

Është e pamundur që vepra të përfaqësohet vetëm nga trillimi. As teorikisht nuk mund të ketë trillim të kulluar. Psikika natyrore është përshtatur për të tretur idetë. Se estetika ka lindur nga bashkimi i natyrores me shoqëroren. Trillimi mbetet lojë e instinktit në këtë bashkëjetesë.

Edhe poetët improvizues e kanë brenda vetes redaktorin refleksiv, por ata e ndjejnë më pak atë.

Improvizimi e shkurton kohën e krijimit dhe, meqënëse është krijim me të dhëna mekaniciste, dhimbjet e daljes i ka më të vogla dhe kujtesën e krijimit më të dobët.

Një redaktor refleksiv, nëpërmjet kontrrollit të rreptë, mund edhe ta tkurrë krijimin, por edhe mund t'i lejojë liri që e tejkalojnë stilin dhe arsyen artistike.

Kufijtë e arsyes dhe të psikikes të redaktimit refleksiv mbulohen nga zjarrmia e vrrullit krijues, por çdo krijues, në nënvetëdije, i ruan gjurmët e redaktimit refleksiv, ndonëse ato i janë thadruar thellë.

Psikika ushqen trillimin, trillimi thërret për ndihmë redaktorin refleksiv për t'ia dlirësuar energjinë dhe ky, me raste, thërret për ndihmë redaktorin logjik, që e ka brenda vetes. Reaksioni zinxhir nis nga psikika,

përçohet te trillimi, shkon te redaktori refleksiv dhe përsëri, kthehet te psikika, ku mbyllet qarku. Nga ky qark lind një njësi artistike. Këto reaksione vazhdojnë gjersa mbaron vepra. Psikika është e ngarkuar me trillim, me redaktim refleksiv dhe me përbërës të tjerë.

Reaksioni artistik në çdo njësi nuk është ngjarje që mund të përshkruhet. Për atë nuk ka të dërguar të posaçëm. Reaksionin artistik nuk e vëzhgon askush, as krijuesi i saj, se ai ri pas përbërsëve, se tagrin ja ka marrë psikika krijuese me bijtë binjakë: trillimi dhe redaktori refleksiv. Brenda trillimit është edhe rrëfimtari. Për këtë arsye krijimi mbetet një histori e brendëshme, një punë mendore me karakteristika të njohura dhe të panjohura.

Krijimi, ka një mekanizëm të ndërlikuar, që përthith tërrë botën nëpërmjet fjalëve. Shpjegimi i një fjale krijon gjasat për një gjuhë. Krijimi e bën botën të dalë nga dera e tij. Bota është thadruar në psikikë. Prandaj ka kuptim të thuhet se një njeri është i gjithë njerëzimi.

Redaktimi refleksiv nuk është zej, është një gjuhë me mendim shumë racional.

Nëpërmjet redaktimit refleksiv bëhet drejtshkrimi artistik i trillimit.

Instinktet janë bërë shoqërorë, kanë dalë hapur dhe ecin në rrugë. Dalin nga individi dhe bëhen zëdhënës të shoqërisë. Ato e kanë lënë në hije arsyen. Vetëm arsyeja natyrore mbijeton se ajo është shprehëse

e instinkteve.

Frika nga instinktet është psikologjike. Është frika e qytetërimit nga natyrorja, është si lufta e brezave që zhvillohet pa marrë parasysh gjakun, por edhe pa e mohuar.

Arsyeja është energji e lindur nga natyra e njeriut dhe nga kultura e, ndonëse shihet si kurrorë e njeriut, është bërë tepër e brishtë. Arsyeja është çkurrorëzuar nga marrëdhëniet, jo nga instinktet. Arsyeja me instinktet janë trajta natyrale e të menduarit. Ndërsa marrëdhëniet janë kthyer në zota për njeriun.

Letërsia është instinkt artistik me pashaportë kozmopolite. Asaj i vihet detyrë të pasqyrojë instinktet sa më fuqishëm.

Na ka bërë skllevër modern *po*-ja. *Po*, *po*, *po,* për gjithëçka *po*. Ajo është fjala më e skllavëruar e njeriut të marrëdhëniezuar nga hirarkia. Është harruar *jo-a* instinktive. Një vepër arti pa instinkte të fuqishme është e njëtrajtshme. Thelbi i fuqisë qëndron te jo-*ja* instinktive.

Redaktori refleksiv bën një punë të mundimshme. Ai, i pari, e ndjen peshën shtypëse të marrëdhënieve dhe i pari, mund të bëhet preja e tyre. Qëndresa e tij, brënda trillimit, e ndërton trillimin. Ai është i pari që ndjen edhe mungesën e instinkteve artistikë të trillimit.

Me redaktimin refleksiv nis mjeshtëria e dhuntisë ose mjeshtëria e ka emrin edhe redaktim refleksiv.

Ai është thelbi i redaktimit dhe është i lidhur me fjalën si njësia bazë e krijimit, pastaj me mendimin si ligjërim shoqëror.

O sa thelbësor është redaktimi refleksiv!

Koha e vetredaktimit ose e redaktimit refleksiv është brenda kohës së krijimit. Ajo është kohë e mbrujtur me ethet e bërjes, dhe mban të ndezur trillimin, kritikën logjike dhe përbërës të tjerë më pak të rëndësishëm, prandaj është klimë e përhershme e veprës. Ajo nuk është vetëm klimë subtropikale krijuese, por është e mbushur me kujtesë dhe me kujtesë krijuese, me më të bukurën e kujtesave. Kujtesa na mban brenda vetvetes, kujtesa krijuese na nxjerr jashtë për t'na bërë shoqëror. Ajo është instinkt e kulturë e njësuar. Kujtesa është një nga lëndët e para të krijimit. Kujtesa krijuese është trillim i përshtatur për jetën shoqërore.

Kur shuhen ethet e krijimit, në thelb, ka mbaruar koha e plotë e redaktimit. Kur krijuesi nuk ka ç'ti shtojë trillimit, koha, që ka lindur nga krijimi, shuhet. Trillimi ka zënë vënd në vepër si gjuhë artistike. Fundi i trillimit është edhe fundi i kohës së veprës. Atëherë vepra është e gatshëme t'i jepet lexuesit.

Trillimi, që të punojë, duhet të krijojë kohën e tij, atë ia jep edhe përbërësve të tjerë për t'a përdorur.

Të gjithë përbërësit e një krijimi kanë vetëm një kohë për ta shfrytëzuar. Koha krijuese e veprës ka pavarësi nga koha jashtë saj, por ka marrë shtysë prej një rëmbi të saj. Koha e veprës është kohë brenda

krijuesit dhe është pjesë e mekanizmit krijues dhe është e përkohëshme dhe s'ka lidhje me kohën që përshkruhet në vepër, por i jep karakteristikat e veta asaj. Koha e krijimit është kohë me ndikim mbi përbërësit e veprës.

Kohës së jetës nuk ja dimë krijuesin. Kohës së krijimit ja dimë atin. Ai është trillimi artistik. Trillimi është edhe krijuesi i lirisë brenda krijuesit. Të trillosh do të thotë të jesh në natyrën tënde, i pavarur. Në brendësi të fjalës krijues ka një vend edhe fjala liri. Prandaj trillimi është krijuesi i kohës së veprës dhe i lirisë së saj. Është ndër rastet e pranuara kur njeriu brënda vetes krijon kohë të trilluar dhe ka ndijesinë se rron brenda kësaj kohe. Koha e trilluar ushqehet nga liritë më të thella, por përjeton edhe ankthin e lirisë për t'a përmbyllur veprën me këto liri, që i ka lindur vetë, se ai e di se liritë e brendëshme kanë lindur me trillimin dhe do shuhen kur të mbarojë ai. Trillimi i anashkalon liritë e realitetit, të cilat janë liri të dyshimta. Në thelb, trillimi ushqehet me liritë e qenies. Por ajme, liritë e qenies pak krijues i përdorin.

Krijimi ngjizet dhe merr trajtë në të përkohëshmen. Liritë sa më të thella të jenë aq më natyrshëm kthehen në cilësi artistike. Thelbi i lirisë është sinqeriteti njeri-krijues. Mungesa e tij, qoftë edhe e pjesëshme prish harmoninë. Krijuesi nuk ka vetëm ndiesinë se ka krijuar kohë, por shkon më tej. Për ta bërë të qënë këtë kohë, i jep asaj për shoqërim krijimin, që rritet çast pas

çasti, nga trillimi dhe nga ankthi i lirisë. Krijimi e ka kohën e tij si ushqim psikologjik. Aq sa plotësohet krijimi aq shkurtohet kjo kohë. Që të lind krijimi duhet të shuhet koha e tij. Kjo të kujton jetën me lindjet dhe vdekjet si vazhdimësi e njëra - tjetrës.

Shpesh, krijuesit, vendosin një datë poshtë krijimit. Veç kronologjisë krijuese, data është një e dhënë kalendarike që lidhet me autorin, por të dyja nuk pasqyrojnë kohën psikologjike të veprës. Data s'thotë asgjë se si lindi vepra. Data thotë se kur është ndarë vepra nga trillimi, ose kur u fut në shestimin krijues koha e trillimit. Datat e lidhin krijuesin me shoqërinë.

Koha e veprës mund të ringjallet. Atë e ringjall papërsosuria e pikasur nga krijuesi. Por ajo s'është kohë e mirëfilltë, është dytëse e kohës së parë, është dytëse, se entuziazmi i trillimit s'mund të rilindë me të njëjtat karakteristika që lindi njëherë. Gjithëçka lind një herë.

Redaktimi refleksiv është bashkëkrijues i estetikës së veprës, ai nuk është teknik, është psikik ose natyror, ose estetik. Redaktimi refleksiv lë në krijim psikikën estetike të krijuesit dhe kulturën e tij, që i është bashkëngjitur të lindurës psikike.

Redaktimi logjik është redaktim kulturor. Ky redaktim mund të bëhet nga vetë krijuesi apo i jashtmi. Ai kullon psikikën estetike të fjalëve. Ai lë kulloshtrën. Ai e shikon veprën pasi ka mbaruar ose ka mbaruar

pjesërisht, ndryshe nga redaktimi refleksiv që i jep, që në ngjizje, trajtë artistike krijimit.

Trillimi artistik lind si estetikë, por estetikën e tij e vëzhgon redaktori refleksiv. Ai e shikon fjalën për t'a bërë estetike dhe ndihmon të nxjerrë harmoninë që do t'i lidhë fjalët. Dhe, me sfondin e natyrores, lidh idetë. Idetë kur janë të tretura në fjalë, lënë të kuptohet se redaktori refleksiv ka qënë bashkëpunues metrillimin.

Redaktimi refleksiv dhe trillimi artistik kanë lindur për t'ia pranuar arsyen njëri – tjetrit. Nuk redaktohet vetëm trillimi artistikprej redaktorit refleksiv, por edhe redaktimi refleksiv redaktohet prej trillimit artistik. Vetë trillimi artistik ka veti kritike. Ai end duke vetëpërzgjedhur. Vetëpërzgjedhja pohon vetitë kritike të trillimit. Në këtë rast redaktiori refleksiv miraton. Në këtë rast ai mbetet pa punë... Por jo çdo gjë është e qartë në këtë bashkëpunim, se brënda tij ka dyshime dhe përplasje. Reaksioni artistik zhvillohet kur ka mirkuptim midis trillimit dhe redaktorit refleksiv. Kur mungon mirëkuptimi për trajtën artistike riskun e merr trillimi. Ai është udhëheqës i krijimit.

Asnjë vepër nuk mbruhet me kulturë, vetëm shkruhet me kulturë, ajo s'është përbërës prijës se ka lidhje me idetë jo me fjalët, të cilat janë dije natyrale që kanë marrë edhe karakteristikat e psikikës.

Problemet e qenies janë tretur në psikikë, jo në kulturë. Jeta i ndëron shpesh kulturat. Kultura është kalimtare dhe ndodh të rekrutohet pa arritur të lidhet

organikisht me krijimin. Nuk ka vepër arti vetëm me kulturë. Roli i parë i kulturës është eufemik, ai i emërton me një gjuhë të pranueshme për qytetërimin instinktet dhe arketipet. Para kulturës duhet të vendoset fuqia mendore e krijuesit, e cila i kthen kulturat në shërbim të saj. Jo çdo kulturë ka vlerë të shtuar për fuqinë mendore të krijuesit.

Fuqiq mendore e Migjenit është paradominante artistike e veprës së tij. Ajo është edhe paradominantja artistike e letërsisë shqipe.

Ndërsa Moikom Z. e ka prishur dominanten artistike të poezisë. Te poezia e tij, kulmimi, dominantja artistike, nuk lëshon kohë heraklitiane. Ajo lëshon kohë panteiste. Unitetin e kohës heraklitiane e ka coptuar me fragmentarizëm panteist. Në poezinë e Moikomit fragmenti është një njësi artistike, pothuajse e pamvarur. Kjo poezi është unitet i fragmenteve jo të nënrenditura sipas një logjike formale. Ajo ka logjikë eklektike.

Ajo udhëhiqet nga logjika e shoqërimit të të ngjajshmeve me kohë dhe me individualitete të ndryshme, të udhëhequra nga çasti koha sot që fsheh unin e poetit.

Uniteti është një ide e sajuar. Fragmentarizmi është një gjendje e përhershme natyrale. Fragmentarizmi mund të ngrihet në një ide monolite. Kjo është rruga estetike e Moikomit. Dominanten artistike të njësisë ai e ka ngritur në metaforë. Unitetin e siguron nëpërmjet

fragmenteve.

Redaktimi refleksiv i siguron thellësinë veprës, sepse ai vjen nga psikika, thellësia zmadhon volumin, se ia rit përfytyrimin lexuesit, redaktimi logjik kujdeset për sipërfaqen, që të jetë në harmoni me thellësinë. Idetë, sado të fshehura, janë të lidhura me sipërfaqen.

Fjala, para se t'i shërbejë idesë, shenjon me tinguj dhe me tinguj psikikë natyrën. Ajo merr me vete edhe idetë. Redaktori refleksiv është i ndjeshëm, para së gjithash, ndaj shenjës së fjalës. Psikika e fjalës është thellësi e ardhur nga kohët, e përditësuar nga krijuesi. Çdo krijues ua përditëson psikikën fjalëve.

Krijuesi çmohet edhe për mënyrën se si e kontrrollon veprën. Ripunimi i kthen dobësitë nga rruga për ku janë nisur, për të lënë në vepër vetëm harmoninë. Edhe në ripunim redaktori refleksiv është përsëri i pranishëm, përsëri i domozdoshëm, me po atë rol, por i pajisur me më shumë arsye se sa refleks artistik. Atje reaksionet artistike janë më të rralla.

Asgjë nuk i hoqa sprovës "Shenja koha sot me..." veç i shtova. Askush s'mund të thotë se kush është më i dobishëm: heqja apo plotësimi. Të dyja synojnë përkryerjen. Për veprën ato janë e njëjta gjë.

Plotësimet në këtë sprove janë sa një e treta e saj, pra, një të tretën unë nuk e kisha thënë. Prandaj u rifuta brenda kohës që kishte krijuar ky krijim, çela gjithë sythet për t'a çuar mendimin në kufijtë e plotërisë. Për këtë më ndihmoi koha e veprës që e përdora të tërrën.

Koha e veprës kishte nevojë të përdorej e tërra, që të shuhej dhe unë të isha i lirë prej saj. Ajo ishte brenda meje, duke e nxjerrë jashtë i bëra një nga përkthimet e mundshme

SHENJA KOHA SOT
ME CIKLET MËDHA TË KOHËS

Metaforat pindarike të Moikom Zeqos mund të mbulojnë paqësisht me energjinë e tyre qiellin e Europës Perndimore.

Ato janë thjerra, që përthyejnë kohën historike për të ndriçuar kohën e qenies. Ato plasin në *kohën sot*, në kohën e Poetit.

Kjo plasje në *kohën sot* e bën figurativitetin kohë të drejtuar nga *koha sot*.. Kohët historike janë në shërbim të *kohës sëpoetit*.

Pika e vrojtimit metaforik është në lartësinë *koha sot*, por s'do të thotë se kjo lartësi është mbizotruese e kohëve të djeshme. Ajo është një lartësi subjektive e poetit. Ajo varet nga të qenit fizikisht sot, atje. Atje, ku gjallon poetikisht poeti, është edhe pika më e lartë dhe më e nxehtë e kohës.

Ciklet e mëdha të kohës ushqejnë njëri - tjetrin me eklisir.

Shenja *Koha sot*, e metaforës moikomiane, është e ushqyer nga *ciklet e mëdha të kohës*.

Moikomi është mjeshtër i madh i shkrirjes së *kohës sot* me *ciklet e mëdha të kohës.*

Detaji *koha sot* lidhet me *ciklet e mëdha të kohës* për t'u dhënë atyre konceptualitetin e sotëm dhe për të marrë prej tyre konceptualitetin e djeshëm. Brenda *cikleve të mëdha* të kohës ka ura lidhëse të vetvetishme. Kështu i mendon poeti.

Koha *koha sot* nuk e dimë nëse është *cikël i madh i kohës*, por dimë që është detaj subjektiv i poetit, është lartësia e tij dhe, vetëm prej këtyre cilësive ajo mund të pagëzohet si *cikël i madh i kohës*.

Moikomi i pohon poetikisht të gjitha kohët. Me këtë pohim hyn te mohuesit e mëdhenj.

Thelbi i mohimit të tij është pranimi i të gjitha kohëve në një njësi poetike. Ai fut tinëz ide konceptuale, kur i pohon të lidhura kohët me kapsen e një njësie poetike.

Kemi lexuar poetë të mëdhenj të një kohe, por Moikomi është poet i madh *i cikleve të mëdha të kohës.*

Por shenja *koha sot,* me nëntekstet që i duhen njeriut, mund të vijë poetikisht edhe nga një kohë e mëparëshme. Nëpër këtë damar të vjetër të kohës, ku janë luajtur drama, ka ravguar Kavafi.

Kohët, të denja për t'u mbajtur mend, kanë veshjet e tyre historike, por poshtë veshjeve gjëllin shpirti, që s'e njeh kohën. Kohën e njeh vetëm mendimi, dhe ai, në rrethana shtrënguese. Mendimi i lirë nuk ka kohë.

Nuk udhëhiqemi nga koha *koha sot*, se ajo s'mund të jetë model për veten. Modeli është gjithnjë një kohë paraardhëse ose paralele. Brenda nesh është uni i

fuqishëm, por ai s'është model, ai e grryen të sotmen.

Moikomi, shkon më tej se koha paraardhëse, ai shkon te të gjitha kohët paraardhëse, vetëm me shikimin e një çasti poetik, që e mbyll në metafora.

Kjo mënyrë s'është nevojë e brendshme e historianit, është filozofi e natyrës së shestimit poetik.

Me terma humanë konceptualiteti i Moikomit është dritë, dashuri, është e gjithë koha e njeriut, që e ka ndërtuar njeriun.

Moikomi riorientohet nga ciklet e mëdha të kohës. Riorientimi është një shndërrim i brendshëm i këndshikimit për një shikim më përmbledhës. Riorientimi lë dhimbje në kufirin e shndërruar, por lë edhe ngadhnjim. Riorientimi i mendimeve nuk është i përfunduar.

Metafora e Moikomit është akademi e dialogimit me kohët. Kohët mbajnë brenda paraardhësit. Në thelb, riorientimi i mendimeve të metaforës së Moikomit arrihet në dialogun me paraardhësit. Ku mund të dialogosh më qashtër se sa në librin e parardhësve? Ata janë të lirë nga *koha sot*. Poezia e Moikomit ka marrë tiparet e një vatre të gjithëkohëshme, ku digjen drurët ekzotikë të historisë.

Në jetë s'jemi vetëm me moshën tonë kalendarike. Kemi edhe moshën mendore të së kaluarës. Në një vështrim, pa e pranuar të pranuarën, jemi kulturalisht edhe një pamje e së kaluarës. Me përfytyrim, kemi fituar edhe të drejtën e pasjes së kohës së ardhme.

Njeriu ka vetëm një kohë të pacopëtuar që e copëton me mendim.

Lidhja me *ciklet e mëdha të kohës* nuk arrihet me teknicitetin e detajit *koha sot*, por me konceptualitetin e tij.

Te poezia e Moikomit dallohen dy shenja kulturore: Moikomi erudit dhe: Moikomi konceptual.

Me terma të tjerë dallojmë: Moikomin ekzistencial dhe Moikomin e qenies. Moikomi i qenies është i fshehur thellë në poezi. Moikomi ekzistencial është i dallueshëm në relievin e fjalëve. Ekzistenca ka nxitur kulturën, qenia konceptin. Ekzistenca është te fjalët (si komunikim), qenia te metafora (si konceptualitet).

Metafora ka tretur me kiminë e saj konceptuale të gjitha *ciklet e mëdha të kohëve*, edhe shenjën të *sotmen sot*, për ti bërë kohë estetike. Por në ngjizje ajo krijon hapësirën e saj dhe, gjënë e parë që bën, zbrazet nga koha, dhe zbrazëtia mbushet me dritën e mendimit. Në thelb, metafora është mohuese dialektike.

Metafora e çmonton kohën, e veçon nga mendimi, e kthen mendimin në shërbyes të saj. Mendimi, pa ndihmën e metaforës, s'mund të ndahet nga koha.

Njeriu e ka të domozdoshme ndarjen e kohës nga idetë. Vetëm pa kohën jemi të lirë, jemi në pasfiziken e lirisë, por vendimet i marrim së bashku me kohën. Arti është liria më e madhe e mundshme e arritur. Në një lexim artistik të thellë koha humb.

Moikomi zbret nga *sot* në *dje*. Nga *dje* vjen në *sot*.

Nga *dje* dhe nga *sot* niset për në të *ardhmen* si një kalorës perandorak i poezisë. Nëpër këtë rrugë, që është një kohë pa kohën, realizon sintezën e figurës. Ai e mbështjell çastin *koha sot* me ciklet e mëdha të kohës me të njëjtin instinkt që mbështjellin bletët mbretëreshën.

Të jesh i vetëm me konceptin tënd estetik është vetmia më e madhe. Vetmia konceptuale është vetmi e plotë. Dikush e mendon koncetualitetin me virusin e herezisë dhe i largohet, ka frikë nga inkuizicioni shoqëror, nga ai që djeg me fjalë. Krijues është ai që del nga ryma. Të tjerët janë vijues të rymës, edhe pse mund të jenë mjeshtra. Ai që del nga ryma, nëpërmjet ligjërimit të tij, vetvetiu ka mohuar, por mbi 'të, po vetvetiu, bie hakëmarrja e rymës.

Moikomi e ka pranuar këtë hakëmarrje të rymës së mëparëshme.

S'jemi aq modernë sa mëtojmë. Modern është vetëm konceptualiteti, i cili është gjuhë e psikikës për të kuptuar qenien.

Psikika drejton nga brenda, nga thelbi i mendimit të qenies. Qenia është e gjalla e arsyeshme e vendosur në psikikë. Ajo është krijuesja e pashpallur. Këtë e di çdo krijues i ndërgjegjshëm. Krijimi i vërtetë shpërthen nga psikika. Krijuesi i vë psikikës emrin që e ka të rregjistruar në gjendjen civile. Ndodh që t'i vëjë edhe një pseudonim. Kjo është më e dlirë. 72 heteronimet e F. Pessoa-s janë edhe 72 gjendje krijuese të Pessoa-s.

Janë një mohim i emërit zyrtar për të pohuar një emër të lindur gjatë krijimit, që mendohet se i përshtatet asaj që është krijuar. Kjo është një fushë pak e njohur, edhe pse është në fushën e lirisë. Ne jemi Askushi që në rrethana i japim vetes emërin që përputh gjendjen e brendshme me rrethanat.

Moikomit, sipas gjendjeve që ka nxjerrë në krijimtari, do t'i përshtateshin disa heteromime, por ai ka zgjedhur dytës Makabe Zaharinë dhe mendon se ky i mjafton. Atij i ka dhënë tiparet e një personazhi të plotësuar me të cilin dialogon.

Krijimi është edhe çast i mbushur me përvojë, por këtij çasti i ka paraprirë psikika krijuese e lindur.

Qenia shkruan ekzistencën. Moikomi e vë në provë psikikën me metaforën e fortë. Është një nga provat e skajshme që mund të bëj një poet mbi lexuesin. Por provën e parë Moikomi e ka bërë mbi vetveten.

Poeti është kavje e eksperimentit që e sajon vetë. Por vetëm poetët që dalin nga metoda e pranuar në mëvetësi e vuajnë me dhimbje eksperimentin.

Njeriu i njeriut është krijuar nga vetvetja, nga futja e njerëzores brënda tij. Njerëzorja s'ka përfunduar brenda njeriut, ndonëse ai mëton se është njeri. Psikika përveç pjesës natyrore, të pashpjegueshme, është e ndërtuar nga trysnia e egzistencës së llojit. Idetë janë copra të ekzistencës. Metaforat janë dhimbje të qenies.

E gjalla është qenie e amshuar, e kapërxen rrethin e kohës. Në qoftë se pjesë të saj bien në tokë, para

murit rrethues të kohës, rryma e saj nuk bie në tokë kurrë. Metafora e Moikomit ka dalë nga rrethi kohë.

Për kohën na lejohet të flasim me shëmbëllime, por ndjejmë se flasim vetëm për një anë të shëmbëllimit, se na mungon përgjegjësja, por përgjegjësja e shëmbëllimit del vetë koha, kur ajo duhet ta drejtonte shëmbëllimin. Nuk e dimë se sa është masa e gabimit në mendim. Lënda e kohës asnjëherë nuk na është shfaqur dhe nuk do të na shfaqet. Dhe, nga mungesa të tilla, detyrohemi të flasim me filozofi spekulative metaforah. Në këtë rast brohorasim: rroftë mendimi abstrakt, shpëtimtari i përhershëm! Ndonëse ai s'i plotëson të gjitha kushtet e besueshmërisë.

Ndërtojmë një mendim të arsyeshëm pa lëndën e parë të domosdoshme të pastërt. Arsyeja përdor një metaforë për të dalë nga gracka që i ka ngritur vetes me një metaforë. Metaforat janë të papërsosura ose janë të përsosura në subjektivitetin e tyre dhe një ditë u shteron rezerva e konceptualitetit, por me fuqinë që kanë e kapërxejnë lëndën jo të pastërt të arsyes dhe në kapërxim e dlirësojnë mendimin dhe krijojnë një lloj ylberi mbi mendim dhe brenda në mendim.

Të gjitha zgjidhjet e mëdha bëhen me metafora. Metafora është mënyra më e epërme për të ushtruar mendimin. Pas pjekjes së mendimit bëhet mbartja e tij (metafora-ja) në jetë. Ajo del nga vetvetja dhe jepet për të tjerët. Veçse të tjerët e bëjnë të tyre në një kohë pasardhëse. Metafora del nga vetvetja që në çastin që bëhet metaforë.

Ndërrimi i shkallëshkallshëm i cikleve të mëdha të historisë vijnë nga fuqia ndriçuese e metaforave. Brenda orbitës së tyre mund të krijohet një jetë ndryshe. Siparin e shfaqjeve të mëdha shoqërore e kanë ngritur metaforat. Formulimi: Dielli është qendra e sistemit të tij, në fillim ishte një metaforë. Pasardhësit i ndëruan gjuhën formulimit, e futën në gjuhën e shkencës.

Njerëzit janë qenie virtuale të konceptualitetit të metaforave. Konceptualiteti është ngjizur dikur, por ende sot, e ka të re fuqinë krijuese. Ai nuk shëmbëllen, ai është. Mënyra e jetesës është shëmbëllim i konceptualitetit. Krijuesit e metaforave janë krijuesit e vërtetë të mënyrës së jetesës. Metafora është futur në jetë dhe në të gjitha indet e dijes. Sot ajo është edhe virtuale. Është edhe luftë edhe paqe. Metafora e Moikomit është një degëz e estetikës që bashkon shenjën *koha sot* me *ciklet e mdha tëkohës*.

Kohën *Koha Sot* Moikomi e ka përqasur edhe me tri ngjyrat e semaforit. Të tria ngjyrat janë profane. E gjelbëra është parajsa profane, e kuqja një ferr profan dhe portokallia një purgator profan me besime teknologjike *Ciklet e mëdha të kohës* janë rrënjët e të menduarit. Koha *koha sot* është trajtë e subjektive e cikleve të mëdha të kohës, atje dominon portokallia profane që ka më tepër afëri me të kuqen e ferrit profan. Sipas gjendjeve shpirtërore portokallia profane mund të jetë edhe e kuqja e ferrit profan. Vetëm parajsa profane pret të vijë nga e ardhmja. Tre ngjyrat

e semaforit të kthyer në metaforë nga Moikomi janë edhe tre stacionet e kohës.

Vetëm duke e parë thelbin e mendimit tonë me mungesa jemi të lirë të vijojmë lojën brenda grackës që i kemi ngritur vetes. Është një lojë që zhvillohet me mungesa të ndjeshme dhe asnjëherë s'jemi plotësisht të kthjelltë. Vetëm në një teren me mungesa mund të jesh krijues. Në plotëri zbatohen rregullat. Por njeriu çuditëshrisht është krenar dhe ecën duke shkelur mbi boshësitë konceptuale që i kanë lënë paraardhësit, për t'i krijuar vetes idenë e ecjes përpara.

Krijuesit e mëdhenj dalin prej mungesave të shoqërisë. Shoqëria e sotme, me mungesa të ndjeshme konceptuale, ka një frymë të zbehtë krijuese. Mungesa e konceptualitetit pozitiv është sajuar enkas nga arkitektët e planifikimit të mënyrës së jetesës. Sot vendos konceptualiteti negativ. Konceptualiteti është metodë e psikikës, por psikika është ndotur. Krijuesit e mëdhenj vijnë si aksidente duke u përplasur me shoqërinë. Pastaj e futin shoqërinë në mendimin e tyre. Moikomin e kanë madhëruar këto mungesa. Kur i kupton mungesat e shoqërisë formon rrjedhën tënde. Tani Moikomi ka hullinë e tij poetike. Ka atë që kërkon një poet që ta ketë. Ai ka sjellë atë që mund të ketë munguar prej kohësh. Ai ka bashkuar veten me ciklet e mëdha të kohës. Prurja poetike e tij ka mbushur një pjesë të konceptualitetit të të menduarit.

Ecja e metaforës së Moikomit s'fillon nga *sot* për të mbetur në *sot*.

Ajo niset nga të gjitha drejtimet e mundëshme të kohës, me vetdije dhe me vetvetishmërinë e vetdijes poetike. Grafikisht ajo mund të jepet me rafshin e një fushe të rahur nga traga me kahje të ndryshme. Është një ecje poetike shumë e ndërlikuar, se nuk i përmbahet një rregulli të pranuar, prandaj edhe poezia e tij duket ndryshe, sfiduese, e hapur po dhe e mbyllur brenda imazheve të kohës. Koncepti i kësaj poezie është: çasti tretet, koha mbetet. Çasti është mundi njerëzor që skalit kohën dhe pastaj flijohet.

"Zogu - që shkon në të Ardhmen, - pse gjen të Kaluarën?", është një varg i Moikomit. Kjo humbje e kahut është një koncept i së pandërgjegjshmes brenda njeriut. Njeriu gjithnjë *humb* kahjet brënda kohës së tij.

Kjo ecje bëhet mbi vetveten, e menduar si e lidhur me të gjitha ciklet e mëdha të njohura të historisë. Në ecje, poshtë vetvetes, nuk mund të shikosh asgjë. Në këtë rast vetvetja është metaforike. Duhet zbërthyer metafora për të parë vetveten Moikom. Vetvetja e Moikomit është në thelb të njerëzores, por e veshur me kulturën dhe ndjeshmërinë e tij.

Poezia e Moikomit është nën trysninë e kohëve të ndryshme, të cilat e kanë prishur vijimësinë logjike të mendimit të pranuar dhe e kanë zëvëndësuar me logjikën e imazheve të mara nga të gjitha kohët. Nga një çast shpërthejnë shumë imazhe të pavarura, që krijojnë boshtet e tyre. Çastin fillestar e lënë në shenjtërinë e tij, por në çastin fillestar janë pasardhës të

pemës gjenealogjike të poezisë. Çdo çast ka një imazh aforistik. Imazhi aforistik ka zëvëndësuar mendimin aforistik dhe mendimin e ndërvarur logjik. Moikomi ka zbehur mendimin aforistik dhe logjik dhe ka forcuar imazhin aforistik. Kjo metodë është imazhinizëm i pastërt. Surealizmi i metaforës së Moikomit rrjedh dhe përcaktohet nga imazhi. Vetë surealizmi është një imazh (që ka një vdekje brenda). Dhe pindarizmi është një kapërxim me imazh. Moikomit do ti përshtatej më shumë se çdo përafrim, përafrimi me imazhinizmin.

Nuk ka kohë të plotë kulturore të ndarë nga ciklet e mëparëshme të kohës. Ky është një koncept i Moikomit, që i ka hapur rrënjët në të gjithë trruallin e poezisë së tij. Kjo është pjesë e lirisë jetësore që kërkon të fitojë Moikomi mbi konceptet veçuese. Pjesa kulturore e cikleve të mëdha të kohës nuk shuhet se është e pajisur me konceptualitet, që ka vetinë të ripërtëritet.

Vetëm me fjalën, pa kujtesën dhe pa përfytyrimin, njeriu nuk do të ishte aq njeri sa është sot. Përsëri diçka thelbësore i mungon njeriut.

Nuk ka të sotme të pastërt. E sotmja në diagramën e kohës është një vdekje, që pritet të ndodhë shpejtë.

Vetëm e sotmja vdes duke e zbrazur vetveten. E kaluara ka fuqinë të ringjallet nga kujtesa. E ardhmja është në përfytyrim. Metafora e ringjall të kaluarën dhe e sjell në të sotmen dhe e përgatit për të ardhmen.

E kaluara dhe e ardhmja ngjajnë në vlera, ndonëse

kujtesa dhe përfytyrimi e bëjnë jetën në organizma të ndryshëm.

Edhe e sotmja, e ka të kaluarën dhe të ardhmen në trupin e saj. Ajo është një pikë e fshehur, që blatohet për të ardhmen dhe për të shkuarën, njëkohësisht. Në qoftë se e sotmja bëhet e ardhme, njëherëshi bëhet edhe e shkuar me të njëjtën shpejtësi. E sotmja është kohë me dy kahje e mbështetur mbi një pikë. Njëri kah i ikën te e djeshmja, ndërsa tjetri shkon te e ardhmja. Vetëm pika imagjinare mbetet. Koha mbi pikën ikën. E sotmja është kohë e shqyer nga kujtesa dhe nga përfytyrimi. Ajo çka mbetet nga kahjet e shqyera është e sotme. Edhe mendimi i sotëm e vuan këtë shqyerje.

Koha ndihet më e qartë jashtë trysnisë së ekzistencës. E kaluara dhe e ardhmja janë jashtë trysnisë së ekzistencës. Iluzioni i tyre shijohet më qartë. E kaluara është më e pasur me kohë nga ç'e mendojmë. E gjithë koha derdhet atje. E sotmja shijohet nën daullet e ankthit. Por njeriu rrallë e ndjen veten jashtë trysnisë së ekzistencës, kjo rrallësi është e barabartë me lirinë që kemi. Pak liri më shumë fiton krijuesi në çastet e ethshme të krijimit. Pastaj ai kthehet në njeri të zakonshëm. Prandaj ai kërkon të rikthehet te krijimi, për të rifituar lirinë edhe për pak çaste të tjerë. Krijuesi krijon që të jetë në liri.

Ikja dhe qëndrimi japin gjendje të ndryshme. Moikomi ikën dhe vjen i vetmuar nëpër kohë. Më shumë e gjen *në dikur* se sa *në sot*. Atje ku është kuj-

tesa. Atje e mbjell përfytyrimin, po prej andej sjell një imazh. Duket sikur kuptimi i jetës shpërthen nga e kaluara. E sotmja i bën vetëm një redaktim të përciptë të kaluarës se ajo ngutet për të ikur. E ardhmja i shton përgjegjësinë. Kujt? Të sotmes që ngutet të iki? Ç'farë mbetet nga e djeshmja dhe nga e sotmja, përgatitet për të nesërmen. Ajo që jep, e sotmja, ngutet dhe dhënien e jep si eksperiment, pa siguri. Vetëm e kaluara ka siguri në dhënie. E ardmja jep një ëndërr.

E sotmja është një qëndrim nën trysninë e ekzistencës. Nën trysni, ajme, natyralja vë maska. Arsyetimi për kohën është ngritur mbi një logjikë, që i mungojnë përbërsit lëndorë. E mbajmë këtë arsyetim të ngrehur, sepse atje gjejmë skeletin e poezive të Moikomit.

E ardhmja nuk është një kohë që pret në qetësi. Nga imazhi që merr nga e kaluara ajo ka fituar përbërës të qetësisë. Nga trysnia e të sotmes egzistenciale ajo trembet. E sotmja është e kërcënuar nga e ardhmja. Këto janë arketipe në psikikën e krijuesit, por çdo krijues i përdor ndryshe. Moikomi, asnjë pjesë të tërrësisë së arketipit nuk lë pa e përdorur.

Psikika krijuese punon për përfytyrimin e kulluar. Por praktikisht s'e dimë ç'është përfytyrimi i kulluar. Mund ta përngjasojmë me poezinë e Moikomit? Është një mundësi për të pohuar lëvizjen e mendimit në të gjitha kohët njëherësh.

Në të gjitha kohët njëherësh (e ka brënda pamundësinë për në të gjitha kohët), mbase është

thelbi i përfytyrimit të kulluar. E kulluara e të gjitha kohëve është dobia më e madhe. Lëvizja në të gjitha kohët njëherësh është edhe prova e mundësive krijuese të njeriut.

Koha kulturore është relievi ku lëviz metafora moikomiane. Metaforë në kohë, e kredhur në kohë, e mbrujtur me kohë, me synim për t'i shpëtuar kohës, është thelbi i metaforës moikomiane. Diçka paradoksale ka këtu. Paradoksin nuk e ka krijuar Moikomi, ai është njerëzor. Përpjekja për t'i shpëtuar kohës është thelbi i lirisë, edhe përpjekja për të pasqyruar veprën e arsyes pozitive i bashkohet thelbit të lirisë. Koha është një mjet shprehës.

Koha është mister. Kuptimshmërinë e saj e ka vendosur njeriu. Qenia e kohës është një problem i pazgjidhur. Jeta është reliev i jo jetës. Po koha mund të jetë relievi i jo kohës? Sipas teologjisë kohën e ka krijuar Zoti. Zotin Moikomi e ka kthyer në një personazh. Ai e emërton Zoti, Zoti. Dihet fuqia e një personazhi. Edhe mbi këtë shtrat është ngritur metafora e Moikomit.

Ekzistenca është në të sotmen, por jo vetëm në të sotmen. E kemi të kaluarën dhe të ardhmen brenda vetes. Ajo që është brenda vetes është në të sotmen. E sotmja e njeriut është një e sotme e zgjeruar. Ne i provojmë të gjitha në ekzistencën tonë.

Njeriu e tejkalon njeriun ekzistencial me kujtesë dhe me përfytyrim për t'u bërë njeri i qenies. Madje njeriu e pasuron Tabelën e Thelbeve të Njeriut me

kujtesë dhe me përfytyrim, me elementët më të rëndësishëm pas fjalës. Kujtesa dhe përfytyrimi sikur janë e njëjta gjë. Kujtesa mund të jetë një përfytyrim i së shkuarës dhe përfytyrimi mund të jetë një kujtesë e ngujuar në të ardhmen. Qenia nuk e kërkon ekzistencën e saj vetëm nga e sotmja. Qenia është jeta, qenia e qenies është ajo çka mbetur nga jeta në qenie nga sulmi i marrëdhënieve.

Pas fjalës, shpikja më e madhe e njeriut është nxjerrja nga hiçi e kohës dhe vendosja e saj në mendimin logjik. Ajo është rrota, që në lëvizje zmadhon rrethin e së djeshmes, synon të ardhmen duke prekur tokën vetëm një çast në të sotmen. Koha është përdorur për drejtpeshimin e qenies, po aq sa është përdorur për prishjen e këtij drejtëpeshimi. Me kohën matim jetën, me kohën matim edhe vdekjen. Ajo është një masë. Masa është instrument i jashtëm.

Koha nuk ka ligje të brëndëshme që priten të zbulohen nga mendimi. A është e mundur të para-shtrohet një llogjikë jashtë kohës? Një heshtje e madhe vjen nga njeriu.

A ka rrënjë koha? Koha e ka sendin në vetvete apo ja kemi sajuar ne? Moikomi, herë pas here, rreket t'ia zbulojë rrënjët ose sendin në vetvete kohës që është bërë pjesë e formulës së të menduarit. Dhe pyet në mënyrë tronditëse: Kohë ku je? Meqënëse nuk pret përgjigje, futet në rolin e poetit alkimist.

Sa më shumë poezi të ketë poezia aq më utopike

është. Utopikja është stigmatizuar se i mungon koha ekzistenciale dhe se është e lidhur me një metaforë. Utopikja është brenda qenies, por është një metaforë e papranuar. Prania e metaforave e zbraz poezinë nga koha. Duke u futur në thelb të poezisë ndjen se nuk të rrethon më koha, por vetvetja me format e fshehta të saj. Kur të kemi kuptuar vetveten do të kemi bërë zbulimin e zbulimeve. Vetvetja është Zoti Vetvete, ajo është më e ndërlikuar se Zoti. Zoti është pjesë e vetvetes.

Moikomi rreket të ndërtojë një njeri kulturor me të gjitha *ciklet e mëdha të kohës*. Ky është një projekt i pamundur. Është një metaforë e papranuar. Njeriu sot është i kënaqur me pak kohë, me aq kohë sa i duhet të harrojë të tashmen, ai do më pak kohë se e tashmja, e do të tashmen pët të harruar të tashmen, ai trembet nga thellësia dhe brishtësia fisnike e kohës kulturore. Koha kulturore është një kohë pa armë në mendim. Vetëm një vrimë e kohës atij i mjafton për t'u fshehur nga ekzistenca. Nuk do ketë patur njeri më të ngjitur me ekzistencën sa njeriu i sotëm. Vetëm periudhat e luftrave e lidhin njeriun kaq fortë me ekzistencën, ku çdo njeri rron për të shpëtuar kokën dhe prandaj ndihet i vetmuar dhe me ankth. Ai është si macet e shtëpisë që njohin vetëm të zotin. Nën daullet e ankthit s'mund të ndërtohet një njeri kulturor.

Metafora e Moikomit ka brënda edhe një meshë rekuiem për kohën *koha sot*. Ai është tingulli më i

bukur i kësaj metafore.

Por duhet të dallojmë projektin ideor nga projekti artistik. Moikomi projektin artistik e ka realizuar.

Brenda logjikës, ku lëvizin idetë dhe, brenda logjikës artistike, ku lëvizin metaforat, Moikomi ka të drejtë. Poezia është një realitet i ndryshëm nga e sotmja, është një përplasje me shumë thelbe të të sotmes. Ajo sikur është shkruar në të ardhmen.

E gjithë poetika e Moikomit luhet në kulturë. Në atë që është dhe në atë që duhet të krijohet.

Ekzistenca është formë e ashpër e luftës së kulturës. Edhe kultura ka nevojë të dliret, se është e ndotur me kotësi dhe me shërbime puthadore ndaj ekzistencës.

Nuk mund të jesh njeri i të sotmes pa qënë edhe njeri i së shkuarës dhe i së ardhmes.

E sotmja merr pjesë në qenie si subjektivitet fragmentar. Ne jemi ndërtuar nga paraardhësit, madje edhe nga pasardhësit e përfytyruar. Kemi filluar t'u përshtatemi pasardhësve me të njëjtën lehtësi që u jemi përshtatur paraardhësve. Moikomi këtë mendim e ka hedhur në figurë.

PËRGJIGJE NJERIUT DHE KRIJUESIT

Pasqyrë pas "Shenja koha sot me ciklet e mëdha të kohës"

Moikom i dashur!

Brenda njeriut është edhe krijuesi, i cili s'është gjithnjë i bindur ndaj sjelljes së njeriut. Ai dyshon se njeriu përzihet në punët e tij. E ç'punë ka njeriu te krijuesi?

Krijuesi brenda njeriut s'është shumë i privilegjuar, se ai e jep veten me qira te fjala, se fjala e ka logjikën të pavarur nga ai, ka rrugët e saj të hapura nga paraardhësit dhe nga vetë ajo. Krijues është ai që është i bindur se është kavje eksperimentale e fjalës. A s'ishin Lasgushi dhe Noli kavje eksperimentale të fjalës së tyre psikike? Por njeriu i tij ka një qëllim që kërkon ta kapërxejë bindjen paralizuese. Fjalën, nëpërmjet krijimit, do që ta bëjë të vetën. Ky është një përvetësim i pronës intelektuale të krijuesit nga njeriu që bashkëjeton me krijuesin. Është një përvetësim që asnjë kod moral s'ka gjetur arsye ta dënojë. Fjala duhet të bëhet e tij. E kujt? E tij? E pamundur! Por ai e ka vetëdijen për pafuqinë dhe kërkon të bëj të vetën vetëm një trajtë të fjalës dhe, gjithnjë shpreson.

Eh, ç'eklisir është shpresa për njeriun!

Nëse do të bindej, vetëm një herë, që fjala është bërë e tij s'do të shkruante më. Ky është përbetimi i të mëdhenjëve. E thyejnë penën kur arrijnë absoluten. Në atë çast vdes njeriu, që kërkon më tepër, dhe rron krijuesi. Noli dhe Lasgushi e thyen penën. Kur krijon një gjuhë poetike s'del dot më jashtë saj. Gjuha vetjake është synimi i ëndërruar i krijuesit. Të gjithë krijuesit që kanë krijuar gjuhën e tyre poetike kanë shkruar pak. Ata janë të vetëdijshëm se cilësia e përjetësisë thadrohet me fjalën e tyre. Krijimi i gjuhës vetjake është i mbrujtur me psikikë. Psikika e tyre është një kapërxim estetik. Ata vuajnë smundjen e fjalës.

Kush nuk do të shkruante më, njeriu apo krijuesi? Nuk del qartë? Jo, paqartësia është brenda njeriut.

S'mund të kërkohet më tepër qartësi për këtë çështje, aq më tepër që ajo merr trajta pronësie. Krijuesi është organ ndjeshmërie estetike dhe nuk e njeh tregun e ekzistencës.

Prandaj ndodh, që çdo gjë që shkruhet shikohet me dyshim dhe dyshimi rritet kur e shkruara duhet të niset diku.

Nuk mund të nisësh një krijim për ta kuruar lexuesi. Është e kundërta. Lexuesi pret të kurohet nga krijimi. Ai gjithnjë pret. Ndonëse rrallë, tepër rrallë, i vijnë krijime të tilla.

Edhe diçka tjetër. Kur shkruajmë ja japim veten krijuesit, që është ringjallur brënda nesh dhe ai, veten

ua jep përbërësve të tjerë, që i mban brenda. Në një farë mënyre, si njerëz, jemi të papërgjegjshëm për atë që shkruajmë se jemi qenie të përdorura nga idetë.

Brenda njeriut Moikom shkruan krijuesi Moikom. Ata s'janë kurrë të barabartë.

Krijuesit i është dhënë një gjuhë që e privilegjon. Njeriu Moikom s'mund të flasë me të tjerët me gjuhën që i është dhënë, jo se nuk do ta kuptojnë, por se ai s'mund ta përdor dot në çdo kohë këtë gjuhë.

Krijuesi duhet të zbrazet nga gjuha e rëndomtë për të fituar liritë, që janë të domozdoshme për ta përdorur këtë gjuhë, por që paradoksalisht ato vijnë nëpërmjet kësaj gjuhe. Burimi i lirisë s'është shumë i qartë se nga vjen.

Për të krijuar duhet të aktivizosh të gjithë përbërsit e krijimit, bashkë me të dhënat e tua natyrore dhe kulturore dhe, bashkëngjitur me këto, duhet ta kesh ndërgjegjen plot me liri. Pa liri të brendshme s'mund të krijosh. Liri të jep edhe krijimi, por ato s'janë të mjaftueshme po nuk i ke të lindura dhe nuk i mbron dot nga shtypja e marrëdhënieve. E të gjitha mardhënieve. Në radhë të parë, e mardhënieve njeri-krijues. Këto liri s'mund ti kesh të tuat për njëzetë e katër orë. Ato i ke vetëm gjatë kohës së krijimit.

Liri krijuese bashkë me të tjerë s'mund të kesh. Njeriu i zakonshëm s'i njeh liritë krijuese. Prej këtej rrjedh: krijuesi nuk është i barabartë (në liri) me njeriun (e zakonshëm). Së pari, ata dallojnë në liritë që ndjejnë

dhe në gjuhën që përdorin. Në këtë rast gjuha e krijuesit është cilësi, ndërsa njeriu i zakonshëm e shikon jetën të lidhur fortë pas çastit. Çasti është shtypës, se është pa pamje rezervë botëvështruese. Pa fondin e pamjeve rezervë s'mund të zgjedhësh. Zgjedhja është një trajtë lirie.

Krijuesit i është dhënë mundësia për të përdorur edhe një gjuhë tjetër dhe, kur të arrijë që kësaj gjuhe ti ketë dhënë një trajtë që rrjedh nga psikika e tij, atëherë ai është futur te paraardhësit e rrallë, që kanë lënë diçka të tyren.

I gjithë dyshimi, që kthehet në dhimbje, kur mbaron një shkrim, përmblidhet në atë nëse ai është i denjë të futet te paraardhësit? S'i ndahet ky dyshim njeriut.

Prandaj e lexon disa herë shkrimin, edhe pse ka mbaruar koha psikologjike që e krijoi. Përse disa herë?

Thamë që njeriu në shkrim ja dorëzon veten krijuesit. Logjikat e tyre s'janë të njëjta dhe botëvështrimi i tyre s'përputhet në çdo gjë. Njëri vjen nga liritë, tjetri nga jeta. Prandaj njeriu duhet ta lexojë për t'a kuptuar këtë krijues, që përpiqet të jetë krijues. Nëse bindet se ajo është një përpjekje për t'iu afruar paraardhësve, e lë të lirë të iki ku të dojë kjo pamje e krijuesit të tij. E, ndonëse njeriu e lexon disa herë krijuesin e tij, s'e shter dot të plotë. Më vonë, edhe me ndihmën e të tjerëve, njeriu kupton më shumë. Njeriu mund ta mbërthejë dyshimi për krijuesin e tij dhe ja trajton keq krijimtarinë. Trajtimi më i skajshëm është

mbajtja në sirtar dhe pastaj mohimi. Për njeriun mendja e krijuesit është një mister. Ata bëjnë jetë paralele, por kanë aparat perceptues të ndryshëm.

Sa krijues jemi? Kjo është një pyetje më shumë dëshpëruese se sa kërkuese. Kush duhet ta jap përgjigjen: njeriu i krijuesit apo krijuesi i njeriut. Më mirë të mos ngatrohen në jetën e njëri-tjetrit. Do gjendet dikush të japë përgjigje.

Ka një ilaç i cili dëshpërimin e kthen në ngushëllim. Ai gjendet brënda fjalëve: "Jo të gjithë janë të denjë të futen te paraardhësit". Pse te paraardhësit? Ku tjetër veç te paraardhësit që kanë arritur absoluten e mundshme.

Por të gjithë vijojnë rrugën me shpresë se një ditë do t'i gjejnë ata. Kjo është loja e njeriut, jo e krijuesit. Mund të jetë loja e krijuesit brenda njeriut dhe, në qoftë se është kështu, ja vlen të vazhdohet përpjekja këmbëngulëse për të shkuar te të parët e denjë. Paraardhësit vijojnë të japin dritën e tyre pa kurcim.

Qofsh mirë Moikom!



TOKË PA KOHË

Për një periudhë pa cak, arti ende s'është mendim për rymën... Këqyret nga largësi lëbyrëse, thjeshtë si një trill i një subjektiviteti të trishtuar. Është një plotëri ndonëse nga mendimi, i përbuzur. Lihet në harresë pa brerje ndërgjegjeje si diçka që s'të kujton asgjë të vlershme. Shqisat levarashe, si përherë, rendin për diku puplore dhe shqisat s'kanë patur ndonjëherë ndërgjegje të pavarur.

Arti gjëllon nën purpurin estetik. Dikur mendimi mprehet për të kaluar Skillën dhe Karibdën e figurës, që të mbrrijë së pari në pakohësinë e artit, që është kuptimi fillestar i tij. Veçse atij s'i duhen të gjithë karatët estetikë, por aq sa të ngrejë me 'ta skeletin e mendimit me art për një urë logjike të vetën. Nëqoftëse arti do të ishte vetëm mendim mendimi s'do rrekej për t'a rekrutuar. Mendimi i artit kalon si një hulli shpendësh suareal mbi kohën e ndërprerë njerëzore.

Natyrshëm, por si një plotërim ideal i natyrës dhe i qenies, ai e bën të njohur formulën e tij edhe si mendim të pranishëm, çuditërisht të papikasur. Formula e figurës s'mund të mësohet nëpër shkolla. Shpesh, shumë breza s'e hapin dot një figurë.

Mendimi matet me artin tepër vonë nga ditëlindja e

tij, se ka edhe frikë të paragjykuar prej foshnjës së ditur, të farëzuar me të veçantën. Mendimi është pjesë e së përditshmes dhe ka thelbësisht tipare praktike, ndërsa mungesa e këtyre cilësive (të rëndomta), artin e dlirësojnë.

Kur arti futet në përbërsit e mendimit, për t'u bërë zëdhënësi më jetëgjatë i tij, gjedhja rishtare, mendim me dromca arti, merr tiparet e një kapërcyelli maramendës në të dy përbërsit, që kanë pranuar bashkëjetesën me njëri-tjetrin. Mendimi bëhet më i figurshëm pra, i shtohet cilësia dhe po aq edhe një sasi e mundshme, që lexohet vetëm nën simbol prej njohësve të gjuhës së tij, ndërsa artit i është piksur shkumëzimi i figurës nga kirugjia estetike e mendimit. Arti futet si dritë e lëvizëshme spikatëse në rembat e mendimit, pa e shkëputur prejardhjen nga jermi logjik, të cilin e ka mitër zanafillore.

Kur arti shndërrohet në një mendim të thukët, ose edhe në një fjalë simbol, ai s'e shkarkon në formën e re të gjithë figurshmërinë zanafillore, sepse ajo është edhe formula e tyre e bashkëjetesës së tyre, që i mban të ndarë në lidhje dhe i ndjek pas në çdo shndërim. Një figurë mund të gjendet në shumë mendime. Edhe pse figurshmëria është futur në tragën e mendimit, ende atje ndihen vuajtet e një mospërputhje të plotë. Kjo është mënyra e bashkëjetesës së artit me mendimin.

Mendimi nuk mund ta bëjë të mosqënë pakohësinë thagmë të artit të strehuar në figurë që është e vetmja *tokë pa kohë* (e pranuar me zë të ulët). Mendimi, që e ka thirur artin për nevojat e tij, është një gjendje e dyzuar. Vetë

mendimi e njeh kohën dhe i nënështrohet asaj pa kushte, ndërsa i thiruri nga ai, s'e njeh kohën. Duhet përsëritur me theks, tokfjalëshi i pakmësipërm: *tokë pa kohë*, për të hedhur dritë të qashtër përsiatse mbi 'të. Drita duhet të jetë gryerse mbi çmërsin e mësimeve të ngulitura.

Në sajë të tokës pa kohë të figurës arti është i papërballueshëm nga ndjeshmëria e rëndomtë. Mendimi shfaqet i kapshëm, i qartë, shërbyes për një derdhje kuptimi, prandaj edhe thirret në log.

Arti s'ka log dhe kohë dhe s'i dihet kurrë gjercaku rezatues dhe dobishmëria ideale e formulës estetike. Figura është vatër që s'shteret nga mendimi sepse mendimi ende është i pabërë dhe i kontrrolluar nga paraardhësit. Figura rron duke heshtur si një trëndafil që e ka të shpërfaqur bukurinë sipërore, e cila është kulmi i lirisë së mundëshme të krijuar. Ajo ecën dhe plotësohet në përfytyrimin e vetmuar dhe, ndër mënyrat e të menduarit, spikat për formën më të bukur pra, është arti i mendimit.

Mendimi, ai që dikur e ka përthithur artin për llogarinë e tij, mund të ketë dalë nga përdorimi bashkë me arsyen e llogaritëse, por në sajë të lidhjes me *tokën pa kohë*, rigjallërohet me cikle, nën trysninë e një mendimi tjetër pasardhës.

Ndodh, në një çast të volitshëm, mendimi gjendet ballëpërballë pakohësisë thagmë dhe ky është triumfi i mendimit, por këtu zë fill vështrimi mbi brerorен e një qarku, qarqe të tjerë të mbyllur e presin mendimin për t'u lartësuar. Arti është Don Kishoti i pashtershëm në fantazi, ndërsa mendimi, shqytari i tij urdhërmarrës, Sanço Pança.



DOMINANTJA E PADUKËSHME

Dua të gjej dominanten artistike te poezia e Moikom Zeqos "Stinët e Pavdekëshme". E lexoj, e këqyr, e përsiat, e përsëri kthehem te pika e nisjes. E rilexoj me zë për ti dhënë një mundësi më shumë vetes.

Deti, - kortezh mbretëror, - dhe unë, - rufetë, - i thith, - papushim – si cingaret!

***

Dhe gjethet, - më vërtiten, - në vorbuj, - mbi supet e mia, - me

peshën, - e një qyteti hyjnor, - të ardhur, - nga e Panjohura!

***

Pastaj, - vjeshta, - boshatiset, - si një humnerë!

***

Kundër stresit, - ende, - paguaj me ditë, - nga valuta kohore, - e fëminisë!

***

Të gjithë fenerët, - e qytetit, - i mbledh, - si fruta, - në frutierën, -

-time, - dhe përjetoj, - stinët e pavdekshme!

Është një mendim i pranuar se një poezi, që të ketë një dominante artistike duhet të eci mbi skeletin e kohës heraklitiane, nëpër tre pikat që s'e harrijnë kurrë njera - tjetrën.

Po i kërkoj tre pikat e kohës heraklitiane në këtë poezi, por nuk i shquaj. Ndërkohë poezia më pëlqen. Ajo është pikturuar nga metaforat, vargjet janë të thuktë dhe, po ta ndihmoj pak përfytyrimi lexuesin, do të gjejë nënshtresa imazhesh dhe kuptimesh plotësuese. Poezia të jep më shumë se sa kuptimi linear i saj, të jep fjalët që i shpërndajnë kuptimet me fuqinë e simbolit.

Që ta bëj të plotë kënaqësinë formale më duhet të gjej edhe dominanten artistike në këtë poezi. Është një kërkesë e hershme e njohjes sime. Por kjo poezi e ka lënë skeletin heraklitian në garderobën e historisë të traditës. Me rënien e këtij skeleti ka rënë edhe dominantja artistike në formën klasike, kanë rënë edhe përbërës të tjerë. Natyrisht, do ndryshojë edhe rrjedha e rrëfimit poetik. Tre pikat, që s'e harrijnë kurrë njera – tjetrën, s'do ti gjejmë në rrëfim.

Po e kqyr poezinë dhe pikas se asaj i mungon koha si rrjedhë. Koha për poezinë është një shtrat, por mund të jetë edhe një mbivendosje e tepërt. Heqja e

një iluzioni e çliron nga pesha historike. Poezia e ka të domozdoshme çlirimin nga pesha historike.

Poetët kanë ndjekur dy rrugë, i janë përgjigjur skeletit heraklitian të kohës dhe rrugën tjetër e kanë gjetur te Syri Pindarit, te një sy i tretë i krijuesit. Edhe kur i janë përgjigjur skeletit heraklitian ata e ka patur të nevojshme pak ajër jashtë kësaj kohe. Ata kanë krijuar në poezi një çarje për t'a bërë atë më të lehtë nga pesha shtypëse e kohës. Çarja ka lejuar dritën mbi kohën e njëtrajtshme. Ndonëse rrëfimi ka qënë heraklitian, i mbathur me çizmet e kohës, çarja e ka çtensionuar rrëfimin e njëtrajtshëm. Çarja është takim me jo kohën. Vetë jo koha është poezia, bërthama e poezisë me skelet heraklitian. Ajo është edhe dominantja artistike e kësaj poezie.

Në poezinë me skelet pindarik ose e parë me Syrin e Pindarit, qenia poetike lëviz nëpër vrullet e saj. Ajo s'ka një çarje të vetme, ajo është e çarë e tëra nga shpirti prej daljeve të tij jashtë kohës.

E çara, te poezia me skelet heraklitian, vjen nga Syri i Pindarit dhe kqyret si një fuqi që del jashtë kohës. Lexuesi fiton një jo kohë brenda në kohën e tij.

Ndërsa te poezia me sy pindarik, sikur kërkojmë të kundërtën, mbylljen e çarjeve. Na duket më shumë subjektiviste se shoqërore. Dhe, për ndihmë, ekuacionin poetik të saj, e kthejmë në Shtratin e Heraklitit. Andej nisim njehsimin e poezisë. Numëri bazë i këtij arsyetimi është koha. Po arsyetimi fillon

nga arketipi kohë dhe nuk është arsyetim i pastërt, për shkak të pafuqisë sonë për të arsyetuar jashtë arketipeve.

Poezia e Moikomit është e çarë nga jo kohët, por ato mblidhen në "stinët e pavdekshme", për të kriijuar kohën e njeriut.

A kanë kohë "Stinët e pavdekëshme? Po, kanë kohën e unit poetik. Ajo është një kohë e brendshme, por e pamatshme. Është kohë me të dhëna të tjera që s'e njeh kohën mbi botë.

Uni poetik është një nga tropet më intrigues të poezisë. Ai na lidh dhe na zgjidh me kohën tonë dhe e bashkon këtë kohë me kohën e përgjithshme. Uni poetik është një jo kohë. Për këtë ai çmohet si lëvizës i brendshëm i poezisë. Ai është shpesh një qenie ekcentrike që bëhet i pranueshëm nga logjika poetike. Ai e vë gjithnjë në provë logjikën, madje edhe logjikën poetike. Ai është i lindur në qenie, ku psikika është më e qëndrueshme, ndërsa mendimet bëhen thurje të tij.

Në këtë poezi të Moikomit uni poetik çfarë kohë jep? Jep një shenjëz të kohës, vjeshtën, por ai s'futet në këtë kohë për ta udhëhequr, por për ta kundruar veten nga një lartësi tjetër. Ai është i lidhur me thelbin e natyrës së vjeshtës, me ikjen dramatike... të saj. "Pastaj, - vjeshta, - boshatiset, - si një humnerë!" Fjalët janë të ndara nga vizat ndarëse dhe kanë fuqinë e një telegrami urgjent: Po zhduket një stinë! SOS!

Të gjitha fjalët, në këtë poezi, kanë hyrë në lidhje

jo me kuptimet e para. Pra, gjuha është rikrijuar, pasi i është hequr shenja e sendit i është dhënë shenja e imazhit. Moikomi është pasuruesi më i madh i shqipes me imazhe.

Uni poetik i kësaj poezie ka lindur nga përjetimi dramatik i vjeshtës. Në vetvete koha s'është dramatike, por dramaciteti është cilësi e poetikës së Moikomit, por ai shfaqet si dramacitet i njeriut. Poezia e vërtetë është gjithnjë e përshkuar nga një tension dramatik. Uni poetik e krijon tensionin dhe po uni poetik e zgjidh nga koha poetike e dramatizuar.

A kanë logjikë të brendshme vargjet e kësaj poezie? Ato i organizon vjeshta dhe uni poetik, një shenjë e jashtëme dhe një e brendshme. Uni poetik është vënë në punë nga logjika... e ikjes së vjeshtës dhe është shfaqur me dhimbjen që jep ikja.

Vjeshtë dhe qenie, ose un poetik i dalë nga takimi i qenies me vjeshtën, ose njeri dhe natyrë, ose kqyrja e vetvetes në pasqyrën e natyrës. Dhe ç'mbetet? Ajo çka mbetet nga natyra te njeriu, fuqia dhe trishtimi. Natyra ka stinët e saj të futura në disiplinën... e përsëritjes. Stinët e natyrës me stinët e njeriut nuk përputhen. Këtë filozifi Moikomi e njeh në rrënjë. Këtej ka rrjedhur, si kundërpeshë e ikjes së vjeshtës edhe vargu përmbyllës i poezisë: " Të gjithë fenerët, - e qytetit, - i mbledh, - si fruta, - në frutierën, - time, - dhe përjetoj, - stinët e pavdekshme!". Por ndihet iluzioni, ndihet pafuiqia e njeriut që bën një veprim

poetik, mbledh dritën e fenerve për ta hedhur në stinën e pavdekshme të njeriut, por përsëri i hedh në një metaforë metafizike. Qenia e ndërprerë plotësohet me idenë, ose ngushëllohet me idenë.

Logjika e kësaj poezie zbret nëpër dhimbje, që vijon të përthyhet dhe të godasë mendimin, gjer sa shuhet përjetimi dhe lind një ide në brendësi të poezisë.

Kur themi logjika poetike zbret nëpër dhimbje, vetvetiu kemi skicuar edhe një mendim paralel: atë që ajo ka edhe një rrëfenjë të brendshme, një skelet heraklitan, që ne e kqyrim të brejtur. Si e tillë duhet të ketë një dominante të vetme poetike. Natyrisht duhet ta ketë, por uni poetik i Moikomit e shpërfaq përjetimin me Syrin e Pindarit si përjetim të përthyer në unin poetik. Ai del nga e tëra si shpërthim dhe i bën hije rrëfimit. Rrëfimi organizon të tërën, kohën, pindarizmi thekson pjesën, të çarën, jo kohën. Vetë jo koha është një kohë tjetër.

Në brendësi poezia " Stinët e pavdekëshme" ka një skelet të ronitur heraklitian, por që s'të jep mundësi për ta pikasur pikën më të lartë të poezisë sipas këtij skeleti.... se poezia e Moikomit zhvillohet në psikikë. Ajo është ksombël e psikikës poetike pindarike. Ai nuk merr hua përjetimet e paraardhësve. Ai edhe arketipet i rikrijon, i fut në gjuhën e tij.

Askush se ka thënë: "Pastaj, - vjeshta, - boshtiset, - si një humnerë!". Mund të mos ta lexosh më tej poezinë dhe s'humb asgjë. Ky varg e ka mbledhur të

gjithë poezinë rreth vetes me tensionin e një rrote që ecën në tatpjetë. Për një poet tjetër ky varg metaforë do të ishte i mjaftueshëm për t'i mbajtur poezinë dhe, ky varg, do të ishte pika më e lartë e saj. Por te poezia e Moikomit, të gjitha vargjet janë metafora, janë pika të larta, të barazvlerëshme me një dominante poetike, janë gjuhë psikike që shpërthen nga krijimi dhe nga kultura e tij.

Çdo varg në këtë poezi është një njësi poetike e mëvetshme me hapsirë të plotë dhe bashkohet me vargun tjetër jo sipas parimit të nënrenditjes, por sipas parimit të pavarsisë relative. Logjika poetike formale bashkuese e vargjeve është tërhequr në brendësi, në rastin tonë, në përjetimin e vjeshtës, dhe ka lënë në sipërfaqe imazhet e figurave dhe brenda tyre, natyrëfilozofinë. Logjika e poezisë së Moikomit e ka lënë nën hije logjikën gramatikore, logjika e gramatikës i është nënshtruar logjikës poetike. Kjo është një triumf i shenjave të dyta të fjalës mbi shenjat e para.

Në lidhjen e vargjeve të kësaj poezie parimi i pavarsisë relative u ka dhënë më shumë liri vargjeve për të shprehur vetveten. Por logjika e vargjeve nuk është anarkike. Ajo është bashkuar nëpërmjet lirisë së njësive poetike. Mendimi subjektiv e ka gjetur shprehjen më të përkryer në poezi, në këtë formë të përjetimeve.

Vargu i parë, " Deti, - kortezh mbretëror, - dhe unë, - rrufetë, - i thith, - papushim – si cingaret!", duket

më i pavaruri dhe më i palidhuri me të tjerët.

Një shkrifërim i sipërfaqshëm semantik i fjalës vjeshtë do të na thotë se në vjeshtë ka shumë rrufe mbi det. Nuk duam të theksojmë dobësinë e Moikomit për detin, që ja thith papushim (dramatikisht) rrufetë si cingaret. Theksuam se vargu i parë është vjeshtë, e parë nëpërmjet psikikës së figurës. Të gjithë tradicionalistët e poezisë nuk do ta përjetonin kurrë këtë varg. Dhe kurrë nuk do ta mendonin unin poetik si feprishje poetike të hullisë së të hapur prej të parëve të tyre. Ata do të tmeroheshin nga ky varg.

Logjika e brendshme e këtij vargu është e lidhur e tëra me vjeshtën. Rrufetë djegin. Duhet përsëritur ky togfjalësh, për ta risjellë ashtu siç ka lindur në psikikën e Moikomit, në çastin e krijimit të poezisë. Rufetë në vjeshtë djegin. Në këtë çast ka lindur poezia. Ka lindur si dhimbje e djegjes së stinës nga rrufetë. A nuk krijohet vjeshta nga një djegje e brendshme? A nuk i vë vjeshta zjarrin vetëvetes? A nuk e përgatisin vjeshtën vizualisht ngjyrat e rufeve? A nuk është fisnike, madhështore, utopike, mbrojtja, mosdorëzimi i vjeshtës nga uni poetik? Dhe tymi i nënkuptuar, nga cingaret e rrufeve, që shfryn nga shqisat e poetit, është një gjendje, një prelud.

Poezia e Moikomit është në thelb natyrore, para se të jetë e rymave letrare. Psikika e tij triumfon mbi elementët e tjerë të poezisë sepse i jep shpirtin dhe formën e saj poezisë. Poezia e Moikomit është degë

e trungut të poezisë së Uitmanit. Por natyroren e ka mbështjellë me psikikën e imazheve me thekse moderne. Kultura i ka dhënë çika guximit të shprehjes, por në brendësi komandon natyraliteti psikik. Edhe imazhi është natyrë, por i parë me përfytyrim.

Psikika krijon gjendje, arsyeja end rrëfim. Arsyeja te Moikomi është thadruar në psikikë. Atje është dobësuar dhe është vënë në shërbim të psikikës. Kjo e shfaq poet të lindur dhe të madh. Poezia e Moikomit është lirikë e psikikës dramatike.

Le të përpiqemi të nxjerrim një moral nga poezia "Stinët e pavdekëshme". Morali do të ishte edhe një paralele e pikës dominante të saj. Morali ka dalë nga përvoja njerëzore. Ai priret ndaj virtyteve. Në këtë poezi kemi metafora të fuqishme të nisura nga foljet, por vetë foljet janë të plogta, pësore. Morali është aktiv, veprues. Metaforat thadrojnë një gjendje të unit poetik. Morali mund ta ndryshojë një gjendje. Por ai përballë stinës vjeshtë është pa kuptim. Uni poetik përball stinës vjeshtë end stinën e vetvetes. Ai mer trajtën e filozofisë estetike.

Uni poetik ndjen, por ndjen në sallën e vetvetes dhe këndon me të gjitha ngjyrat e ndjeshmërisë, por ai nuk ndryshon dot asgjë. Ai me këngë shpjegon pozicionin e vetvetes përball asaj që e kemi emërtuar vjeshtë, shikon ndryshimin dhe fundin e saj. Ndriçon të vërtetat e fshehura të natyrës me mjete të bukura. Këtu mbaron e drejta e tij. Këtu mbaron edhe e drejta

e poezisë. Më tej e marin në dorë moralistët.

Në brendësi, dominantja artistike është dhimbja që na e nxjerr natyra me trajtat e saj, por ne me kok-fortësi duam edhe një dominante artistike të jashtme, të dallueshme.

Drama ka kuptim si mardhënie njerëzore. Ajo ka edhe pikë kulminante. Por "Stinët e pavdekëshme" nuk janë dramë njerëzore, pavarsisht nga përjetimi dramatik i Moikomit. Nëse s'ka dramë njerëzore s'ka edhe pikë kulmore të saj, se natyra është përjetësi dhe çdo dramë e njeriut përball natyrës bie nga shtrati i mendimit, se është i stisur. Mbetet gjallë vetëm poetika që nuk është një mendim logjik rigoroz.

Atëherë duhet të rravgojmë në një hulli tjetër për të gjetur dominanten artistike të poezisë "Stinët e pavdekshme, ndonëse, gjer tani, i kemi lënë shenjat e saj nëpër rradhë.

Le të kqyrim përsëri foljet e kësaj poezie. Ato janë vendosur në mes të vargjeve. Në të dy kahet nxjerrin metafora. Një folje shpërndan dy metafora. Kjo është një mrrekulli e fuqisë poetike të Moikomit. Është një strukturë e re e fjalisë poetike me një ekonomizim të fjalëve, që është një fat hyjnor ta ndeshësh. Ky është edhe stil i epërm.

Le ti përsëritim foljet e poezisë: thith, vërtiten, boshatiset, paguaj, mbledh, përjetoj.

Mbas tyre qëndron uni poetik, pak ekstravagant, pak dramatik, pak patetik, pak panteist, por gjithnjë i

sinqertë. Brenda këtyre foljeve nis uni poetik.

E nisur nga folja në metaforë, gjendet rruga e dominantes artistike të poezisë së Moikomit.

Folja tregon veprim, ajo e çan rrugën nëpër sende, nëpër tre pikat e kohës, pra është e lidhur me skeletin heraklitian. Ajo është e mbarsur me energji, që do që t'i shpërndajë për të shpëtuar vetveten në rrethana.

Figura është pa kohë dhe pa tokë, është përfytyrim, është e parë vetëm me Syrin e Pindarit, është e çara e kohës.

Te Moikomi, figura e merr energjinë e parë te folja, merr dhe gjendjen e saj të brendshme. Gjendja e brendshme e foljes lidhet psikologjikisht me metaforën. Folja bëhet rrënjë e metaforës. Moikomi nuk vetshkarkohet nëpërmjet foljes, por nëpërmjet metaforës, por figura ka lindur nga gjendja e brendshme e foljes. Folja e Moikomit është një gjendje në ethje. Metafora i merr energjinë e foljes, jo veprimin e saj. Në qoftë se do merrte veprimin, ajo do endej nëpër sende, dhe do ishte e detyruar të fliste me gjuhën e parë të sendeve. Energjia e lidh figurën me idenë poetike dhe me gjuhën e dytë të sendeve.

Dominantja artistike në këtë poezi është e padukshme... edhe për shkak të foljeve në ethje, jo në shpërthim. Shpërthimi i gjendjes në folje do ta vendoste veprimin në një lartësi. Foljen, Moikomi, sikur e zhyt në ujin e vet bashkë me ngarkesën psikologjike. Duke u zhytur, folja, lëshon figurën, për ta shpëtuar bijën

e saj të ndritshme. Ajo ka bindjen se figura është metafizike, ndryshe nga vetja e saj që është shkëlqimi i një çasti.

Në qoftë se do të këmbëngulim për të gjetur domominanten formale të kësaj poezie, atë do ta kërkojmë te vargu "Pastaj, - vjeshta, - boshatiset, - si një humnerë". Por ajo është një dominante pindarike e ndërtuar mbi një imazh. Ky varg, dramën njerëzore e ka futur në hullinë metafizike dhe ka edhe aftësinë që të krijojë edhe skeletin e dominantes artistike me kohë heraklitiane. Edhe dominantja e tij do bjerë po mbi këtë varg. Folja zhytet në ethjen e vet, figura e lë veprimin në hije, kështu të dyja dominantet e mundshme neutaralizojnë njera – tjetrën paqësisht, por mbetet shija e dominantes pindarike.

FJALËS S'I MJAFTON KURRË NJË KUPTIM

Unë jam i varfër dhe s'mund të bëj dhurata, por Moikomit do ti fal Vjosën.

Le ti japim Medaljen e Natyrës Moikomit për ato pak metra katrorë det që i ka në kujtesë.

Po të kishte lindur te Rrapi i Libohovës Moikomi do të ishte rapsod.

Ca njerëz nuk vdesin dot nga pavdekësia në Parajsën e Moikomit.

Moikomi është ateist që në çdo udhëtim e ka Krishtin në krah.

Jeta duket si Java e Madhe e Pashkës.
Të gjithë personazhet historik dhe të trilluar vijnë për ta vizituar.

"Nga myku, - i librave, - si ta bëj – penicilinën, - për turberkulozin – e hyjnive?"

Metodat e harruara të alkimistëve Moikomi i ka fshehur në parfumin e lirikës.

Ata që e shijojnë poezinë vetëm nga dominantja artistike heraklitiane
S'kanë pirë antidot për t'u futur në minerën e Moikomit.

Semaforët, Moikomit, i kujtojnë Tri Botët e Dantes.

Ndonjëherë, edhe Moikomi, lind fjalë të vdekura si E Premtja e Zezë.

Edhe te Moikomi "Heronjtë, - tani, - janë, - refugjatë - tek Hiçi! "

Fjala poetike s'është asnjanjëse, por Moikomi e kthen në akuarel,
Që çuditërisht këndon mërinë e njeriut për veten.

Frikë të madhe përjeton Zoti kur shikon Diellin!

Moikomi e mban vështrimin edhe te shenja grafike e vizës ndarëse,
Sepse ajo po vendos edhe një herë kufijtë e simboleve të fjalëve.

Sikur të shfrytëzohej energjia e metaforave të Moikomit

Do të elektrifikonte gjithë malet shkëmborë të botës.

Kthehuni, u thotë Moikomi Perandorve të Durrësit. Dilini nga trupi i gjatë i Historisë.
Për Ju kam prositur këpucë te Argjendari Diell, që të shkelni me 'to tokën e të parëve.

Të gjithë artistët joshen nga Pagani Diell.

Të dashurës së Moikomit i mungon mishi i mëkatit.

Moikomi i ka takuar, një nga një, mistikët nëpër shpella,
Ndërsa mistikun Naim Frashëri e ka takuar tek Ëndërimet e Tij.

Maria e mbajti Krishtin në strehën e mishtë nëntë muaj diellorë,
Moikomi e mban poezinë gjithë jetën në Frymën e Tij të Shenjtë.

Nuk e di kush është poeti, Moikom Zeqo apo Makabe Zaharia?

Fjalën e Moikomit e ka kapur ryma elektrike e psikikës, për t'a shpëtuar i lëshon imazhet.

Poezia e Moikomit është e modelit të fortë dinamik.

Për Moikomin ka edhe Parajsa të Pista. Ato janë të njohura në Tokë.

Me frymëmarrje burri mendimtar Moikomi i jep ritëm poezisë.

Duhet të thithim gjithë burnotin e shekujve të tështijmë ca luftra.

Jeta si dhe Toka i përkasin Njeriut jo Pronarit. Ato janë pasuri e njerëzimit.

Ajo që s'mund të prodhohet, s'mund të shitet. Njeriu s'mund të blihet nga shteti.

Së shpejti gjithë njerëzit do jenë skllavopronarë. Do blejnë skllevër robotë në supermarkete.

Nëqoftëse Bota do të zhvillohej me metafora,
Banka e Moikomit do të ishte më e fuqishmja.

Moikomi ka globalizuar edhe kohën e shkuar me aksionet e poezisë.

Metafora është kështjellë e ngritur në lartësinë e mendimit pa mure ekzistencialë.

Kush e pi cigaren: Moikomi apo Makabe Zaharia?
Tymin kush e shikon si mistikë të natyrës?

Cigaren Moikomi e ndez me zjarr Prometeu.
Si shpëton pa u djegur përfytyrimi nga zjarri i zotave?

Moikomi gjithnjë pyet: Ç'jemi? Pyetet edhe ndryshe: Kush është njeriu?
A ka model të njeriut? Për pyetje të tilla s'ka ardhur koha.

"A do t'i sjell, - kjo Hënë, - patjetër, - edhe Dardanisë, - një det?"
Ç'varg i çuditshëm! Një "patjetër" e bën si imperativ kategorik.
Pa atë "patjetër" edhe De Rada do mahnitej nga akuareli i fjalëve pyetëse.

Moikomi, ai liriku revolucionar i Komunës së Parisit të Poezisë.

Moikomi është kundër diktaturës intelektuale.

Kush grumbullon fuqi më shumë seç i duhen është i racës së diktatorëve.

Kuptimet, nëse janë kuptime, formulojnë qenien.

Moikomi e përdor rimishërimin e Pitagorës edhe si argument se s'ka qenie orgjinale.

Moikomi e pranon që është joshur nga panteizmi i Naimi Frashërit.

Rimishërimi ka qënë para dhe është edhe pas Pitagorës në formë artistike dhe shkencore.

Ai ka ndihmuar zhvillimin e botës, prandaj është Ide.

Moikomi s'e ka fshehur kurrë që Pindari, Pitagora dhe Herakliti janë mjetet e tij artistikë.

Moikomi është fshehur te folja, gjymtyrët e tjera ja ka lënë metaforës ti përdorë.

Strukturë poetike më e thjeshtë s'mund të gjendet.

Moikomi e shkëmben foljen me trajtat e ndajfoljes, edhe atje është syri i tij i madh.

Natyra e përkorë s'ka plagë, ato gjenden brenda qytetërimit.

Moikomi u kujton kohëve teknikat poetike të harruara.

Ka mbetur ndonjë gram përvoje poetike pa u përdorur nga Moikomi?

Për Moikomin, poezia është frymë mistike kur rrethanat i lë jashtë.

Kaini kapërxeu pragun e qenies. Ra në boshësi. Tani është edhe jashtë etikës.

Te njeriu s'ka të vërteta, ka qenie të përdorur nga rrethanat.

Ata që e përdorin qenien për të mposhtur rrethanat vdesin shpejtë.

Moikomi e bën fije-fije fjalën, merr një fije dhe e bën Pemë Parajse në Purgator.

Fjala lëshon energjinë natyrore, metafora lëshon edhe energjinë e konceptit.

Kuptimi i shumës së fjalëve të metaforës s'është sa kuptimi i fjalëve natyrore të saj.

Metafora i fut në alkiminë e saj fjalët natyrore. Ajo është faza e dytë e gjuhës.

Kur shfaqet një metaforë mrrekullohemi dy herë.
Nga koncepti i ri i krijuar dhe nga gjuha e re që lind.

Poeti Moikom Zeqo është më i plotë se Moikom Zeqo erudit.

Brenda poetit udhëheq liria që krijon, brenda eruditit udhëheq dija që e përsëritin rrethanat.

Liria është rrënja e natyrës, por njeriu mbjell në vetvete teknikën e shtetit.

Lirinë askush s'e ka kuptuar.

Liria më e dhimbëshme është vetëvrasja për mospërmbushjen e qenies.

Vetëvrasja për ekzistencë është një vdekje e përshpejtuar.

A ka një histori të meditimit? Askush s'e di. Pyetni Moikomin.

O- në Moikomi e përjeton si një rruzull që zgjerohet nga frymëmarrja e tij,
Ose si një shpirt që pastrohet nga smundja e pasthirmave.

Çdo "Ah!" mund të jetë si pasthirma e fundit e Kaosit,
Kur shpëtoi nga vetëvetja dhe u bë gjithësi.

Çdo “Ah!” i Moikomit është pasthirma e fundit e kaosit të tij kur shndrrohet në poezi.

Kush del nga kaosi gjendet në bollëkun e virgjërisë.
“Dhe unë, - bredh, - i vetmuar, - si turma, - e vizioneve të mia!”

Grafikisht, vargu i Moikomit, është më i stolisuri në poezinë shqipe.
Presja e tij të kujton kolektivtetin spartan, viza ndarëse individualitetin athinas.

Në qoftë se do të krijohej ushtria e cituesëve,
Moikomi do të kishte ushtri më të madhe se Aleksandri i Madh .

Arkivolet e shpirtrave të gjithë botës i porosit Pitagora.

Dhe – ja, kjo lidhëse e rëndomtë, shpesh bën një punë fisnike,
Lidh imazhet e largëta. Ajo është Syri i Pindarit.

Çdo varg në lirikën e Moikomit është edhe një lidhëse logjike dhe poetike.
Vargu Lidhëse i Moikomit zëvendëson logjikën formale të gramatikës.

Vargu Lidhëse i Moikomit ka prishur dominanten artistike heraklitiane.

Moikomi është krijues i një logjike poetike. Ajo mund të këqyret me Syrin e Pindarit.

Ushtarët e poezisë së Moikomit s'mbajnë të njëjtën uniformë,
Por kanë frymën e gjeneralit metaforë.

Moikomi ka marë gradën Gjeneral i Ushtrisë së Metaforave Moderne.

Moikomi ka shumë shenjtëri laike, por mbi gjithëçka ka shenjtëri natyre.
Me këtë shenjtëri natyre Moikomi krijon metaforat.

Rruga poetike e Moikomit kalon nga shenjtëria laike në shenjtërinë e natyrës.

Moikomi nuhat parfumet e shekujve të shkuar që s'përdoren më nga zonjat me kapele.

E dashura e Moikomit ka rënë në Kohë dhe në Hapësirë.
Ka humbur tiparet. Në asnjë radiografi nuk del.

Moikomi të dashurën ja ka blatuar Kohës dhe Hapsirës, hyjnive laike.

E dashura e Moikomit është rrënjë etike.

S'ka më virgjëresha të flijuara për Zotin, ndonëse ai i pranon
edhe të zhvirgjëruarat, se është bërë personazh i Tokës.

Moikomi e josh Krishtin të zbresë Një Kat më Poshtë.
Zoti Krisht ende s'i ka hequr gjëmbat e zinj të Tokës nga shputat e këmbëve.
Një gjëmb hiqet për shtatë ditë hyjnore.

Pa Rilindjen e Tij, Krishti do të ishte një Zot i mëzitshëm si jeta në Tokë pa teatrin e vet.

Moikomi është si Juri Gagarini që s'e pa Zotin as jashtë Tokës.

Zoti, te Moikomi, është personazh i Idesë Absolute të Poezisë.

Çdo bëhet me ëngjëjt tani që Zoti është bërë personazh?

Moikomi krijoi dy personazhe të rinj: Zoti, Zoti! dhe Deti, Deti!

Dhe u dha pajimin e rëndë të pikëçuditëses mbi shpinë.

Zoti është bërë më i vogël se njeriu, ndërsa Deti ka mbetur siç ishte.

Njeriu ende se ka krijuar Etikën e Zotit të Tij Laik.

Moikomi ka një qëllim fisnik. Aq sa është tagri i krijuesit.

Ai e do Zotin personazh. Mos jeton Lukiani në trupin e tij?

Zoti, Zoti! - personazhi i Moikomit, s'ka fjalë, s'ka rol. Kujtesën ja ka krijuesi.

Estetika s'ka gjetur truall ku ti bëjë shtëpinë këtij Personazhi pa Kujtesë.

S'e kam pyetur ende Moikomin: Si krijon muzikalitet me energjitë e kundërta të fjalëve?

Gjersa ta pyes do mendoj se energjitë e kundërta i fut në makinën natyrore të dialektikës.

Psikika e Moikomit është antidiktatura e poetit Moikom.

Koha është asnjanjëse. Ky tipar e madhëron kohën.

Moikomi është poet pa popull, që ka mbirë në të ardhmen. Kjo nuk është fatkeqësi.

E ardhmja nuk është fatkeqësi, aq më tepër që atje është mbjellë një estetikë.

Pse ka kaq pak lexues Moikomi? Se të tjerët s'janë lexues.

Kur të çmohet poezia vetëm nga estetika, Moikomi do zërë një vënd të epërm.

Poezia e Moikomit është e elektrifikuar në qelizë.

Fjala është e elektrifikuar me dritë natyrore dhe psikike, edhe drita psikike është dritë natyre.

Jo të gjithë e kanë çelësin e dritës së fjalës që është dritë psikike.

Moikomi luan golf me historinë, ndonëse është i përkorë si një proletar.

Parada më e madhe e Historisë bëhet në Shëtitoren e Poezisë së Moikomit.

Pikën dominante të poezisë Moikomi e nis nga folja për në figurë.

Shpesh, çdo varg i lirikës së Moikomit është një poezi e plotë.

"Shoh – nga dritarja – e shekujve – dhe zgjas – duart prej shiu, - drejt, - tërë kontinenteve!"

Moikomi fjalinë dëftore e përdor për nevoja të domozdoshme.

Shenjat grafike Moikomi i përdor me elegancë sikur ndodhet në pritjet

E Mbretit Diell. Ato mbeten në kujtesë si servitorë mbretërorë.

Shumë kohë në një ligjërim bëhen polifoni.

Polifoninë e parë e shpiku deti kur ndjeu dhimbje nga rufeja.

Moikomi është bërë Zëri i Parë i Polifonisë së Detit.

Truri është gdhendur nga fjalët.

Moikomi po e vë në provë trurin me metafora.

Poezia e Moikomit shëmbëllen me një Festë Purgatori e joshur nga Parajsat e Humbura.

Moikomi po gjeti një çast, me siguri, do ta bëjë kohë poetike me shumë kahje. Kjo është alkimi.

Sikur Pitagora ta fuste shpirtin e Omar Khajamit në trupin e Moikomit,
I Vjetri do jepte disiplinën e rubairës dhe do merrte fantazinë e tjetrit.

Po të digjeshin arkivat e Shqipërisë historianët do t'u ktheheshin poezive të Moikomit.

Sikur të ngjalleshin Të Vdekurit e Mëdhenj,
Ato do tregonin me gisht Eliksirin në Kujtesën e Moikomit.

Natyra, te Moikomi, është bërë pjesë e kulturës krijuese. Ky është kulmi i shfrytëzimit poetik.

Poezia e Moikomit rrjedh nga Atdheu Botëror i Estetikës.

Moikomi është nga raca e etërve të poezisë së përbotshme.

Moikomi i shkelmon fjalët për t'u dhënë energjinë që u duhet në rrugë dhe në rrethana të vështira.

Dominantja artistike është nga shpikjet më të mëdha të artit.

Ajo ka skeletin e kohës heraklitiane. Çelsin e saj e ka lartësia morale e kohës.

Moikomi është aq mjeshtër i përdorimit të foljes, në pozicion tjetër, sa edhe Fan Noli.

Te Noli, folja është pika dominante e energjisë së fjalëve.

Moikomi nuk e përdor dominanten poetike me skelet heraklitian.

Ai përdor skelet pindarik. Atje qenia lëviz nëpër idetë e saj.

Në brendësi të lirikës së Moikomit gjallon edhe një dominante me kohë heraklitiane.

Dominantja poetike me kohë heraklitiane merr trajtë pindarike nga psikika e Moikomit.

Po të bëhet lidhja logjike dhe poetike e foljes me metaforën,

Në lirikën e Moikomit do zbulohen pamje të fshehura.

Ata që do ta kuptojnë Lirikën e Moikomit do na tregojnë se ai përdor

Në një poezi dy dominante, që neutralizojnë njëra – tjetrën, paqësisht.

Njëra dominante ishte te Vargu Lidhëse dhe tjetra te metafora.

Është nga gjërat më serioze të stdudiosh poezinë e Moikomit me dominante të neutralizuara.

Në poezinë e Moikomit fjalët marrin kuptime të reja nga semantika e metaforave.

Poezia e Moikomit është një gramatikë e re poetike.

"Kush, - në minerën, - e ajrit, - mblodhi - arin farfuritës, - të rrufeve?"

Folja në qendër ka lëshuar dy metafora, në dy kahje, njëherësh.

Unë u kthehem foljeve për të kuptuar poezinë e Moikomit.

Ato nuk kanë energji noliane, por janë qumshti i metaforave.

Ato janë edhe si kohë të flijuara për për metaforat pa kohë.

Ajo që lidh të dukëshmen me të padukëshmen dhe vetë mbetet e padukëshme është lirikë.

Prosodia e Moikomit i nënështrohet psikikës dhe shenjave grafike.

Instinkti krijues i Moikomit ka vënë buzët te kultura si foshnje e etur.

Ata që s'e shikojnë sot Moikomin s'do ta shikojnë as nesër.

Edhe mekanizmi i teknikave është instinktiv, askush s'ia ka mësuar metaforën Moikomit.

Po të gërmosh në vetëdijen e Moikomit, që me kazmën e parë, do të nxjerësh Statujën e Migjenit.

Statuja e Migjenit ende s'ka përfunduar, ndonëse Moikomi po punon gjithë jetën për 'të.

Statuja e Migjenit do përfundojë kur t'i bjerë pika e fundit mahnitjes së Moikomit.

Moikomi kur kujton Migjenin të tjerët i zvogëlohen.

Asnjë krijues s' mund të bashkojë moshën njëzetë e shtatë vjeçare me universin që zgjerohet nga Migjeni.

Migjeni është Mbinjeriu i Vetëm që kemi. Ai është edhe Njeriu i Parë i Mbinjeriut.

Moikomi kthen kokën majtas-djathts, s'gjen shokë dhe zhytet te polifonia e Detit, Detit!

Për Moikomin shenjat e pikësimit janë fjalë të një alfabeti tjetër, që jo të gjithë dinë ti përdorin.

Brenda poezive të Moikomit qëndron edhe një recitues që ankohet

Për më tepër disiplinë herakitiane, por krijuesi i tij ka shpirt pindarik.

Moikomi ka dalë i zhgënjyer nga pushteti i mëparshëm poetik.

Moikomi i gëzohet pushtetit të ri poetik që e ka krijuar vetë. Kjo do të thotë poet.

Moikomi e ka gjuajtur poezinë në metaforë me shigjetën e harkut të foljes.

Të gjitha pyetjet e Moikomit janë ankthe ekzistenciale. Ai u jep atyre imazhe për ti kuruar.

Mos po krijohet një Bibël e Re?

Nën lëkurën e Moikomit janë ngjyrat e Van Gogut dhe fantazia e Jeronim Bosh-it.

Unë s'e harroj dot këtë varg të Moikomit: "Dhe lypësi më i mjerë, i hakërrohet Dantes:

“ Ti s’di,- asgjë, - për Ferrin!” Këto janë fjalë të një lypësi gjenial.

Moikomi u ka dobësuar lidhjet formale fjalëve për t’u dhënë energji.

Një fjalë që prodhon shumë energji është bërthamë për simbolin.
Moikomi përdor edhe simbolet e gatshëm.

“Pse, - drurët, - lumi, - yjet, - dhe stuhia, - mbajnë erë njeriu?”
Pyetja të shtang, vargu të këndell me parfumin natyral.

Sot, Moikomi, është njeriu më i pasur i planetit me metafora.

Si qytetar shëmbullor, Moikomi është zëmëruar me shtetin, por u bie në gjunjë luleve.

Ndonjëherë Moikomi thotë po afron Koha Profetike. Po Makabe Zaharia, ç’thotë?

Të rroj apo të mos rroj? Kjo është çeshtja, tha Zoti dhe iku gjithë zëmërim kur erdhi Shekspiri.

Meshën rekuiem në Shqipëri Zotit ja blatoi Migjeni.

Naimi u tret në gjithësinë panteiste. Atje i ka mbajtur një vend dishepullit Moikom.

Koha do ti zhvarrosë varret e tyre me thundrat e kalit të Skënderbeut, për t'i nisur në Krujë.

Moikomi është dishepull i shumë shkollave poetike, por është mjeshtër vetëm i shkollës së tij.

Në qoftë se Moikomi e do të kaluarën time, unë ja jap bashkë me Minerën

E mbyllur të Memaliajt, të futë gjithë djajtë me kravatë në atë Ferr.

Do t'ia ndërroj surumet Moikomit, do ti jap Ujë të Kaltër Vjose.

Metaforat e Moikomit po futen në errësirën e Dodonës.

Unë do ti them mirëseerdhët Lisave të Tempullit të rilindur.

Moikom, zbrit nga Çasti i Madh, - Koha dhe nga rimishërimi i Pitagorës!

Jeto mes drurëve të metaforave, se ato të krijuan, ndonëse i zbulove ti!

Njeriu është një udhëtim në vetvete.

Udhëtimi në vetvete i poetit bëhet me Pegas Utopik.

Fjalës s'i mjafton kurrë një kuptim.

FJALËT KTHEHEN NË RRUGËT QË LINDËN

Pasqyrë pas "Dominantja e Padukshme"

Po e këqyr fjalën. Është e vjetër, përafërsisht e pavdekshme si asgjëja. Janë bërë gati të gjitha almisat për t'ja hapur trupin e brishtë. Kam menduar me përpikëri mënyrat për t'ja mbyllur trupin e hapur, që ndodhet në duart e mia. Edhe vendimi për ta lënë të lirë është nxjerrë. Të shkojë ku të dojë, megjithëse ajo i ka të vetparacaktuara rrugët dhe, do të kthehet përsëri, në po ato traga ku lindi. Ajo është po ajo, pas çdo rilindje dhe, rilind gjithnjë, po mbi shtratin e moçëm të vetvehtes. S'ka vetëm një lindje dhe jeta e shkurtër e njeriut s'mjafton t'ja numërojë ato, por edhe nëse jeta do ishte tepër më e gjatë, përsëri do të mbetej po ajo pamundësi. Lind vetëm për një çast dhe pastaj tërhiqet në errësirën e saj. Kur e thërresim vjen. Dhe, asnjëherë s'ja dimë sasinë e përdoruesve dhe dëndurinë në atë çast. Mund të themi se bëhet e mosqënë mbi atë rrugë, që e lindi dhe, nga liturgjia e tingujve të vetvetes, rringjallet. Për përdoruesin, lindja e saj mbetet e pa vënë re, nga që është bërë pjesë e qenjes së tij, ndonëse është përherë e proshkët si e sapodalë nga lëngjet e

përfytyrimit. Në rrethana ndryshon paksa, merr pahun e tyre, ky pah është trajtë. Po flasim për fjalën në njëjës, mbase s'është e drejtë, se kështu ja brejmë shtresëzimet e fshehura.

Fjalët janë si foshnja të ditura, por mund të thirren dhe me cilësimin nderues "të moshuara", që s'dinë më shumë se një foshnjë e ditur. Ky kryqëzim kahesh (të një kuptimi), mbase s'jep asgjë. Një foshnjë e ditur, që i ka kaluar caqet e rritjes së saj të natyrëshme, pa nevojën e një jete me përvojë, është një provë e një qenie pa kohë, ashtu si edhe një e moshuar, që s'di më shumë se një foshnjë e ditur, që ka mësuar vetëm kur ishte foshnje, dhe s'ka patur periudhë tjetër, përveç foshnjërisë kur u hap drita për të. Edhe foshnja edhe e moshuara kanë tharm të njëjtë me një parahistori.

Kur jeton nuk e shikon jetën. Për fjalët, mund të thuhet, që s'e njohin jetën e tyre ashtu siç i njohim ne njerëzit ato, ndonëse edhe ne njerëzit kemi cipën e verbërisë. Ndoshta edhe ne fjalët na njohin ndryshe.

Thuhet se dikur ka patur gjer në tri zogj feniks, që rringjalleshin nga hiri i tyre. I pa përfillshëm ishte numuri i këtyre zogjëve mitikë përballë miliona fjalëve, që ringjallen nga vetvetja, pa përplasje flatrash. Ato janë të njëjta edhe para edhe pas rilindjeve, me po atë sasi jete, me po ato trajta, me po ato tinguj, me po ato kuptime. Vetëm në peshoren psikike ato ndryshojnë në trajta. E përjetëshme është tipi i fjalës. Është rasti të thuhet, se përjetësia, nëse ka të tillë, është strehuar te

fjalët, që s'vdesin kurrë. Njeriu i lidhur me fjalët është i pavdekshëm. Jashtë fjalëve ai vdes. Kjo është gjendja e tyre e pastërt, por këtë urtësi e gëryen ndriçimi që shkëmbejnë ato në bashkëlidhje dhe klima pskike e atij që i përthith. Brenda qenies së ndërprerë, ato s'mund të jenë të përjetëshme. Përfytyrimet kanë trajta dhe futen në hulli të reja, ku humbin formën e përjetësisë. Rrugët e fjalëve janë ryma në mendim, atje gjëllin jeta e tyre. Jetë mbi rrugë, shtjellë apo diçka e përafërt, e përsëri ato s'janë boheme. Edhe trajtat e fjalëve janë të dhëna nga fuqi të panjohura paraardhëse dhe, ngjajnë me lojtarë rezervë, që presin të futen në lojë për të dhënë taktika të reja të mendimit.

Fjala merr pak dritë në mbaresë dhe shquhet, rifillon të eci në hullinë e saj, e përndezur. E njëjta fjalë, kur i shtojmë një tingull tjetër, në fund të saj, ndryshon dhe bëhet e panumërt. "E-pa-numër-ta" është jashtë kufirit të mundësive tona. Ajo është gjithësi, ose përfaqsuese e gjithësisë. Të vdekshmit, janë mësuar me numra, por shumësi i fjalëve s'i njeh as dhe të ashtuquajturit numra natyralë, as pafundësinë e rreshtuar të numërave.

Fjala, nga vetvehtja, me një tingull shtesë në mbaresë shumohet dhe kjo ardhje me shtim është e magjishme. Duket sikur ajo ja njeh mundësinë vetvetes, madje edhe trajtat e saj në rrethana, por s'i mendon kurrë rrethanat, ndonëse është e gatshme për rrethanat, që i paraqiten, prandaj të shtyn të mendosh,

me pa të drejtë, se fjalët kanë kujtesë dhe logjikë, që e vënë në përdorim.

Shumimi i saj s'mund të shkërbehet dhe është zej i ndaluar për njerëzit, që gjithë jetën rropaten të shtojnë paksa mundin e vetvetes, por s'e arrijnë. Mbase shumimi i fjalëve nga vetëvehtja është një nga mësimet e tyre të vyera, që për ne mbetet ëndërr. Shtesa është brenda vetvetes jo jashtë saj, por nuk mund të shikojmë brenda vetvetes.

Në shumësin natyral fjalët janë të panumërueshme dhe caku ynë bie ndesh me pacaksinë e shumësit të tyre. Fjala, ajme! përfaqëson vetëm arketipin dhe ne endim në përfytyrim të quajturin shumës të tij, pa mbrritur kurrë te pacaksia e fjalës, se është me cak ajo që njohim. Edhe përfytyrimi ynë për shumësin është i cunguar. Ai është i vendosur në rrethana të ngulitura, të cilat na ndikojnë për të përcaktuar.

Thuhet se asgjë s'është e barabartë me vetveten, por ka një përjashtim, fjalët në shumës, që i kalojnë caqet që njohim për riprodhimin e jetës si zinxhir ndryshueshmërie. Para alkimistëve të dështuar kanë qënë përfytyruesit e suksesshëm të fjalës.

Rugët, mund të mbushen me të njëjtën fjalë që e riprodhon trajtën e vetvetes, me një tingull shtesë. Është sikur lë në një dhomë të mbyllur vetëm një fjalë të brishtë në erësirrë dhe kur hap dritën, gjithë dhoma është mbushur me të njëjtën fjalë. Udhëtimi i tyre mbi rrugë mund të zgjatë pambarimisht, pa krijuar kurrë

pengesa në qarkullim. Përsiatja endet nëpër mjegullirë të gjejë një mbështetje. Diku kapet, të vijojë më tej dhe shtohet.

Shumësi, jashtë gramatikës, mund të jetë një gjendje e panjohur plotësisht. Fjala lind në shumës. Në thelb, është përgjithësim vetish. Njëjësi është përfaqësim te ne i shumësit. Punishtja e përfytyrimit, që krijon fjalët, nuk e njeh njëjësin, njeh tipin e fjalës, nga e cila ne zbresim një trajtë që i themi njëjës. Ndryshe nga fjalët, jemi qenie me interesa, prandaj kemi nevoja të ngutshme për trajtat e fjalës. Mbaresën e shumësit e heqim për të vendosur në vend të saj një tjetër. Në fillim e kthejmë fjalën në trajtën thelbësore fillestare. Interesat na kërkojnë një mbaresë që fjalën ta kthejë në vepruese. Fjala fillon të nxjerrë lëndën e vetvetes pambarimisht. Ajo prodhon përfytyrimet e saj, sigurisht kjo është një ide që na përmbush pa na ngazëllyer. Ne, të ndërprerët, që e kemi gjithëçka të kufizuar, që duam ta thithim, gjer në bulzën e fundit mushtin e vetëvetes, i lëmë një të vogëlth çast të pamatshëm, fjalës vepruese. Ne s'duam fjalën vepruese, por veprimin të dalë nga nënhijet e fjalëve. Ligjërimi, që del nga fjala vepruese është një rymë psikike, që na jep idenë e vijimsisë. Si në të gjitha trajtat, ajo ka gulfet e lëvizjes së gjakut me temperatura të panjohura. Vetëm psikika jonë i përjeton me shkallë zjarrmie.

Për një gjë jemi të sigurtë: fjalët shprehin thelbin e

vetvetes me besnikërinë e natyrës, që s'u nënështrohen trrilleve të jetëve të ndërprera. Fjalët flasin. S'e dimë mënyrën se si flasin dhe kur ndodhen më pranë vetvetes, se ç'farë lëndë të padukshme e kthejnë për ne në mendim. Kur fjalët flasin ne mendohemi. Mbase "mendohemi" s'është cak i fundëm, mbase është një pjesëz e fjalës, që e lë jashtë jetën e saj. Mbase përdorim pjesën për të tërën me sigurinë e të tërës. Asgjë mallëngjyese s'ka te fjala, veç pafajsisë së saj për të qënë qenie e përkorë. Patetizmi është sajesë e mendimit ligjërues. Kështu do jetë gjithmonë. Sigurinë na e jep e kaluara që s'ndryshon, ose që ndryshon për pasardhësit e saj duke mos ndryshuar thelbin.

KRONIKA (IME) SI DYTËS PËRSHKRUES

Pasqyrë për sprovën "Përkthimet e Kohës"

Jam dytësi i fjalës, të këqyr jetën e saj në çdo çast është qëllimi im. T'i vë në pikpyetje diturinë, t'a brohoras diku në një përballje, t'i largohem paksa dyshues, por asnjëherë të mos t'a braktis. T'i vë kundruall mure, t'a vëzhgoj se si do t'i kapërxejë dhe, t'a ndihmoj përsëri të rimarrë veten. Ta vë prore në udhë; të vjel kuptimet, që ajo i lëshon nga përplasjet me simotrat e fshehura; t'ja jap ato kuptime si pajime për të vijuar më tej. Të ndjej keqardhje për plagët që merr, por gjithsesi ta lë fillikate me plagët, t'i mjekojë vetë me lëngjet e gjuhës. Të mos ketë më tepër kohë se sa për t'u kujdesur për këto plagë. Si spartane ta ndjekë fatin dhe të shikojë me kthjelltësi rreth brerores. Ky përshkrim mund të jetë i anasjelltë, domethënë është fjala, që më këqyr mua, por gjithsesi po e lë gjendjen e parë të flasë. Unë po e përshkruaj fjalën e parlindur. Pra, ajo ka filluar ta hap tragën, të cilën s'do ta quaj kurrë të vetën. Mbi 'të, mbas saj, ecin të tjerë, ndonëse ajo s'qorton askënd, vetëm rend; me hap të lehtë çel rrugën. Unë ligështohem se ajo, ndonjëherë, do një grimë mund t'a

rimarë veten, por gjithsesi në këtë qëndrim ajo ecën me taktikë, pra jeton në një formë tjetër, për të lëvizur më me vrrull në tragën që po hap. Ajo i ka caktuar vetes një qëllim, askush tjetër s'ka pjesë në këtë qëllim, ndërsa ajo, në rast se do të mbrrijë diku, gjënë e mbërritjes do ta ndajë me të gjithë, ndonse s'është me të gjithë, është e dlirë, pa veskun e armiqësisë dhe, të gjithë, s'janë me atë, por janë pa pezëm, madje në heshtje e quajnë të lajthitur. Ajo të tillë ka vetëm hovin e lindur për të ecur më tej, për të mbrritur diku, që ende s'e di ku ndodhet, por me të mbrritur atje bëhet e mosqënë. S'merr parasysh këshilla. Edhe unë, dytësi i saj, jam i panevojshëm për të tilla dhënie. Përsëri është e vetme, takon fjalë me mendësi të përafërt, tek ato merr pak përndritëje, u vë në provë farefisninë dhe prap u largohet, ndonse ato i kanë shërbyer si gjonpagzorë, s'janë qëllimi i saj, më shumë janë pengesa të vëna nga verbëria e panjohur. Edhe për këtë duhet të luftojë, po këtë s'e quan luftë. Mbase ajo s'e kupton luftën. Unë, dytësi i saj, ja emërtoj hovin si luftë ngadhnjyese. Si përherë, ajo shmang me mjete të pa vëna re verbërinë, që i ka dalë përpara. Unë e shikoj, që po mbrrin diku. Atje rrugët janë të hapura, por hapja është aq e madhe, sa mund ta quash edhe mbyllje. Ajo, për vetveten, e ka shkokëluar nyjen dhe, ka ndihmuar edhe simotrat e përafërta dhe, tani, është e lirë të kthehet përsëri nga erdhi. Përpara saj gjithëçka është e hapur, aq sa të krijon mbresën e zënies me perden e hapësirës së lëbyrët.

Një çast, thashë, mbërriti, atje ku kishte synuar dhe, sa s'thirra i ngazëllyer për fitoren e fjalës, por ajo e kishte pikasur rrugën e lirë, zënë nga hapësira pa fund. Ajo, që është mësuar të eci mbi tragë, dhe për më tepër, ta çajë vetë, u kthye përsëri. Mendova se do të vijë te unë, me hop të menjëhershëm dhe, unë, paskëtaj do dal në rezervë nga detyra e dytësit përshkrues. Diku do të çlodhem, gjersa fjala të ketë nisur një tragë tjetër. Porsa u kthye mbrapsh, shtegu, që kishte qënë i hapur, u mbyll. Kjo ishte e papritur për mua. Një keqardhje e re për shpirtin ngazëllyes të fjalës, që po përballej me mbylljen, më kaploi. Por fjala përsëri filloi të eci. Traga, që kishte mbetur e hapur për të tjerët, pikërisht për atë, që e kishte çarë, u mbyll në kthim dhe, ajo filloi ta çel me hapin e saj të pavënre. Unë them "me hapin e saj", por ai hap është një ushtrim gramatikor i një vështirësie të panjohur, që ajo e zgjidh me lehtësi, në fshehtësi të plotë. Madje "me lehtësi", s'është përcaktimi i duhur, se cilësimi është imi dhe unë s'e kam tagrin e së vërtetës. Ajo s'i njeh vështirësitë dhe, natyrshëm, s'i njeh edhe lehtësitë. Përdor një mënyrë, që e kanë ditur paraardhësit, por tani ka humbur për ne. Unë, jam vetëm një dytës përshkrues, që s'e kam durimin dhe madhështinë e saj si të një kreshte të qetë, por edhe ky mendim për madhështinë, është imi. Ajo kurrë s'përdor epitete. E mbarështron mendimin krejtësisht ndryshe, po unë ia kam ndotur me epitete dlirësinë. Ajo s'përdor as krahasime dhe, kam kuptuar,

se krahasimet janë shkak lufte në botën tonë. Ajo përdor vetveten në çdo rrethanë, ajo i mjafton. Punon me një mënyrë të panjohur nga njerëzit. Përsëri nisi lëvizjen, në tragë tjetër. Ata, që kishin ecur lirshëm në tragën e hapur prej saj, i ishin mirënjohës, por ajo s'takoj asnjë mirënjohës në kthim. Ndoshta ajo tragë kishte qënë vetëm e saj dhe, pikërisht prej saj pritej të hapej, të tjerët vinin mbrapa. Kishte filluar të ndeshej me pengesa të tjera. Edhe një herë, i kërkoj ndjesë për të menduarit tim të palatuar, por më tepër ndjej se gjuha e saj e vërtetë, gjuha, që e vë në lëvizje pa qëllim praktik, është e huaj për mua. Do t'i ndodhem pranë gjithnjë, pa ja kuptuar dot kthjellësinë. Pas një mbërritje vjen një pushim. Ajo s'është e ndikuar në thelbin e vet nga shprehitë, që luhen me gjakim mbi tokë. Ka ardhur në jetë të lëvizë për hapje shtigjesh të njohur, kinse të mbyllur, ndërsa unë mendoj se e kam të siguruar lavdinë me shërbimet që i bëra fjalës sime. Ajme për mua! Përpara kam një godë ujë me lëng limoni, ktheva ca gllënjka. Fjala, me siguri, po ecën në kthim, ndonse s'jam i sigurt se ka kthim për të dhe unë kam të drejtë ta përfytyroj, por s'mund ta ndjek në të gjitha shtigjet. Në thelb, jam automat, që ja shfrytëzoj përvojën, pa ja njohur diturinë, që mban në trurin e saj. Në këtë grupfjalësh, që sapo e shpreha (në thelb, jam automat) s'mund t'a di me përpikëri, në cilën fjalë bie theksi logjik. Edhe në ma thënçin gramatikanët, përsëri do jem dyshues. Por tani, dua pak pushim të

lavdishëm. Ndërsa për fjalën time, që po rend mbi tragë të fortë, kam keqardhje dhe po filloj ta përfytyroj gjithnjë e më pak.



O HY I POEZISË! SHKOFSH NË DJALL!

Ah, Moikom! O Hy i poezisë! Shkofsh në djall!
Ah! O Hy i kulturës! Edhe ti shkofsh në djall!
Tridhjetë ditët e fundit, ç'gjuhë do flasësh?
Po e profetizoj, do të vijë gjuha e detit në gojë.
Nga uji i njelmët do dalin Pitagora dhe Koha
Si peshk fluturues dhe si leshterik.
Më në fund do t'i kuptosh idetë bosh.
Ah, Moikom Zeqo! Do ti kuptosh?
Pse u more me Pitagorën dhe Kohën?
Nuk e dije ç'përbindsha ishin ata?
Me figura ua mbushe sarkofagët Hijeve.
Ç'bëmë më shumë ne se duart e paraardhsve,
Që na hodhe metafora për drekë parajse?
Ne donim të na shpije në Macdonald.
Si s'na kuptove që jemi ide kulinarie?
Ah! Edhe ti si pasardhës i ngratë e kuptove jetën.
Njerëzit qënkan kulturë totalitare!
Mushkrinë e psherëtimës e çpojnë me sqepin e qejfit.
Ndryshove poezinë, jetën ku e gjete e le.
Një bisht cigareje me ankth është bërë jeta.
Ah, ah jeta! Jeta para dhe pas zotave.
Ditën ri me shkencën, natën fle me një flutur.

Si s'e kuptove që Pitagora ka vdekur?
O Njeri Kulturë Kozmopolit,
Luan golf me historinë. Ah, pindarik!
Omar Khajami provon rubairat në zërin tënd.
Metaforave u rrëzëllin Vera e Kuqe e Persisë.
E prishe dominanten poetike të poezisë.
Tani ç'zemberek do futim në orën e saj?
Ah, Moikom Zeqo, shkofsh në djall!
Bashkë me metaforat që na hodhe!
Na lër nën Ninullën e Jetës me Kainë,
Ose na shpjer në Macdonald!
Si një Fleming me penicilinë në dorë
Dua të të shpëtoj prej njeriut të madh.
Ç'kalorës të çuditëshëm vijnë e ikin në botë!
Peshën e tyre e shkarkojnë mbi ne.

INTERMEXO 2



LETËR VASIL VASILIT PËR POEZINË

POEZIA SI PAKUFISHMËRI

Homeri flet diku, se zotat kishin bërë të pamundurën: kishin burgosur Muzikën.

Hermesi, lajmësjellësi, rrugëqiellori, hyjnorlajmëruesi e ç'burgosi Muzikën më në fund.

Kështu rravgon edhe ungjillëzimi i Poezisë.

Muzika është sekreti dhe substancë e Poezisë.

Të ç'burgosësh Poezinë është mrekulli e intelektit njerëzor.

Kështu poetët janë hermesiakë.

Poezia që kam shkruar në vitet '70 të shekullit të kaluar ka qenë liria ime për të tjerët.

Më pas jam dëshpëruar nga Poezia.

Poezia burimsohet nga kriza.

Jashtë krizës nuk ka Poezi.

Pakënaqësia lind vizione të mëdha.

Kujtesa është sytë ende të gjallë tek një kafkë e historisë.

Zotin mund ta duan të gjithë, po varet se kë do ai vetë.

Poeti krijon epet e tij në funksion të një uni imagjinar. Poeti artikulon me sy fytyra shekujsh.

Ai i jeton në një kohë të gjitha kohërat.

Ai është egërsisht i gjallë, pa asnjë Post Mortum.

Të gjitha elementet e universit janë pseudonime të brishta dhe të kërthnesta të tij.

Si Shehrezadja, Poeti mbijeton çdo natë, duke thënë përrallën e Artit.

Statujat për Poetin janë gjumi metaforik i të gjallëve. Për Poetin edhe një luledielli është ora e engjëjve pa kronologji.

Por sot Poeti është si një detar fenikas mes makinave të bujshme të trafikut frikëndjellës të metropoleve.

Filozofi i atomizmit logjik L. Wittgenstein ka shkruar se nuk është e rëndësishme ajo që është thënë, por ajo, që nënkuptohet, pa u thënë, madje asnjëherë.

Këtu është Shpresa, ose Utopia marramendëse e Poezisë.

Idetë kompjuterizohen, por jo shpirti i gjuhës poetike. Poeti nuk klonohet dot.

Në globalizmin virtual, Poeti nuk tjetërsohet nga imazhet.

Poezia është një herezi e amëshuar dhe e papërballueshme.

Si mund të gjendet një metaforë e re, – metal i panjohur që nuk e di as Tabela e Mendelejevit?

Vdekatarë të papërsosur, poetët projektojnë Njerëzimin e Ri! Amen!

Durrës 15 korrik 2006

KORPUSI POETIK I MOIKOM ZEQOS, BOTIM I "APARKEAS - ABRAXAS"

1. MISCELLANEA 1, 2006
2. MISCELLANEA 2, 2007
3. MISCELLANEA 3, 2007
4. MISCELLANEA 4, 2008
5. MISCELLANEA 5, 2008
6. MISCELLANEA 6, 2009
7. MISCELLANEA 7, 2011
8. MISCELLANEA 8, 2014
9. MISCELLANEA 9, 2015
10 MISCELLANEA 10, 2015
11. MISCELLANEA 11, 2015
12. MISCELLANEA 12, 2016
13. DETI KANIBAL, 2016
14. PLAGOSJA E KUJTESËS, 2016
15. POSTIERËT E MAGJEPSUR, 2016
16. ANIJA MISTERIOZE, 2016
17. NË ANËN E TRILLUAR TË KOHËS, 2017
18. TË ËNDËRROSH INFINITIN, 2017
19. BLICI I ËNGJËJVE, 2017
20 LETRAT PËR MAKABE ZAHARIAN, 2017
21. ESHTRA ZODIAKU, 2017
22. STINA E PESTË, 2017
23. LULJA CENTAUR, 2018
24. KËMBËSOR NË QIELL, 2018

THËNIE TË POETËVE TË SHQUAR AMERIKANË PËR MOIKOMIN

WAYNE MILLER:

"Moikom Zeqo është një poet i jashtëzakonshëm. Ai ofron Antlantidën si një metaforë për botën e zhytur kulturore, historike dhe letrare, që e ka tërhequr tërësisht vëmendjen e tij, një botë e banuar nga Mobi Dick dhe Shekspiri. Ai është poet i rendit të lartë poetik, autor që përpiqet për të thënë gjithçka që ai di - ashtu siç ndodh me kryeveprat "Elegjitë e Duinos" të Rilkes, ose "Fijet e barit" të Whitmanit".

ILYA KAMINSKY:

"Është gjë e rrallë në ditët tona të gjesh një poet që nuk është vetëm interesant apo mjeshtër i artit të tij por edhe i pashtruar, i egër, i papërmbajtur, një poet i dimensioneve të mëdha dhe komplekse, që nuk krijon vetëm një portret njerëzor, një komunitet, apo një pasqyrim, por bën një kozmologji të tërë siç është "Komedia hyjnore" e Dantes, "Elegjitë e Duinos" të Rilkes, "Katër kuartetet" të T. S. Eliotit ose në ditët tona ndoshta edhe me "Cantico Cosmico" të Ernesto Cardenal-it".

KEVIN D. PRUFER:

"Moikom Zeqo është një mendje e fuqishme që mediton për mënyrën sesi historia njerëzore, letrare, politike dhe sociale ekziston njëherazi me vetë vdekshmërinë tonë. "Unë shkatërroj veten", pohon Zeqo në një moment, "me përgjërim për historinë" - por ky është një lloj shkatërrimi i bukur, i jashtëzakonshëm, transcedental dhe tronditës".